

DITURIA ISLAME

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE • Nr. 388 • MARS 2023



PERSIATJE RRETH
AJETEVË TË AGJËRIMIT

SI E PRISNIN TË PARËT RAMAZANIN?

BOTA SOLIDARIZOHET ME TË
PREKURIT NGA TËRMETI

تَهْرُفُصْنَا الَّذِي أَنْزَلَ فِيهِ الْقُرْآنَ

هُدًى لِلنَّاسِ وَبَيِّنَاتٍ مِنَ الْهُدَى وَالْفُرْقَانِ

Muaji Ramazan (është ai muaj) në të cilin (filloi të) zbriste Kurani, që është udhërrëfyes për njerëzit dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues

(i së vërtetës nga gënjeshtria).

(Kuran; 2:185)

EDITORIAL

- 4 Aroma e këndshme e muajit që ngjallë shpresën për ndryshim

FE & SHKENCË

- 5 Përsiatje shkencore rreth ajeteve të agjërimit (1)
Mr. Samir Zullufi
- 8 Si e prisnin të parët Ramazanin?
Rashit Zylfiu
- 10 Përcaktimi i fillimit të Ramazanit, syfyrit dhe iftarit
Dr. Muhamed Stublla
- 14 Dispozita për agjëruesen e Ramazanit
Dr. Violeta Smajlaj
- 17 Agjërimi në vendet që kanë gjatësi të disbalancuar të ditës e të natës
Bashkim Aliu
- 21 Përfitimet shëndetësore të agjërimit
Dren Qerimi
- 24 Komentimi i kaptinës El-Fet'h (2)
Sabri Bajgora
- 28 Vlera e muajit Shaban dhe e natës së Beratit
Dr. Jusuf el Kardavi
- 30 Muhamedi a.s., një peygamber i përkushtuar ndaj paqes
Phd. Flamur Vehapi

EDUKIM & FAMILJE

- 34 Loja dhe dëfrimi si metodologji edukuese në edukimin parashkollor
Phd. Melihate Zeqiri



- 37 E drejta e gruas myslimane përballë ideologjisë së të drejtave të njeriut dhe feminizmit stereotipizues (2)
Edlira Durmishaj

KULTURË

- 39 Moderniteti dhe ideologjia në tekstet shkollore të Perandorisë Osmane (1)
Hasan Bello
- 42 Leximi i librave -kuptimi i së vërtetës
Ma. sc. Refik Gërbeshi
- 44 Egjipti i Akifit në letrat e mërgimit
Abdullah Huruglica
- 46 Kontributi i El Batanit (858 – 929) në zhvillimin e shkencave
M.sc Artan S. Mehmeti



AKTUALITET

- 48 Bota solidarizohet me të prekurit nga tërmeti
Bajram Pomak




PERSONALITETE

- 50 Muhamed Naim Jasin (1943 – 2023)
Mr. Artan Musliu



AKTIVITETE

- 52 Myftiu Tërnava: "Bashkëndiejmë dhembje me popullin turk"



DITURIA ISLAME

Revistë mujore fetare, shkencore e kulturore
Nr. 388 • viti 36 • mars 2023
• Sha'ban / Ramazan 1444
• çmimi 1 €

Boton

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë

Redaksia

Kryeredaktor: Mr. Driton Arifi
Anëtarë:
Dr. Ejup Haziri, Merita Boroci,
mr. Muharrem Tërnava,
mr. Vedat Shabani.
Sekretar redaksie: Dr. Rexhep Suma
Lektor & korrektor: Bajram Zeqiri
Redaktor artistik & teknik:
Bashkim Mehani

Adresa

"Dituria Islame",
rr. "Bajram Kelmendi" nr. 182,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +384 38 224 024
E-mail: redaksia@dituriaislame.net
www.dituriaislame.net
Shtypi:
"Europrint", Prishtinë



“Nuk është agjërimi thjesht një ndërprerje e ushqimit e pijes, por agjërimi është ai që të largon nga kotësitë dhe fjalët e pahijshme. Madje edhe nëse ty të ka fyer apo lënduar dikush, ti vetëm thuaj: unë jam duke agjëruar...”

(Muhamedi, a.s.)

Aroma e këndshme e muajit që ngjallë shpresën për ndryshim

Si një erë e lehtë, e cila na shtetë shi për të gjithë të përvuajturit e të rraskapiturit nga thatësia e tej zgjatur e përcëlluese, na vjen neve mysafiri fisnik, i cili me vete sjellë ofertën rigjallëruese dhe shumë bujare për besimdrejtë zemërdëlirë. Zoti yt, nga bujaria e Tij, m'u në këtë muaj na fton që ta shfrytëzojmë shansin e artë, që t'i heqim qafe kthetrat e manisë e varshmërisë ndaj të gjitha atyre gjërave që na rënduan jetën tënde e s'arritëm t'i braktisim kurrë.

Ramazani, është emri i muajit që na thërret për abstenim nga kërkesat e trupit, dhe për rikthim të vëmendjes te kërkesat e shpirtit tonë të paepur për udhëzim.

Muaj ky që shpirtin tënd të së mirës e kalit, e pastaj bëhet edhe mbizotërues ndaj të gjitha llojeve të cytjeve të egra që të kanë molisur në jetë. Ai është që fton për frenim të egos, dëlirësi të shpirtit dhe gdhendje të karakterit me vlerat më sublime e më humane.

E motoja e besimtarit që ka pikësynim ndryshimin në këtë muaj është gravuar qartazi e më së miri nga Muhamedi a.s., i cili tha: “Nuk është agjërimi thjesht një ndërprerje e ushqimit e pijes, por agjërimi është ai që të largon nga kotësitë dhe fjalët e pahijshme. Madje edhe nëse ty të ka fyer apo lënduar dikush, ti vetëm thuaj: unë jam duke agjëruar...”

“Unë jam duke agjëruar”, duket të jetë parulla më fisnike profetike e ndryshimit në këtë muaj. Të tillës, nëse i përmbahesh, të është premtuar se nuk do të mbetesh duarthatë, por je afër për të fituar “trofeun e devocionit”. Këtë trofe nuk e fiton e as nuk e ngrit dot ai i cili agjërimin e ka kuptuar si adhurim të ngujuar vetëm brenda dimensioneve të abstenimit nga ushqimi e pija apo intimiteti bashkëshortor. Këtë trofe e fitojnë ata që në këtë muaj kanë bërë ndërrim të kahjes e orientimit të jetës së tyre të lajthitur. Ata që veset e tyre të mbrapshta vendosën t'i edukojnë e t'i korrigjojnë, vetëm për hir të Allahut.

Në këtë periudhë dëlirësie, që u bekua edhe me zbritjen e Librit fisnik - Kuranit, mundësohet realizimi i atij devocionit të aspiruar, e i cili jashtë kësaj periudhe për shumë kë është vetëm i ëndërruar. Ti, tashmë duhet t'i thuash egos se ke një Zot, se ndaj Tij nënshtrohesh, e me urdhrat e Tij je i gatshëm të jetosh e të krijosh shprehi. Ky është lajmi më ogurzi që mund ta marrë prej teje pasioni yt i shturur. Ai i cili të dha teposhtën e mëkateve që po vazhdon të tërhiqesh rrëmbyeshëm po sikur me litar, nga armiku yt i njohur - djalli.

Vëri mendjen kësaj porosie hyjnore të Zotit tënd, ku Ai të tha: “A e ke parë atë, që kënaqësinë - egon e vet e ka marrë për zot, dhe Allahu, e ka lënë në humbje duke e ditur (të keqen e tij) dhe ia ka vulosur të dëgjuarit e tij dhe zemrën e tij, e para syve të tij ka vënë perde? Kush do ta udhëzojë atë, pos Allahut? A nuk po kuptoni?”. (El Xhathije, 23). E pra Kurani, që është zbritur në këtë muaj dhe vetë agjërimi si kryeadhurimi i këtij muaji e ngulitin në kokën e secilit besimtar se egoja e njeriut nuk bën t'i bëhet kurrë zot atij. Andaj, ti përpiku që ta mposhtësh lakminë dhe pangopësinë tënde, që shpesh të bëri të flesh e të gdhiesh me belbëzimet e numrave e shifrave të xhirollogarive tua që s'të lanë të prehesh e të jetosh rehat asnjëherë. Gjeje forcën që t'iu buzëqeshësh m'u në këtë muaj, të gjithë atyre që te ti kishin parë vetëm valët e rrudhave në ballin tënd të vrenjtur, dhe nga ti prisnin vetëm lëndime, ofendime e fjalë poshtëruese.

Thuaj mjaft më koprracisë sate, e lëshoje grushtin tënd të fisnikërisë ndaj atyre që do t'i bësh të lumtur edhe me një kafshatë buke të thatë më të cilën ua mbanë shpresat gjallë se ende paska mbetur diku njerëzi.

Mësoja ballit tënd rrugën e shkurtër deri te sexhdeja, ajo adresë fisnike e tij që ai kurrë deri më tani nuk e ka ditur. Ramazani po të troket në derën tënde që ti të shmanges nga gjithçka e ligë e mbrapsht, dhe të rifillosh jetën e mbarë e fisnike, në rrugën e dëlirtë të Krijuesit tënd.

E ti, mirëprite atë!

Mr. Driton Arifi

Përsiatje shkencore rreth ajeteve të agjërimit (1)

Mr. Samir Zullufi

“O ju besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu siç u ishte urdhëruar atyre para jush, që të mund të ruheni nga të këqijat.”¹ (El Bekare, 183).

Ky është ajeti i parë i ajeteve të agjërimit, i cili nis me thirrjen ndaj besimtarëve, gjë që nënkuptohet sepse janë besimtarët, ata, që i pranojnë urdhëresat e Tij dhe i zbatojnë ato. Kurse mësimet kryesore që nxjerrim nga ky ajet mund të përmbledhen në tri pika, siç vijojnë:

- **Agjërimi si adhurim është obligim i prerë për besimtarët – farz**

Siç dihet, agjërimi (i Ramazanit), njëherësh është edhe një nga pesë shtyllat e Islamit. Fjala “*saum*” gjuhësisht nënkupton lënien apo abstenimin, kurse në terminologjinë islame, nënkupton abstenimin nga gjërat që e prishin agjërimin (ngrënia, pirja, intimiteti, e të ngjashme), nga koha kur dallohet bardhësia e agimit të vërtetë nga errësira e natës, e deri në përfundimin e diellit.

Në këtë ajet nuk përcaktohet se për cilin agjërim bëhet fjalë, dhe për këtë ka disa interpretime: A është për qëllim agjërimi i muajit Ramazan; apo tri ditë nga secili muaj siç ishte më herët obligim para se të bëhej obligim Ramazani në formë të prerë, që i bie që ky ajet të jetë i abroguar nga ajeti 184 i kësaj sureje; apo interpretimi i tretë që është thjesht agjërimi në esencë si lloj ibadeti, e që duket të jetë më i sakti.²


- **Agjërimi nuk është veçori e këtij ymeti, sepse ishte obligim edhe i popujve të më hershëm**

Komentuesit e Kuranit, japin tri mendime se cilët mund të jenë të mëhershmit për qëllim në këtë ajet. Një pjesë e dijetarëve thonë se janë të krishterët, të tjerët mendojnë se janë ithtarët e Librit,³ dhe mendimi i tretë është se janë të gjitha ymetet e mëhershme të urdhëruara me agjërim, pejgamber pas pejgamberi që nga Ademi a.s..⁴ Sido që të jetë, kjo e shfaq rëndësinë e këtij adhurimi si pjesë e përbashkët e shariateve të zbritura nga Allahu i Madhërishëm. Gjithashtu ky krahasim jep një ndjesi lehtësimi, pasi që dihet se gjërat jo të lehta, siç mund të konsiderohet edhe agjërimi, përballohen më lehtë kur kuptohet fakti se ato ishin obligim i të gjithëve, sesa po të mbetej vetëm obligim i veçantë për ne. Po ashtu, kjo gjë nxit në kryerjen e tij dhe i shtyn besimtarët ta marrin atë me seriozitet, pse jo që t’i tejkalojnë edhe popujt e mëhershëm.⁵

- **Agjërimi si synim ka devotshmërinë dhe frenimin nga punët e këqija**

Nga definicionet më përmbledhëse të devotshmërisë është se të jesh i devotshëm, do të thotë të vësh pengesë ndërmjet teje dhe dënimit të Zotit, duke i zbatuar urdhëresat e Tij dhe duke u larguar nga ndalesat e Tij. Prandaj, i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “Agjërimi është mburojë....” (Buhariu, 1894),⁶ pra në kuptimin metaforik të fjalës, që e mbron agjëruesin nga mëkatet.

“O ju besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu siç u ishte urdhëruar atyre para jush, që të mund të ruheni nga të këqijat.” (El Bekare, 183).



“(Agjërimi zgjat) disa ditë (të caktuara), por, nëse ndonjëri prej jush është i sëmurë ose duke udhëtuar, le të agjërojë aq ditë sa i ka prishur në ditët e tjera pas. Ata që kanë mundësi për të agjëruar, duhet të ushqejnë si shpagim nga një të varfër për çdo ditë agjërimi. E, nëse ndonjëri jep më shumë se kaq, kjo është edhe më mirë për të. Por, agjërimi juaj është më i dobishëm, në qoftë se e dini.” (El Bekare, 184).

Ky ajet, gjuhësisht, është i ndërlidhur me ajetin paraprak, meqë fillon me “disa ditë (të caktuara)”; dhe si rrethanor kohe (ose edhe si kundrinor i drejtë), plotësohet kuptimisht me ajetin paraprak. Shpjegimin dhe normat që nxjerrim nga ai, mund t’i përmbledhim në pikat vijuese:

Rreth fjalëve “disa ditë”, ka dy mendime se çka është për qëllim me to. Shumica e tefsirologëve mendojnë se janë për qëllim ditët e Ramazanit.⁷ Madje, Imam Taberiu, thotë se nuk ka argument të prerë që të dëshmojë mjaftueshëm se ka pasur agjërim tjetër të obliguar për këtë ymet përveç Ramazanit.⁸

Më tutje, ajeti shpjegon se të sëmurët dhe udhëtarët mund t’i kompensojnë më vonë ditët e pa agjëruara gjatë Ramazanit.

Për sa i takon sëmundjes nga e cila lejohet të priset agjërimi, sipas mendimit më të saktë është për qëllim, ajo sëmundje që sjell vështirësi të mëdha për agjëruesin, si dhe sëmundja që e dëmton trupin apo e shton – eskalon sëmundjen.⁹

Kurse për udhëtarin, se kush konsiderohet i tillë, ka po ashtu mospajtime ndërmjet dijetarëve. Por, sipas shkollës hanefite, me udhëtim është për qëllim distanca që e kalonte njeriu për tri ditë e tri net me mjete udhëtimi primitive.¹⁰ Sot kjo distancë përlllogaritet diku së paku 85 kilometra.

Më pas vjen fjalia “Ata që kanë mundësi për të agjëruar, duhet të ushqejnë si shpagim nga një të varfër për çdo ditë agjërimi”, për të cilën ka disa interpretime dhe nga e cila varet edhe interpretimi i pjesës tjetër të ajetit, më saktësisht bëhet fjalë për fjalinë (يُطِيقُونَهُ) - ata që kanë mundësi për të agjëruar. Kjo fjali recitohet me dy kiraete të njohura dhe ka disa mendime për domethënien e saj.¹¹

Shumica e tefsirologëve, duke u bazuar në kiraetin e xhumhurit, e që është mutevatir, dhe siç e kemi të shkruar në mus’hafe (يُطِيقُونَهُ), janë të mendimit se kuptimi i kësaj fjalie është: ata që munden (të agjërojnë).¹² Sipas mendimit më të saktë, në mënyrë specifike, për qëllim janë të moshuarit/at, që mund ta përballojnë agjërimin, ata/ato mund të agjërojnë ose ta kompensojnë. Rrjedhimisht, sipas këtyre dy interpretimeve, i bie se ajeti është abroguar me ajetin pasues “...pra, kushdo nga ju që e arrin këtë muaj, le të agjërojë!...”, me të cilin obligohen të gjithë, përveç atyre që nuk munden. Kurse interpretimi i tretë është se ajeti nuk është abroguar, dhe kuptimi i kësaj shprehje është: ata që munden të agjërojnë sa janë të rinj, ta bëjnë atë, e kur plaken, të japin kompensim ushqim të varfërve.¹³

Mendimi tjetër bazohet në kiraetin tjetër (يُطَوَّقُونَهُ), që transmetohet se kështu e ka lexuar Ibën Abasi r.a., me kuptimin: ata që me vështirësi e agjërojnë. Nga kjo janë për qëllim të shtyrit/at në moshë dhe bashkëngjiten me ta gratë shtatzëna dhe gjidhënëset.¹⁴

Për të dyja mendimet, komentuesit argumentohen me tekste të përcjella nga gjeneratat e para, por mendimin e parë e mbështet transmetimi i Aishes r.a., ku thotë: “Më herët, agjërohej dita e Ashures, e kur zbriti obligueshmëria e

Ramazanit, kush donte agjëronte dhjetë ditët e para të Muharremit, e kush donte, nuk agjëronte.” (Buhariu, 4502).¹⁵ Po ashtu transmetimi i Seleme ibën Ekues r.a., që thotë: “Ne kohën e Pejgamberit a.s., kush donte nga ne agjëronte në Ramazan, e kush donte nuk e bënte dhe jepte kompensim ushqim një të varfëri.” (Muslimi, 1145).¹⁶ Këto dy tekste përforcojnë variantin se agjërimi ka qenë obligim, por me mundësi zgjedhjeje ndërmjet tij dhe kompensimit; kuptohet se është fjala për ata që kanë mundur ta agjërojnë, meqë nuk përmenden pleqtë apo kategoritë e tjera. Për më tepër, ky mendim përkon me frymën e Sheriatit që gjërat e vështira t'i obligojë apo ndalojë gradualisht.

Kur jemi tek ata që nuk kanë mundësi të agjërojnë për shkak të shtyrjes në moshë, si dhe për shkak të sëmundjes nga e cila nuk pritët shërimi, ata e kompensojnë agjërimin me ushqim të të varfërve. Kurse gratë shtatzëna dhe gjidhënëset, të cilat kanë frikë se agjërimi i dëmton ato ose foshnjat e tyre, si dhe të sëmurët me sëmundje nga e cila pritët shërimi, i agjërojnë më vonë kaza ditët e lëna, sipas mendimit më të zgjedhur, duke mos ua kushtëzuar të gjitha ditët përnjëherë një pas një, e as menjëherë pas Ramazanit, ngase në ajet nuk kërkohet një gjë e tillë.¹⁷

Për sa u përket shtatzënave dhe gjidhënësve, disa dijetarë janë të mendimit se duhet edhe të kompensojnë me ushqim përveç kazasë, duke u bazuar në mendimin e dytë për kuptimin e fjalisë (يُطَيِّفُونَ), siç u sqarua më lart, dhe meqë me këtë obligohet i shtyri në moshë. Kurse mendimi i shkollës hanefite dhe i shumë dijetarëve të tjerë është se nuk mund të obligohen dy zëvendësime për të njëjtën gjë, të shtyrët në moshë obligohen vetëm me kompensim si zëvendësim për agjërimin, sepse nuk ka kuptim t'i obligosh ata me kaza, kurse udhëtarët dhe të sëmurët e përkohshëm obligohen vetëm me kaza, siç e shpjegon ajeti tekstualisht, si dhe duke u bazuar në mendimin e parë për kuptimin e fjalisë (يُطَيِّفُونَ). E rasti i grave shtatzëna dhe gjidhënësve i ngjason kategorisë së dytë (të sëmurëve), dhe meqë obligohen me një zëvendësim, ai u mjafton, e që duket të jetë mendim më i saktë.¹⁸

Pjesa tjetër e ajetit, na bën me dije se ata që kanë mundësi të japin më tepër, se sa ushqimi i një të varfëri për një ditë, është më mirë për ta. Kurse në fund thekson se agjërimi është më i dobishëm, porse për kë është më mirë të agjërojnë, ka disa mendime dhe ato lidhen me interpretimin e pjesës paraprake të ajetit. Sipas mendimit të shumicës së dijetarëve, që shpjegojnë se agjërimi në fillim ishte me mundësi zgjedhjeje për të gjithë në mes tij dhe kompensimit, kjo është e qartë se agjërimi është më i mirë sesa kompensimi, dhe këtu nuk ka dilema. Ata pastaj potencojnë se nuk mund të konsiderohet më i mirë për ata që i dëmton, të sëmurin, sepse e ka të ndaluar ta ekspozojë veten ndaj shkatërrimit, shtatzënat dhe

gjidhënëset po ashtu, meqë agjërimi i dëmton ose ato ose foshnjat e tyre.

Kurse, për sa i përket agjërimit gjatë udhëtimit, se a është më mirë të agjërohet apo jo, ka transmetime nga Pejgamberi a.s. se ka agjëruar si udhëtar, por ka gjithashtu transmetime se e ka prishur dhe se ka udhëzuar të mos agjërohet. Një gjë e tillë mund të shpjegohet se varet nga gjendja e agjëruesit dhe mundimi që mund t'i shkaktojë agjërimi atij. E nëse flasim për normën në parim, një pjesë e madhe e dijetarëve janë të mendimit se agjërimi për udhëtarin është më i mirë, duke u argumentuar me fundin e këtij ajeti.¹⁹ Kurse Rraziu, përveç kategorive të përmendura, e përkrah mendimin se është me kuptim të përgjithshëm, duke përfshirë edhe të sëmurin,²⁰ e Allahu e di më së miri!

1 Përkthimi i ajeteve në këtë shkrim është bazuar në përkthimin e Hasan ef. Nahit, me disa ndryshime.

2 Rrazi dhe Ibën Ashuri anojnë kah mendimi i fundit, Muhammed Omer err Rrazi, *Mefatihu 'l-gajb Et-tefsiru 'l-kebir*, botimi i tretë, Bejrut, Daru Ihjai't-Turathi'l-Arabij, V/239-140; Muhammed Tahir ibën Ashur, *Et-tahriru ue 'l-tenuir*, Tunizi, Daru't-Tunusije li'n-Neshr, 1984, II/156.

3 Këtë zgjedh Taberiu, Muhamed Xherir et Taberi, *Xhamiu 'l-bejan an te 'uil aji 'l-Kur 'an*, botimi i parë, Kajro, Daru Hixhr, 2001, III/135.

4 Këtë mendim ka Zemahsheri, Muhamed Amr ez Zemahsheri, *El-keshshaf an hakaiki gauamidi 'l-tenzil*, botimi i tretë, Bejrut, Daru'l-Kitabi'l-Arabij, 1987, I/225; Shiko: Taberi, vepra e cekur, III/154-155.

5 Rrazi, vepra e cekur, V/239; Ibën Ashuri, vepra e cekur, II/152-153.

6 Muhamed Ismail el Buhari, *Sahihu 'l-Buhari*, botimi i parë, Daru Tuki'n-Nexhah, 2001, III/24.

7 Ndër ta Taberiu dhe Rrazi, Taberi, vepra e cekur, III/159; Rrazi, vepra e cekur, V/241-242.

8 Taberiu, vepra e cekur, III/159.

9 Shiko: Rrazi, vepra e cekur, V/243; Muhamed Ahmed el Kurtubi, *El-xhamiu li ahkami 'l-Kur 'an*, botimi i dytë, Kajro, Daru'l-Kutubi'l-Misrije, 1964, II/276-277.

10 Ahmed Ali el Xhessas, *Ahkamu 'l-Kuran*, botimi i tretë, Bejrut, Daru'l-Kutubi'l-Ilmiye, 2007, I/213.

11 Shiko: Taberi, vepra e cekur, III/161-179; Rrazi, vepra e cekur, V/247-249.

12 Ndër ta: Taberiu, Zemahsheri, Bejdaviu dhe Nesefiu, Taberi, vepra e cekur, III/178; Zemahsheri, vepra e cekur, I/226; Abdullah Omer el Bejdavi, *Enuaru 'l-tenzil ue esraru 'l-te 'uil*, botimi i parë, Bejrut, Daru Ihjai't-Turathi'l-Arabij, 1997, I/124; Abdullah Ahmed en Nesefi, *Medariku 'l-tenzil ue hakaiku 'l-te 'uil*, botimi i parë, Bejrut, Daru'l-Kelimi't-Tajjib, 1998, I/158.

13 Shiko: Taberi, vepra e cekur, III/169; Rrazi, vepra e cekur, V/247-249; Ali Muhamed el Mauerd, *En-nuket ue 'l-ujun*, Bejrut, Daru'l-Kutubi'l-Ilmiye, I/238-239.

14 Mauerd, vepra e cekur, I/238; Ismail Omer ibën Kethir, *Tefsiru 'l-Kur 'ani 'l-adhim*, botim i dytë, Daru Tajjibe, 1999, I/501; Ibën Ashuri, vepra e cekur, II/167.

15 El Buhari, vepra e cekur, VI/24.

16 Muslim el Haxhaxh, *Sahihu Muslim*, Bejrut, Daru Ihjai't-Turathi'l-Arabij, II/802.

17 El Xhessas, vepra e cekur, I/220-222, 253-254.

18 Gati për të gjitha çështjet e dy paragrafëve të fundit ka detaje të tjera dhe ndryshim mendimesh ndërmjet dijetarëve, por nga pamundësia për t'u zgjeruar më tepër këtu u mjaftuan me pikat kryesore dhe mendimin më të saktë. Për më tepër shiko: El Xhessas, vepra e cekur, I/220-223; Rrazi, vepra e cekur, V/248; El Kurtubi, vepra e cekur, II/276-290.

19 Kështu mendojnë Imam Ebu Hanife dhe dy nxënësit e tij, Imam Maliku dhe Imam Shafiu. Kurse Imam Euzai dhe Imam Ahmedi mendojnë të kundërtën, El Xhessas, vepra e cekur, I/261; Rrazi, vepra e cekur, V/246.

20 Rrazi, vepra e cekur, V/250.



Si e prisnin të parët Ramazanin?

Rashit Zylfiu

Ramazani është një muaj i veçantë. Karakterizohet për nga ngjarje dhe adhurime të cilat na bëjnë të kuptojmë se trajtimi i tij duhet të jetë serioz. Për këtë shkak, edhe pse agjërimi përkufizohet formalisht si abstenim nga ushqimi e pija, në psikikën e besimtarëve është e ngulitur thellë se manifestimi i tij duhet bërë përtej këtyre dimensioneve. Pra, duhet agjëruar jo vetëm me trup. Agjërimi, po gjurmuam në thellësi të tij, gjejmë se synon nivelin më të përkryer të fetarisë, atë të nënshtrimit dhe bindjes absolute të robit ndaj Zotit. Por, për të arritur te ky synim, ka një rrugë që duhet bërë, e të cilën jo të gjithë arrijnë ta përshkojnë. Prandaj, për besimtarin që synon kënaqësinë e Allahut, jetike në këtë rrugë mbetet gjetja e një modeli të cilin do ta ndjek, këshillat e të cilit do t'i përfillë, mësimet e të cilit do t'i zbatojë. Është kjo çfarë ky artikull ka marrë mundin për ta bërë.

CILI ËSHTË MODELI YNË?

Në jetë, shpeshherë lind nevoja që t'u kthehemi referencave për të gjetur përgjigjen e saktë dhe të besueshme. Jemi duke kërkuar një referencë, të cilën për fat të mirë e kemi në fenë tonë, pra se kë duhet të marrim për model, kë duhet të konsultojmë e sidomos në rastin tonë se si të përgatitemi për Ramazanin. Ramazani është rast ideal për ndryshim personal dhe kolektiv në rrafshin e imanit, ibadetit dhe moralit, sepse është sezonë adhurimesh dhe shans për të fituar shumëfishin e sevapeve, prandaj patjetër duhet t'i kthehemi referencës sonë, që janë i dashuri ynë, Muhamedi, alejhi selam dhe gjeneratat e para të arta, të cilët ishin shembulli më i mirë për t'u ndjekur në rrugën e të qenit robër të Allahut.¹

Besimtari arrin në përfundimin se muaji Ramazan është rasti më i favorshëm për të garuar për vepra të mira, sepse mundësitë që Ramazani u jep besimtarëve për të vepruar, ndryshuar dhe fituar shpërblime nuk mund të gjendet në muajt e tjerë. Kjo shihej edhe në jetën e myslimanëve të parë, kur garonin për vepra të mira si individë apo edhe si shoqëri. Nëse do të tërheqim një paralele mes tyre dhe nesh, do të shohim se sa e largët është kjo distancë. Kjo më mirë të mbetet një test individual për ta kuptuar se mos vallë ne e kemi përkufizuar Ramazanin gabim kur menduam se ishte thjesht një abstenim.

Të parët tanë gëzoheshin nga sihariqi profetik *“ju erdhi Ramazani, muaji i bekuar...”* sepse qysh herët preokupoheshin me ardhjen e Ramazanit, duke e lutur Zotin t'u dhuronte shëndet e jetë që ta agjëronin. Në jetën e të parëve tanë, do të shohim një vetëdije dhe gatishmëri të lartë për t'u përgatitur për sezonet e adhurimeve. Ata kishin kuptime të qarta për agjërimin dhe ibadetet e tjera. Këtë na e pasqyrojnë mendimet dhe qasjet e tyre, si për shembull: *“Agjërimi nuk është vetëm privim nga ushqimi dhe pija, por agjërim është ta pastrosht gjuhën tënde nga rrena, e kota dhe fjalët e ndyra.”* Kështu thoshte Omer bin Hatabi, Allahu qoftë i kënaqur me të!²

Hafsa bint Siriin, Allahu e mëshiroftë!, ka thënë: *“Kur shokët e Pejgamberit agjëronin, qëndronin në xhami dhe thoshin se agjërimi ishte mburojë, derisa të mos digjej. Djegia e tij ishte përgojimi.”*

Ndërsa në transmetimin e Muslimit thuhet: *“Hapen dyert e mëshirës, mbyllën dyert e Xhehenemit dhe lidhen shejtanët.”* (Sahihul Muslim).

Ibën Rexhepi ka thënë: *“E si të mos gëzohet besimtari për hapjen e dyerve të Xhenetit!”* Vërtet Ramazani kërkon angazhim dhe energji në rrafshin e adhurimit. Më poshtë do të shohim disa nga përgatitjet e gjeneratave të para, ku ata merrnin energji për t'u përgatitur për muajin Ramazan.

ENERGJIA E ADHURIMIT TEK ATA

Përgatitja psikike është më se e nevojshme para Ramazanit, sepse çdo sukses në jetë është i lidhur me përgatitjet paraprake, prandaj themi përgatitje bazike, esenciale apo përgatitje përfundimtare.

Gjeneratat e para të myslimanëve ishin kureshtarë që çdo herë të ndriçoheshin nga kandili profetik i Ramazanit, sepse vetëm kështu ngjallehin ambiciet e tyre për adhurime.

Ata e përjetonin bukur hadithin që e kishte transmetuar Ebu Hurejra, Allahu qoftë i kënaqur me të!, i cili ka thënë: *“Kur vjen Ramazani, hapen dyert e Xhenetit, mbyllën dyert e Xhehenemit dhe lidhen (prangohen) shejtanët.”* (Buhariu, Muslimi).

Nijeti ose qëllimi, i cili është boshti kryesor që na mëson dhe na kujton se për kë dhe pse agjërojmë. Ai duhet të jetë i pranishëm në zemrën e secilit para Ramazanit, se unë do të



agjëroj. Kështu myslimanët e parë e rregullonin nijetin e tyre. Kjo mbështetet në hadithin e Pejgamberit, alejhi selam, të cilin e transmeton Ibën Omeri: “*Nuk agjëron vetëm se ai që ka bërë nijet para agimit*”. (Maliku dhe Nesaiu).

KONTROLLIMI I PULSIT TË IMANIT PËR TA PARË SE KU JEMI

Ata tregonin përkushtim në adhurime, edhe pse përkushtimi duhet të ekzistojë gjatë tërë jetës, por para dhe gjatë Ramazanit duhet të jemi edhe më të kujdesshëm. Por kjo sjell edhe përmirësim të adhurimit në cilësi, sepse do të shohim më vonë se Ramazani synon që të mos kufizohemi në numër, por në kualitet. Të parët tanë bënë agjërim vullnetar, lexonin Kuran, jepnin sadaka dhe luteshin që imani i tyre të ishte në nivelin e duhur kur të vinte Ramazani.³

Ramazani për të parët tanë ishte një shkollë, energjia e së cilës përpos adhurimeve gjatë tij, do t’u duhej edhe pas tij. Kjo shkollë u jepte mësimet e duhura se si duhet të agjëronin edhe vullnetarisht pas Ramazanit, apo si duhet të falnin namaz vullnetar pas Ramazanit. Ata, nga kjo shkollë e kuptonin se Kurani duhej lexuar, medituar e jetësuar në jetën e përditshme. Mësimet e Ramazanit i mësonin që të garonin në punë të hairit, në adhurime e vepra të mira, që të arrinin kënaqësinë e Allahut dhe të hynin në Xhenet.⁴

Hasen el Basriu ka thënë: “Allahu e bëri Ramazanin një arenë për krijesat e Tij, në të cilën ata garojnë për kënaqësinë e Tij, kështu që disa prej tyre paraprinë dhe fituan, e të tjerët mbetën prapa dhe u zhgënjyen (sepse dështuan).”

PO NE, SI PO E PRESIM?

Kur ne, besimtarët e kësaj kohe, bëjmë krahasime me të kaluarën, ndoshta në raste të caktuara edhe e nënvlerësojmë veten dhe veprat tona, sepse jemi dëshmitarë se një pjesë prej nesh e ka përkufizuar Ramazanin gabimisht. Nuk duhet të vazhdojmë në rrugën e gabuar, por duhet të vetëdijesohemi

dhe të zgjohemi nga gafleti, nga pakujdesia që shpeshherë na mbulon sytë, për ta parë udhëzimin e Zotit dhe thirrjen që t’i bashkohemi karvanit.

Ne duhet ta lexojmë drejt jetën e të parëve tanë, ta përkthejmë në praktikë dhe ta reflektojmë sidomos në adhurim, sepse ata ishin dhe mbeten referenca më e besueshme, ata që këtë test e kaluan me sukses. Një pjesë e tyre ishin edhe bartës të shpalljes, pjesa tjetër ishin të kujdesshëm që mësimet e Zotit dhe të Profetit Muhamed t’i praktikonin pa u larguar nga koncepti dhe praktika e saktë.

Ne duhet të fillojmë që ta presim Ramazanin duke ndjekur fillimisht këta hapa:

Thyerja e zakoneve,⁵ pasi dihet që gjatë udhëtimeve të jetës kemi përvetësuar disa të tilla, që na pengojnë t’i përkushtohemi adhurimit. Kjo thyerje duhet të jetë para përgatitjes, që ta kemi më të lehtë bërjen e përgatitjeve të nevojshme për Ramazan.

Përcaktimi i objektivave, që është një vepër tej fisnike, sepse vetëm kështu do të kemi mundësi të arrijmë te caku e të korrim sukses duke arritur faljen e Allahut dhe hyrjen në Xhenet.⁶

Neve sot na mungojnë standardet e adhurimit, sepse fokusi ynë më shumë është si ta kryejmë sa më shpejt adhurimin. Kjo shihet qartë edhe gjatë namazit të teravive, ku fokusi ynë më shumë është te numri, sesa cilësia e adhurimit që bëjmë.

Para Ramazanit ne duhet të bëjmë një parapërgatitje për adhurim, duke e përgatitur veten që kemi nevojë për adhurim dhe se adhurimi është ushqimi i vetëm për ta mbajtur shpirtin të gjallëruar dhe që të ruajmë objektivin pse erdhëm në këtë botë. Nëse nuk fillojmë të bëjmë përgatitje në këto dy rrafshë, ekziston frika që do të hyjmë në Ramazan dhe disa vepra së bashku me agjërimin do t’i bëjmë në mënyrë mekanike, nuk do të ndiejmë nevojën shpirtërore për to dhe as shijen e tyre.

Më shumë se kurrë para Ramazanit kemi nevojë të krahasojmë veten me gjeneratat e para, se si ata përgatiteshin për Ramazan dhe si përgatitemi ne. Ata i kushtonin vëmendje anës shpirtërore dhe pothuajse aspak asaj materiale, kurse ne më shumë po i kushtojmë vëmendje anës materiale sesa shpirtërore.

Ne kemi nevojë për përgatitje shpirtërore që ta rrisim energjinë dhe të bëjmë sa më shumë vepra të mira, por nuk duhet të harrojmë se për përgatitjet para, gjatë dhe pas Ramazanit duhet të ndjekim modelin e të parëve tanë.

Ibën Mesudi thoshte: “Cili prej nesh është i pranuar, që ta përgëzojmë? E cili prej nesh është i privuar, që ta ngushëllojmë? Urime për ty që je pranuar! Ndërsa ti që je privuar, Allahu të ndihmoftë në fatkeqësinë që të ka rënë!”⁷

1 Fejsal Bedani, *Heketha Kane Ennebji fi Rmadan*, Riad, 2007, fq. 23.

2 Rashit Zylfiu, *Kandili i Ramazanit*, Gjilan, Këshilli i Bashkësisë Islame, 2017, 26.

3 Dr. Sedat Islami, *Si të përfitojmë nga Ramazani*, Prishtinë, 2019, 14.

4 <https://www.alukah.net/sharia/0/44211>

5 Dr. Omer Mudejfir, *Kejfe tenxhah fi Rmadan*, Riad, 1428h, 17.

6 Po aty.

7 Rashit Zylfiu, *Kandili i Ramazanit*, Gjilan, Këshilli i Bashkësisë Islame, 2017, 35.

Përcaktimi i fillimit të Ramazanit, syfyrit dhe iftarit

Dr. Muhamed Stublla

Agjërimi i muajit Ramazan bëhet obligim me hyrjen e muajit Ramazan, ndërsa obligimi i ditëve të Ramazanit, fillon prej zbardhimit të dytë, ose thënë ndryshe, prej fillimit të shkëndijave të zbardhimit real dhe përfundon me perëndimin e diellit.

Fillimi, përfundimi dhe agjërimi i ditëve të Ramazanit, bëhet përmes këtyre metodave:

- **Shikimit të hënës**

Kur muaji Shaban të jetë në përfundim, konkretisht në ditën e 29, besimtarët në kohën e perëndimit të Diellit vëzhgojnë qiellin. Nëse shihet Hëna, lajmërohet autoriteti përgjegjës apo institucioni kompetent, i cili pas vërtetimit të saktësisë së informacionit, do të vendos të shpallë apo jo fillimin e Ramazanit. Numri i dëshmitarëve mund të jetë relativ, nëse qielli është i turbulluar, mund të mjaftojë edhe dëshmia e një personi, i cili duhet t'i plotësojë kushtet e dëshmisë. Ndërsa, nëse qielli është i çiltër, dhe hëna mund të shihet me lehtësi, duhet së paku të jenë dy dëshmitarë, në mënyrë që të vërtetohet saktësia e shikimit të Hënës. Në situatën e tillë, dëshmia e vetëm një individi është e dyshimtë, për faktin se si ishte e mundur që Hënën ta shihte vetëm një individ, ndonëse nuk kishte pengesa në horizont për shikimin e saj. Prandaj, në këtë situatë refuzohet dëshmia e një dëshmitari të vetëm. Kështu që, agjërimi shpallet nga autoriteti kompetent, dhe jo nga shikimi apo jo i Hënës nga ndokush.¹

Obligimi dhe e drejta e shpalljes së fillimit të Ramazanit nuk i përket individit, edhe nëse atë e ka parë me sytë e vet. Agjërimi i bëhet obligim vetëm atij, përderisa është i bindur se e ka parë Hënën. Megjithatë, atij i ndalohet thirrja e njerëzve për të agjëruar Ramazanin, gjë e cila do të rezultonte me çrregullime në shoqëri. Kjo kompetencë, në aspektin fetar dhe juridik, është e rezervuar për institucionin apo autoritetin kompetent. Në rastin konkret, në vendin tonë, autoriteti i vetëm kompetent për shpalljen e fillimit të Ramazanit është Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës. Për këto procedura verifikuese,

përmes së cilave do të përcaktohej fillimi i Ramazanit, na ka informuar Muhamedi a.s., i cili ka thënë: *“Agjëroni, atëherë kur ta shihni hënën, dhe përfundojeni agjërimin, atëherë kur ta shihni atë, ndërsa nëse ajo nuk duket, atëherë plotësojeni muajin Shaban tridhjetë ditë.”*² Nëse në ditën e 29 shihet Hëna, të nesërmen duhet agjëruar. Gjithashtu, Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Mos agjëroni derisa ta shihni hënën, dhe qëndroni agjërueshëm derisa ta shihni atë, nëse nuk duket nga turbullira e qiellit, përcaktojeni atë.”*³

- **Duke plotësuar muajin Shaban tridhjetë ditë**

Nëse nuk duket Hëna në përfundim të ditës së 29, ose në natën e ditës së 30, pasi që në kalendarin hënor nata i paraprinë ditës, atëherë plotësohen 30 ditë të muajit Shaban, dhe Ramazani me automatizëm fillon pas ditës së tridhjetë. Muhamedi a.s. në një transmetim tjetër ka thënë: *“...plotësojeni muajin Shaban tridhjetë ditë.”*

- **Përmes llogaritjes astronomike**

Astronomia është shkencë që studion trupat qiellor dhe proceset e tyre. Ajo, në studimet e saj, përdorë metoda shkencore, të cilat tashmë janë shumë të sakta dhe të avancuara. Shkenca e Astronomisë, për një kohë të gjatë në të kaluarën, kishte ngecur së zhvilluari, sepse kisha katolike kishte ndaluar apo edhe ndjekur shkencëtarët e saj. Arsyeja e përndjekjes së tyre, ishte sepse ata sillnin rezultate të ndryshme nga botëkuptimet e saj. Në periudhën e mesjetës, thuajse studiuesit e vetëm të astronomisë ishin myslimanët. Ata nuk i pengonte as feja dhe as shteti që të studionin atë fushë, edhe pse ende nuk pranoheshin rezultatet e studimeve të tyre, pasi që në atë periudhë, shkenca e astronomisë ende nuk ishte e formuar aq sa të bindte dijetarët islam për saktësinë e rezultateve të saj. Në kohët e para të Islamit, nëse do të kërkohej nga myslimanët përcaktimi i muajve, ditëve, e kohëve të namazit, përmes llogaritjes astronomike, do të paralizohej apo vështirësohej kryerja e adhurimeve që ndërliidhen me kohë të caktuar. Kjo si rezultat se astronomët ishin të paktë, por edhe nëse do të gjendeshin njohës të saj, do të ishte e vështirë që studimet e tyre të shpërndareshin te

secili vend dhe familje, për shkak të vështirësive të komunikimit në atë kohë.

Vëmendje: Shkenca e astronomisë nuk duhet ngatërruar me astrologjinë apo me pseudo-shkencat, të cilat mundohen të zbulojnë fatin e njerëzve përmes vërtetimit të lëvizjeve të trupave qiellorë. Astrologjia nuk ka baza apo rregulla shkencore, prandaj më shumë i ngjan metodës së falltarëve, gjë e cila është e ndaluar.

Sot, astronomia është shkencë me rregulla, ligje dhe metoda, të cilat studiohen në institucione arsimore, universitete etj.. Tanimë, rezultatet e llogaritjes së lëvizjeve të trupave, planetëve etj., janë jashtëzakonisht precize, shumë të sakta. Ka precizitet aq të lartë, ku pas dhjetëra viteve mund të tregojë ditën, orën, por edhe minutën e eklipsit dhe saktësisht se cilën pjesë të Tokës e përfshinë etj.. Astronomia me saktësi të madhe tregon lëvizjen e Hënës, Tokës, kur fillon shfaqjen dhe perëndimin e Diellit etj., ajo është shumë më e saktë sesa përpjekja e shikimit të hënës me sy.

Imam Es Subkiju, i cili ka vdekur në vitin 756 hixhri, ka thënë: “Saktësia e llogaritjes astronomike është e prerë, ndërsa dëshmia e dëshmitarëve është e diskutueshme. Diçka që është e diskutueshme nuk mundet të ketë prioritet para asaj të padiskutueshmes, e assesit t’i jepet përparësi, prandaj nëse dikush thotë se kam parë hënën dhe llogaritja astronomike e dëshmon të kundërtën, apo anasjelltas, mbështetemi dhe vendosim sipas llogaritjes së astronomisë.”⁴ Nëse Imam Es Subkiju e thotë këtë, para shtatë shekujve, çka do të thoshte sot, nëse do ta shihje këtë zhvillim të jashtëzakonshëm të astronomisë, e cila dëshmon me prova rezultatet e saj. Saktësinë e metodës shkencore të astronomisë, e dëshmojnë studiuesit e saj, myslimanë dhe jomyslimanë. Dijetari i njohur shqiptar, Shuajb el Arrnauti, në njërin prej ligjëratave të tij ka thënë: “E kam parë një shqiptar nga Siria, i cili ka përgatitur një kalendar për rreth 400 vitet e ardhshme, preciziteti i të cilit studim i kishte lënë përshtypje të jashtëzakonshme. Por fatkeqësisht, ai kalendar dhe studimi i tij ishin shkatërruar nga faktori njeri.”⁵ Nëse një hulumtim individual me mjete individuale dhe primitive, është aq i saktë, atëherë sa është preciziteti i rezultateve të astronomisë përmes satelitëve, të cilët në mënyrë të vazhdueshme vëzhgojnë dhe regjistrojnë çdo lëvizje përrreth nesh, por edhe të kozmosit në tërësi?!

Dijetari i njohur bashkëkohor, Ahmed el Xhemali, tregon se një marinar mysliman i devotshëm i kishte thënë: “Preciziteti i kohëve është me sekonda, gjë e cila në njohim shumë mirë, pasi që natyra e punës sonë ndërlidhet me precizitet kohor.”⁶ Llogaritjen astronomike për përcaktimin e kohëve e pranojnë shumë prej dijetarëve bashkëkohorë.

“Saktësia e llogaritjes astronomike është e prerë, ndërsa dëshmia e dëshmitarëve është e diskutueshme.

Imam Es Subkiju

Hadithet e lartcekura, nuk ndalojnë përdorimin e metodave të tjera, nëse profesionalistët e fushës së tyre dëshmojnë për saktësinë e tyre. Nëse dijetarët islamë janë unifikuar për një normë juridike, mbyllet mundësia e diskutimit të saj. Mendimet që atakojnë atë, nuk konsiderohen fare dhe pranimi i tyre është i pamundshëm. Por, nëse konsensusi i këtyre dijetarëve ndërlidhet me ndonjë shkak specifik, atëherë, me ndryshimin e shkakut, jo vetëm që do të diskutohet çështja, por me ndryshimin e shkakut ndryshon edhe norma juridike e saj. Kjo rregull është e padiskutueshme në të drejtën islame. Shkaku i mos pranimit të llogaritjes astronomike ka qenë pamjaftueshmëria e saktësisë së saj. Prandaj, nëse sot, saktësia e

arritjeve astronomike është e pakontestueshme, edhe veprimi me të është i pakontestueshëm, dhe mbështetja dhe përfitimi nga ajo, duhet të jetë e pakontestueshme. Llogaritja shkencore astronomike, më nuk është e dyshimtë, përkundrazi ajo është më e saktë sesa shikimi i Hënës me sy. Njeriu mund të gaboj, hutohet apo mashtrohet nga lëvizjet që i sheh apo nuk i sheh në horizont.

Shqetësim: Nëse llogaritja astronomike është aq e saktë, atëherë pse ndodh që studiuesit e astronomisë të thonë që ka filluar muaj i ri hënor, por shikimi i hënës është i pamundur? Këtë përgjigje e shpjegon prof. dr. Sheref el Kudah, në punimin e tij shkencor ku thotë: “Sipas konsensusit të njohësve të Astronomisë, saktësia e llogaritjes astronomike është e pakontestueshme.” Gjatë shpjegimit, ai thotë: “Hëna nuk mund të shihet me sy para 15 orëve, dhe mund të zgjasë deri pas 30 orëve pas lindjes së saj. Sigurisht se përmes



teleskopit mund të jetë pak më shpejtë, por jo para 12 orëve pas lindjes. Shkaku i mos dukjes së Hënës në këtë interval kohor, pas lindjes së saj, është sepse Toka gjendet në mes të Diellit dhe Hënës, si rezultat i së cilit pozicion, rrezet e Diellit nuk arrijnë në Hënë, dhe ato rreze nuk do të mund të reflektojnë në Tokë, prandaj edhe nuk duket Hëna. Kjo do të vazhdojë derisa Hëna të devijon aq sa rrezet e Diellit të arrijnë Hënë, të cilat do të reflektojnë në Tokë, dhe do të mund të shihet Hëna.”⁷ E njëjta gjë ndodhë edhe kur muaji është në procesin e përfundimit të tij, ku disa orë para përfundimit nuk ka mundësi të shihet Hëna.

Kurse hadithi: “*Ne jemi popull analfabet, nuk dimë të shkruajmë dhe as të llogarisim, muaji është njëzet e nëntë ditë apo tridhjetë ditë*”⁸, nuk nënkupton që Muhamedi a.s. e ka ndaluar llogaritjen astronomike, dhe se një gjë e tillë është e pa saktë dhe e keqkuptuar. Prandaj, kuptimi i hadithit duhet të bëhet në dritën e disa parimeve:

Hadithi pasqyron gjendjen arsimore të arabëve, në atë kohë. Zoti xh.sh. në Kuran tregon se arabët si komunitet ishin analfabetë, ku thotë: “*Allahu është Ai që u solli analfabetëve një të Dërguar nga gjiri i tyre...*” (El Xhumua, 2).

Kur pasqyrohet gjendja, assesi nuk kuptohet se duhet të vazhdohet në atë gjendje. Zoti xh.sh. në shumë ajete ka potencuar rëndësinë e diturisë, sa që ajeti i parë që ka zbritur, ka urdhëruar për lexim - mësim. Muhamedi a.s. në mundësinë e parë, kishte investuar në dituri, dhe atë përmes lirim të robërve të luftës, duke ju kushtëzuar që t’ua mësojnë shkrimin 10 veta prej myslimanëve.⁹ Ky shërbim, ishte pagesë aq e vlefshme, sa që dhuronte lirinë e jetës, edhe pse ata mësues e luftonin Islamin, ata e gëzuan këtë benifit.

Objekti i këtij hadithi është që t’u thotë myslimanëve se përderisa jemi shoqëri analfabetësh, përcaktoni kohët e adhurimeve me shikime të hënës, apo plotësimin e muajve 30 ditë. Kjo ishte lehtësim, pasi që pranohej përdormi i metodave që posedonin.

Hadithi nuk ndalon mësimin, ai nuk ndalon as llogaritjen astronomike. Zoti xh.sh. në Kuran thotë: “*Allahu e ka bërë Diellin burim drite, kurse Hënë e ka bërë të shkëlqejë, që ju të dini numrin e viteve dhe njëhësimin e kohës...*” (Junus, 5).

Kështu që llogaritja kohore është e kërkuar. A nuk është trashëgimia e tëra e ndërtuar në llogarinë e numrave?! Si të jetë llogaritja e ndaluar? Ajo që kërkohet në llogaritje është të jetë e saktë, nëse saktësia është në nivel apo e sigurt, duhet shfrytëzimi i kësaj mundësie.

Fjala رؤية - رأى - në gjuhën e Kuranit ka kuptimin shikim, njohje, e cila arrihet përmes zemrës, mendjes dhe syrit. Zoti xh.sh. në Kuran ka thënë: “*A nuk e ke parë çfarë bëri Zoti yt me poseduesit e elefantëve*” (El Fil, 1). Folja رأى prej رؤية - në gjuhën e Kuranit d.m.th.: “*A nuk e ke parë, dëgjuar?*” Në kuptim real, Zoti xh.sh. po thotë: “*A nuk e ke dëgjuar informacionin, përmes së cilit e ke kuptuar aq qartë, sikurse*

me pa me sy, se si ka vepruar Zoti me poseduesit e elefantëve.”¹⁰ Folja: “parë”, ka për objektiv dëgjimin apo kuptimin.

Gjithashtu, në njërin nga transmetimet e haditheve të theksuara më lartë, thuhet: “*Nëse Hëna nuk duket nga turbullirat e qiellit, përcaktojeni atë*.” Përcaktimi përfshin edhe llogaritjen. Prandaj, nëse do të kuptohet se kur fillon Ramazani, nuk është e rëndësishme rruga që përdoret. Përveç se, ajo duhet të jetë shkencore dhe e saktë, në mënyrë që të mos gabohet. Muhamedi a.s., në disa raste ka vepruar sipas fjalëve të sahabëve, si p.sh. në luftën e Bedrit, në përzgjedhjen e pozicioneve të luftës, ka vepruar sipas fjalës së El Habab bin el Mundhirit. Në betejën e Hendekut, që të hapet hendeku, veproi sipas fjalës së Selman el Farisiut. Muhamedi a.s. ka thënë: “*Ju jeni më të ditur se unë për çështjet që nuk janë fetare*.”¹¹

Koha e syfyrit? Fillimisht duhet të potencohet që përcaktimi i kohës së imsakut, është kompetencë e institucionit, i cili vepron në bazë të argumenteve islame dhe nxjerrë konkluzë unifikuese për myslimanët e vendit. Lidhur me këtë çështje, Muhamedi a.s. ka thënë: “*Vërtet ezani i Bilallit është natën, hani dhe pini derisa të dëgjoni ezanin e Ibën ummi Mektumit*.”¹² Pejgamberi a.s. nuk kishte kërkuar që çdokush të stopohet nga ushqimet sipas vlerësimit të tij. Ai, urdhëronte që ata të fillojnë agjërimin me ezanin e Ibën ummi Mektumit, të cilin Muhamedi a.s. e kishte angazhuar për thirrjen e ezanit, e që thirrej me kohën e imsakut. Ata vepruan sipas udhëzimit të Muhamedit a.s., ata nuk ishin të pavëmendshëm ndaj ajetit: “*...Hani e pini derisa të dallohet fja e bardhë (bardhësia) e agimit nga fja e zezë (errësira e natës)...*” (El Bekare, 187). Nga kjo kuptojmë se syfyri zgjat derisa të duket, dallohet bardhësia e ditës nga ajo e natës. Zoti xh.sh. në Kuran nuk ka thënë derisa të shfaqet apo qartësohet ajo, por ka thënë derisa të dallohet bardhësia e ditës nga ajo e natës. Një sahabi i kishte thënë Muhamedit a.s.: “*Unë vendosi nën jastëk dy penj, që të dalloj natën prej ditës. Pejgamberi a.s. kishte thënë: “Jastëku, (nata) jote qenka e gjerë. Vërtet ajo është dallimi mes errësirës së natës nga zbardhimi i ditës.”*”¹³ Prandaj, shkëndijat e para të zbardhimit të ditës janë kufiri i fundit i lejimit të ushqimit dhe njëkohësisht fillimi i agjërimit.

Pretendimi që përcaktimi i kohës së imsakut është para kohës, dhe se është legjitime ngrënia dhe pirja edhe pas imsakut, është gabim dhe tejet e rrezikshme, keqkuptim i fesë dhe mos respektim i kohëve të përcaktuara nga autoriteti institucional. Kjo shfaq turbullira dhe çrregullime shoqërore, të cilat kanë arritur të depërtojnë edhe në mes familjeve, ku disa anëtarë të familjes vazhdojnë të hanë e pinë, e disa të tjerëve, nëse nuk ju ka përfunduar koha e imsakut, kanë mbetur pa syfyri, pa ushqim! Kjo formë e veprimi, jo vetëm që prish agjërimin e tyre që hanë pas imsakut, por edhe ndikon në prishjen e agjërimit edhe të të tjerëve, apo të paktën krijon përçarje në familje, nëse jo në familje, atëherë në shoqëri, e të cilat çrregullime, aspak nuk na duhen. Është e çuditshme se si njerëzit kanë guximin të veprojnë ashtu,

dhe sikurse nuk mjaftohen me këtë, ata ftojnë edhe të tjerë në këtë veprim, i cili në rastin më të mirë është i dyshimtë. Veprimi i tyre paraqet shprehjen apo të kuptuarit, se ai di atë që të tjerët nuk e dinë!¹⁴ Enesi r.a. tregon që mes syfyrin – imsakut - dhe faljes së namazit të sabahut me Pejgamberin a.s., lexonim prej 50-60 ajete të Kuranit.¹⁵ Leximi i këtyre ajeteve dhe faljes së synetit merr së paku 20 minuta.

Koha e iftarit: Në citatin që tregohet koha e syfyrin, potencohet edhe koha e iftarit, konkretisht deri në cilën kohë duhet të vazhdojë agjërimi. Zoti xh.sh. thotë: *“...pastaj, plotësojeni agjërimin derisa të bie errësira...”* (El Bekare, 187). Agjërimi plotësohet kur perëndon Dielli. Nuk mjafton humbja e shikushmërisë së Diellit, përderisa ende nuk ka perënduar. Pejgamberi a.s. na tregon se kur bie errësira, realisht plotësohet edhe agjërimi. Ai thotë: *“Nëse nata ka filluar nga lindja dhe përfundon dita nga perëndimi, duke perënduar Dielli, le të bëjë iftar agjëruesi.”*¹⁶

Për të konkluduar se Dielli ka perënduar dhe duhet të bëhet iftar, hadithi kushtëzon këto elemente:


Fillimi i natës nga lindja. Ky është një kusht shumë i rëndësishëm, të cilin e potencon ajeti kur thotë: *“...deri sa të bie errësira...”*.

Përfundimi i Diellit nga perëndimi. Hadithet e shpjegojnë njëra-tjetrën, në një version tjetër thotë: *“Mos dukja e Diellit”*, të cilin e sqaron transmetimi tjetër, kur thotë: *“Perëndimi i Diellit”*, kur perëndon Dielli, sigurisht që nuk duket më. Por nëse Dielli nuk duket, nuk do të thotë se ka perënduar, prandaj duhet të përdorej versioni që përfshihen të dy transmetimet, mos dukjen dhe perëndimin e Diellit, kështu bie errësira. Përmes bashkimit të versioneve të hadithit, nuk përjashtohet asnjë transmetim, dhe hadithet do të jenë në pajtueshmëri me Kuranin.

Perëndim i Diellit, jo fshehje e tij pas kodrave apo maleve, por të perëndojë në horizont, në mënyrë që të bie errësira, ashtu si e ka përshkruar Kurani.¹⁷

Porosi të Muhamedit a.s.: *“...Ai që ruhet nga të dyshimtat, ka ruajtur pastërtinë e fesë dhe nderit të vet, kurse ai që vepron të dyshimtat, veçse ka rënë në haram...”*¹⁸. Gjithashtu ka thënë: *“Lëri gjërat e dyshimta, duke kaluar tek ato që nuk janë të dyshimta.”*¹⁹ Pyete zemrën tënde, si duhet të veproni. Të pasoni institucionin, të siguronit adhurimet, duke ndërprerë ushqimet e pijet në kohën që te të gjithë është e pranuar, apo, të përfundoni në teoritë e pretendimeve individuale, që zakonisht barten nëpër shoqëri dhe janë pa studim e analizë dhe pa referencë. Qasjen që secili të caktojë kohën e syfyrin, iftarit etj., e refuzojnë shumica absolute e dijetarëve.

Vëmendje: Nëse paraqitet ndonjë transmetim nga gjeneratat e para, ndryshe nga ky koncept, ai nuk është më i fuqishëm se këto argumente të paraqitura, ose duhet të sqarohen në frymën e këtyre ajeteve dhe haditheve, por assesi nuk duhet të atakohen mes vete, pasi që nuk ka kundërthënie në shpalljen e Zotit xh.sh..



Përfundimi i Ramazanit, kalimi në muajin Sheval, konkretisht shpallja e Bajramit, bëhet në formë të përafërt me atë të shpalljes së Ramazanit. Veçse në asnjë rrethanë nuk lejohet agjërimi i kësaj dite. Kështu arrihet uniteti i shoqërisë, gjë të cilën shumë e do i Madhi Zot xh.sh..

- 1 Err Rrazi, Husamudin, *Hullasatu ed Delail ve Tenkih el Mesail fi Sherh el Kuduri*, Jordan-Amman, Der el Feth, 2016, vëll. 1, fq. 573-574.
- 2 El Buhari, Muhamed bin Ismail, *Sahih El Buari*, Dar Ibën Kethir, Dar el Jemameh 1993, vëll. 1, fq. 574, nr. 1810.
- 3 Muslim ibn el Haxhaxh en Nejsaburi, *Sahih Muslim*, Kajro, Matba Isa el Babi el Halebij ve Shurakeuhu, 1995, vëll. 1, fq. 759, nr. 1080.
- 4 Es Subkij, Tekijudin, *Fetava Es Subkij*, Egjipt, Dar el Mearif, vëll. 1, fq. 209.
- 5 Jordan, Amman, lagjia Medinetu err Rrijadije, në shtëpinë e tij, viti 2015.
- 6 El Hamevij, Ahmed el Xhemal, *El Ihbar Bivakt El Imsak Biliftar*, Jordan-Amman, Dar Linesher ve et Tvezu, 2014, fq. 53-54.
- 7 El Kudah, prof. dr. Sheref, *Mexheletu Dirasat*, El Xhama el Urdunijeh, vëll. 26, nr. 2, 1999, fq. 17-18.
- 8 Buhari, *Sahih El Buhari*, vëll. 2, fq. 575, nr. 1814. Muslimi, *Sahih*, vëll. 2, fq. 761, nr. 1080.
- 9 Hanbel, Ahmed bin, *Musnedi i Ahmed ibn Hanbelit*, Bejrut, Mesesetu er Rrisaleh 2001, vëll. 4, fq. 92. 2216. Hadithi i saktë.
- 10 En Nesefij, Abdullah bin Ahmed, *Medarik et Tenzil ve Hakaik et Tevil*, Dar el Kalem et Tajib 1998, vëll. 3, fq. 580.
- 11 Muslim, *Sahih Muslim*, vëll. 4, fq. 336, nr. 2363.
- 12 Muslim, *Sahih Muslim*, vëll. 2, fq. 768, nr. 1092.
- 13 Muslim, *Sahih Muslim*, vëll. 2, fq. 766, nr. 1090.
- 14 El Hamevij, *El Ihbar Bivakt El Imsak Biliftar*, fq. 67.
- 15 El Buhari, *Sahih el Buhari*, vëll. 1, faq. 210, nr. 550.
- 16 El Buhari, *Suahih el Buhari*, vëll. 2, fq. 591, nr. 1853.
- 17 El Hamevij, *El Ihbar Bivakt el Imsak Biliftar*, fq. 42-43.
- 18 Muslim, *Sahih Muslim*, vëll. 3, fq. 219. Nr. 1599.
- 19 El Buhari, *Sahih el Buahri*, vëll. 2, fq. 724. Nr. 1946.

Dispozita për agjëruesen e Ramazanit

Dr. Violeta Smajlaj



Agjërim quajmë të përmbajturit gjatë ditës nga ngrënia, pirja dhe marrëdhëniet intime bashkëshortore, me nijet për të adhuruar Zotin.¹

Agjërimi i muajit Ramazan është detyrë individuale - farz ajn -² për çdo myslimane me mend dhe të moshërritur, që është me shëndet të mirë dhe jo në udhëtim, e lirë nga pengesat e natyrshme si menstruacionet dhe lehonja. Kjo nënkupton se kushtet e obligueshmërisë së agjëritit të Ramazanit për një myslimane janë pesë:

1. mendja e shëndoshë, sepse njeriu me të meta mentale nuk ka detyrë fetare;
2. puberteti, pasi fëmijët nuk obligohen me përgjegjësi fetare;
3. shëndeti fizik, ngase i sëmuri ka arsye me vete për të mos agjëruar nëse këtë ia kërkon mjeku i besueshëm;
4. të jetë në vendbanimin e vet, se udhëtari ka rrethana lehtësuese për të mos agjëruar;
5. pastërtia nga ciklet-gjakrat e natyrshme, si menstruacioni dhe lehonja.

Për të qenë dispozitat e agjëritit, që dalin nga këto kushte, sa më të qarta për femrën myslimane, do të shqyrtojmë në vijim disa detaje të fikhut lidhur me agjërimin në Ramazan.

HYRJA NË PUBERTET GJATË RAMAZANIT

Periodha e pubertetit është pikënisje e përgjegjësisë fetare për njeriun. Në qoftë se gjatë Ramazanit një e mitur arrin pubertetin, atëherë ajo është mirë të përmbahet nga gjithçka e prishë agjërimin (imsak) në pjesën e mbetur të ditës, në mënyrë që t'i ngjasojë agjëruesve. Mirëpo, ajo e ka të lejuar të mos agjërojë pjesën e mbetur të ditës, përderisa dita ka filluar pa e pasur obligim agjërimin.³ Gjithashtu, meqenëse është bërë e përgjegjshme për detyrat fetare nga çasti i hyrjes në pubertet, ajo nuk ka pse t'i kompensojë ditët e Ramazanit që i kanë kaluar pa i agjëruar, sepse deri në atë çast nuk e ka pasur obligim të agjërojë.

PARAQITJA E MENSTRUACIONEVE GJATË AGJËRIMIT

Paraqitja e menstruacioneve te vajzat është një fenomen i natyrshëm, që e bën atë të hyjë në fazën e pubertetit, duke e bërë përgjegjëse drejtpërsëdrejti për urdhrat dhe ndalesat fetare. Mirëpo, paraqitja e menstruacioneve te femra myslimane, e obligon atë ta ndalë agjërimin dhe faljen e namazit. Dijetarët myslimanë njëzëri janë pajtuar se gruaja me menstruacione nuk lejohet të agjërojë e as të falet. Ebu Seid el Khudri r.a. tregon se Pejgamberi, paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të!, ka thënë: "...kur gruaja ka menstruacione nuk agjëron e as nuk falet."⁴



Nëse cikli menstrual ose gjaku i lehonisë i paraqitet një gruaje në një ditë Ramazani, sado pak çaste para perëndimit të diellit, atëherë ajo e ndërpret agjërimin dhe mund të hajë e të pijë përgjatë kësaj kohe, ndërkohë që ditët e humbura i agjëron më vonë si kompensim-kaza. Nuk ka nevojë që të abstenojë (imsak) për t'i ngjasuar grave që agjërojnë, për arsye se agjërimi në këtë periudhë për të është haram dhe përngjasimi me diçka haram është në vetvete haram.⁵

NDËRPRERJA E MENSTRUACIONEVE PAS AGIMIT

Nëse gruaja pastrohet nga menstruacionet, pra i ndërpriten ato para fillimit të agimit, obligohet të bëjë nijetin dhe të agjërojë.

Agjërimi i saj konsiderohet i vlefshëm edhe nëse ajo ende nuk është larë, nuk ka bërë gusël nga menstruacionet, sepse këtë mund ta bëjë edhe pas agimit.

Nëse menstruacionet ndërpriten pas agimit, gjatë ditës së Ramazanit, atëherë ajo grua duhet të përmbahet nga gjithçka e prishë agjërimin përgjatë pjesës tjetër të ditës, si përngjasim me agjërueset e tjera, meqenëse arsyeja për mos agjërim ka përfunduar.⁶

LEHONIA (NIFASI)

Lehoni quajmë periudhën e gjakderdhjes, pas lindjes së fëmijës ose abortit. Kur një grua lind fëmijë gjatë Ramazanit, nëse ajo ka qenë duke agjëruar, e ndërprejnë menjëherë agjërimin, ngase edhe ashtu në këtë situatë, agjërimi i saj i është prishur, e pastaj i kompenson më vonë ditët e pa agjëruara - humbura.

Nëse periudha e lehonisë mbaron në Ramazan,⁷ atëherë ajo merr gusël, pastrohet dhe agjëron pjesën e mbetur të muajit. Nëse ndërprerja e lehonisë ka ndodhur vetëm një moment para agimit, mjaftueshëm sa për të bërë nijetin e agjërimin nga nata, atëherë agjërimi i asaj dite është i saktë dhe nuk kompensohet. Përndryshe, nëse ndërprerja ndodhë gjatë ditës së Ramazanit, pas agimit deri në perëndim, asaj i mbetet detyrë ta kompensojë më vonë atë ditë të humbur, edhe pse obligohet të përmbahet (imsak) gjatë asaj dite nga gjithçka e prishë agjërimin, si nderim ndaj kohës dhe për shkak se arsyeja për mos agjërim është ndërprerë.

Në rast aborti, nëse fetusi i abortuar e ka marrë formën e njeriut sa t'i dallohen koka dhe disa nga gjymtyrët, gjakderdhja në këtë rast merr të njëjtën dispozitë sikur të lehonisë (nifasit) dhe myslimania nuk agjëron gjatë periudhës sa është lehonë. Përndryshe, nëse fetusi nuk është formuar, gjaku i cili rrjedh pas abortit llogaritet hajz, cikël menstrual, nëse është tri ditë

Paraqitja e menstruacioneve te femra myslimane, e obligon atë ta ndalë agjërimin dhe faljen e namazit.

deri në dhjetë, e nëse është më pak se tri ditë llogaritet gjakderdhje e çrregullt (isihada), prandaj abortuesja agjëron dhe kryen obligimet e tjera fetare duke marrë abdes për çdo namaz, e nuk e pengon agjërimin gjakderdhja e shkaktuar nga aborti e atij fetusi të pa formësuar.⁸

GJAKDERDHJA JO MENSTRUALE (ISTIHADA)

Femra që ka gjakderdhje jo menstruale, obligohet të agjërojë dhe të falet, e për të nuk vlen dispozita e menstruacioneve. Dallimi ndërmjet gjakut të menstruacioneve dhe gjakut të istihadës është në atë se, gjaku i periudhës së menstruacioneve konsiderohet gjakderdhje e zakonit dhe e shëndetshme te femra, kurse gjaku istihada është gjakderdhje

e pazakontë dhe jo e shëndetshme që kërkon trajtim mjekësor, sikur gjakderdhja nga hunda për shembull.⁹ Prandaj, në rastin e istihadës nuk zbatohen dispozitat e gruas me menstruacione.

Çdo gjakderdhje përtej periudhës së menstruacioneve, tri deri në dhjetë ditë, është e pazakontë dhe si e tillë ka dispozitë të veçantë për të cilën flet hadithi i transmetuar nga Aisheja r.a. ku thotë: "Erdhi te Resulullahu a.s. Fatimeja, e bija e Ebu Hubejshit dhe e pyeti: "O i Dërguari i Zotit, unë vazhdimisht kam rrjedhje gjaku dhe kurrë nuk ndërpritet, a thua vallë ta lë namazin pa e falur? Tha: "Jo, ky është gjak që vjen nga venat (nuk është gjak i menstruacioneve). Faljen e namazit do ta lësh vetëm aq sa zgjasin ditët e menstruacioneve në kohë normale. Kur të përfundon koha e tyre, pastrohesh prej gjakut dhe falesh." Urve, transmetuesi i hadithit nga Aisheja, ka thënë: "Pastaj, merr abdes për çdo namaz deri të të vijë koha e zakonshme e menstruacioneve."¹⁰

MOS AGJËRIMI I GRUAS SHTATZËNË OSE GJIDHËNËSE

Në qoftë se një grua shtatzënë apo gjidhënëse ka frikë për shëndetin e vet apo të fëmijës së saj nëse agjëron, siç është pakësimi i qumështit si pasojë e mosushqimit të rregullt, atëherë ajo e ndërpret agjërimin për ta kompensuar aq ditë më vonë - kaza dhe nuk obligohet të agjërojë më tepër diçka si masë ndëshkimore - keffare, sepse e ka prishur me arsye, e as të paguajë fidje-shpagim, sepse foshnja e cila është arsyeja e mos agjërimin nuk obligohet me agjërim. Ky rast dallon prej të moshuarve, sepse këta obligohen me agjërim dhe në rast se nuk kanë mundësi për të agjëruar mjafton të shpagojnë këtë obligim duke paguar fidjen.¹¹

Nëse gruaja qëndron mirë me shëndet dhe dëshiron të agjërojë, rekomandohet të konsultohet me doktor të besuar, i cili e njeh rëndësinë e agjërimin të muajit Ramazan, sepse



shpesh ndodhin ekzagjerime në këtë drejtim, sugjerime për ndërprerjen e agjërimit pa pasur nevojë.

Nëse gruaja gjidhënëse vendosë të agjërojë, ajo këshillohet të ushqehet mirë gjatë mbrëmjes deri në syfyr, me ushqim të pasur me proteinë, nga qumështi dhe produktet e tij, në mënyrë që fëmija të ketë mjaftueshmëri të të ushqyerit dhe nëna të qëndrojë e fortë gjatë ditës së agjërimit.

MARRJA E PILULAVE PËR PENGIMIN OSE VONIMIN E CIKLIT MENSTRUAL

S'do mend se agjërimi i plotë i muajit Ramazan në kohen e vet kur të gjithë janë agjërueshëm, është më e preferuar për femrat, se sa ndërprerja e agjërimit dhe kompensimi i ditëve të humbura për shkak të ciklit. Andaj, për të mos ndërprerë agjërimit është analizuar mundësia e pengimit ose vonimit të ciklit me anë të medikamenteve përkatëse.

Më parësore është mos marrja e tyre, për shkak të dëmit të mundshëm shëndetësor, kjo duke u bazuar në përvojat e grave, ku në të shumtën e rasteve mund të shkaktojë çrregullime të vazhdueshme të ciklit, të cilat nuk normalizohen për një kohë të gjatë. Pranimi i gjendjes natyrore, duke prishur agjërimit gjatë ciklit për t'i kompensuar më vonë ditët e humbura, në pajtim me rregullin e natyrshëm, është adhurim në vete, duke shtuar faktin se as nënat e besimtarëve nuk e kanë bërë këtë, ndonëse një intervenim i tillë ka qenë i njohur në mjekësinë popullore, madje vetë Aisheja r.a. ka qenë një përpunuese e barnave.

Nuk duhet të krahasohet Ramazani me haxhin, ngase haxhi është mundësi një herë në jetë për shumëkënd dhe udhëtim i vështirë për t'u realizuar, andaj gjatë asaj kohe është edhe e arsyeshme marrja e pilulave të tilla.

Por, nëse ndodhë që një grua t'i ketë marrë pilulat, agjërimi është i saktë. Ruajtja e jetës së shëndetshme është qëllim i Sheriatit në shumë dispozita, prandaj lënia e gjërave në rrjedhën e tyre natyrore mbase është më së miri. Afërsia me Allahun arrihet nëpërmjet njetit të sinqertë dhe përkushtimit në adhurim sipas rregullit.

SHIJIMI I USHQIMIT GJATË PËRGATITJES

Nuk ka asgjë të keqe që një agjëruese ta shijojë ushqimin nga nevoja për ta ditur shijen, por që këtë e bën me kujdes, merr pak nga ushqimi, pastaj e nxjerrë jashtë dhe shpërlanë gojën, e nëse mundet pa e provuar, kjo është edhe më mirë.

Në qoftë se agjëruesa shijon diçka ushqyese me gojë gjatë përgatitjes së ushqimit, ky veprim nuk e prishë agjërimit, përdërisa ushqimi i shijuar nuk ka hyrë në fyt apo në brendësi të trupit, edhe pse një veprim i këtillë konsiderohet i papëlqyeshëm mekruh tenzihen, nga frika se një tundim i tillë mund të çojë drejt prishjes së agjërimit. Kjo dispozitë vlen edhe për gruan që përtypë ushqimin për foshnjën e saj, përdërisa ka mundësi që ta shmangë një veprim të tillë.¹²

PËRFUNDIM

Shtruarja e ushqimit për agjëruesit dhe shërbimi për familjarët gjithmonë është i lavdëruar. Në muajin e bekuar Ramazan, gruaja myslimane zakonisht kryen ibadete shtesë nga të tjerët, pasi që ajo vullnetarisht shton kujdesin për familjarët për t'u siguruar se të gjithë ushqehen shëndetshëm në iftar dhe syfyr, për të përballuar lehtësisht agjërimit dhe teravitë. Me këtë kujdes të shtuar për agjëruesit e tjerë, ajo ka shpërblim të madh te Zoti i Madhëruar. I Dërguari i Zotit ka thënë: *"Shtroji ushqim, përhapni paqen (selamin) dhe faluni natën derisa njerëzit janë duke fjetur, do të hyni në Xhenet në paqe."*¹³

1 El Merginani, Ali bin Ebubekr, El Hidajeh fi sherhil-bidajeh, (red. Talal Jusuf), Beirut: Daru Ihjait-turath el Arabi, 1/120.

2 Agjërimi i Ramazanit është farz në bazë të fjalëve të Zotit në Kuran: *"O besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi..."* (El Bekare, 183).

3 El Merginani, El Hidajeh fi sherh El Bidajeh, 1/126.

4 Transmeton Buhariu, Muhamed bin Ismail, Es Sahih, (red. Mustafa El Buga), Damask: Daru Ibni Kethir ue Darul Jemame, bot. 5, 1993, 1/116 nr. 298 dhe 2/689 nr. 1850. Shih, gjithashtu, El Kushejri, Muslim bin Haxhxhaxh, Es Sahih, (red. Muhamed Fuad Abdullbaki), Kairo: Matbeatu Isa el bab el halebi ue shurekahu, 1955, 1/86 nr. 79.

5 El Merginani, El Hidajeh fi sherh El Bidajeh, 1/126.

6 El Merginani, El Hidajeh fi sherh El Bidajeh, 1/126.

7 Nuk ka limit minimal kohor të pastrtisë pas lehonisë, pra nëse pas dy javësh ndërpritet gjakderdhja, gruaja është e pastër dhe fillon të agjërojë e të kryejë obligimet e tjera. Mirëpo, nëse gjakderdhja vazhdon përtej dyzet ditëve, atëherë ajo konsiderohet gjakderdhje e çrregullt (istihada), sepse periudha maksimale e lehonisë (nifasit) është deri në dyzet ditë.

8 El Ajni, Mahmud bin Ahmed, El Binajeh sherh El Hidajeh, (red. Ejmen Shaban), Beirut: Darul kutubil ilmijje, bot. 1, 2000, 1/689.

9 El Ajni, El Binajeh sherh El Hidajeh, 1/689.

10 Buhariu, Es Sahih, 1/91 nr. 226 dhe El Kushejri, Es Sahih, 1/262 nr. 332. Në këtë rast, abdesi për namaz nuk duhet të merret para hyrjes së kohës së namazit dhe është e pëlqyer që para marrjes së abdesit të lahet organi gjental, si dhe të vendoset pambuk me qëllim që të zvogëlohet prezenca e gjakut.

11 El Merginani, El Hidajeh fi sherh El Bidajeh, 1/124.

12 El Merginani, El Hidajeh fi sherh El Bidajeh, 1/123.

13 Transmeton Tirmidhiu, Muhamed bin Isa, El Xhamiul Kebir, (red. Beshshar Avvad Maruf), Beirut: Darul Garb el Islami, bot. 1, 1996, 4/652 nr. 2485 dhe El Kazvini, Muhammed Ibnu Maxheh, Es Sunen, (red. Shuajb El Arnauti dhe të tjerë), Beirut: Dar Err Rrisaletil Alemijje, bot. 1, 2009, 2/360 nr. 1334. Tirmidhiu e vlerësoi si hadith hasen sahih.

Agjërimi në vendet që kanë gjatësi të disbalancuar të ditës e të natës

Bashkim Aliu

HYRJE

Agjërimi në kuptimin e kohës, lidhet me imsakun (fillimin) dhe iftarin (përfundimin). Një aspekt i rëndësishëm, e që është edhe temë debati për agjërimin, është kohëzgjatja e ditës e cila agjërohet në Ramazan. Me fjalë të tjera, ardhja e muajit Ramazan, e hap edhe debatin për agjërimin në vendet që kanë gjatësi të disbalancuar të ditës dhe natës, siç janë vendet në veri të Evropës, gjegjësisht vendet skandinave, Kanadaja, etj.. Myslimanët janë të shpërndarë në të gjitha anët e botës, dhe në çdo kontinent ka bashkësi myslimane, ashtu që është edhe e pritshme që të diskutohen probleme përkitazi me agjërimin, të cilat ngrihen nga këto bashkësi, si rezultat i kushteve dhe rrethanave specifike në vendin ku ata jetojnë.

Debati për agjërimin në vendet në fjalë, gjen mbështetje në trashëgiminë pejgamberike, pasi i Dërguari i Zotit, kur ka folur për Dexhallin, ka thënë se do të qëndrojë në botë dyzet ditë, ashtu që dita e parë do të jetë sa një vit, e dyta sa një muaj, e treta sa një javë, dhe ditët e tjera si ditët e zakonshme. Kjo i ka shtyrë disa që ta pyesin të Dërguarin e Allahut se në këtë rast, si t'ia bëjnë me namazin, dhe a mjaftojnë vetëm pesë namaze? Ai u ka thënë se nuk mjaftojnë vetëm pesë namaze, por do të duhet të bëjnë llogari.¹ Kjo përgjigje merret si element i rëndësishëm në përgjigjen për agjërimin në vendet ku disbalansimi i ditës dhe i natës është i theksuar, pasi edhe agjërimi është adhurim i obliguar sikurse namazi, dhe si rrjedhojë e kësaj, edhe agjërimi, sikurse namazi, lidhet me kohë në kuptim të fillimit dhe mbarimit.

Ardhja e muajit Ramazan, e hap edhe debatin për agjërimin në vendet që kanë gjatësi të disbalancuar të ditës dhe natës.

NDARJA E ZONAVE QË KANË DISBALANS TË GJATËSISË SË DITËS DHE TË NATËS GJATË VITIT

Nëse analizohen zonat të cilat kanë një disbalans të theksuar të kohëzgjatjes së ditës dhe të natës në periudha të caktuara të vitit, mund t'i dallojmë tri² zona të këtilla:

Zona ku dita apo nata zgjat njëzetekatër orë, varësisht prej stinës së vitit. Në këto raste, në vendet e këtilla, përlllogariten kohët e namazit, agjërimin dhe adhurimet e tjera në bazë të vendeve më të afërta, ku nata dhe dita dallohen brenda njëzetekatër orëve.

Zona ku nuk humb skuqja e mbrëmjes pas perëndimit të diellit derisa të agojë dita, ashtu që nuk dallohet muzgu i mbrëmjes prej muzgut të mëngjesit, koha e fundit e jaciesë dhe e imsakut për agjërim, si dhe koha e namazit të sabahut në bazë të periudhës së fundit kur këto dy drita dallohen.

Zona ku ka ditë dhe natë gjatë njëzetekatër orëve dhe ku kohët dallohen. Mirëpo, në këto vende, në disa periudha të vitit, nata zgjat shumë, dhe në disa periudha tjera të vitit, dita zgjat shumë.

Në lidhje me këtë ndarje, është replikuar se ka një ngatërrim apo përzierje të nocioneve “ditë” dhe “natë” sipas dy koncepteve: atij juridik islam dhe atij astronomik. Kështu, nëse ridefinohen nocionet “ditë” dhe “natë” sipas konceptit juridik islam, do të konkludojmë se zonat në botë ndahen në dy grupe:

- Zona ku dita sipas konceptit juridik islam, dallohet nga nata sipas të njëjtit koncept;
- Zona ku nuk dallohet dita nga nata sipas kuptimit të këtyre dy nocioneve në të drejtën islame.



Sipas kësaj ndarje të dyfishtë, do të kemi dispozita juridike islame për agjërimin në zona ku kemi ndërrim të dalluar të ditës dhe të natës brenda njëzetekatër orëve, si dhe dispozita juridike islame për agjërimin në zona ku nuk dallohen shenjat e ndërrimit të ditës dhe të natës, apo ka ndërhyrje të kohëve të shenjave të namazit të sabahut dhe të jacisë, për shkak të dallimit jo të qartë të këtyre shenjave nga njëra-tjetra.³

PËRCAKTIMI I ÇËSHTJES DISKUTABILE

Diskutimet e dijetarëve përkthimi me agjërimin në zonat me kohëzgjatje të disbalansuar të ditës dhe të natës në disa periudha gjatë vitit, u referohen zonave ku dallohet qartë nata prej ditës brenda njëzetekatër orëve, por në disa periudha të vitit, dita është shumë e gjatë, dhe në rast të Ramazanit, duhet agjëruar më tepër se 18 orë.

Ndërkaq, në zonat ku nuk dallohen shenjat e ditës dhe të natës sipas konceptit juridik islam, apo shenjat e ditës dhe të natës dallohen, por në disa periudha gjatë vitit, dita zgjat shumë, e në disa periudha të tjera, nata zgjat shumë, është evidente se duhen përllogaritur koha e agjërimit dhe e faljes së namazeve. Dijetarët kanë ndjekur dy rrugë në këtë përllogaritje: Disa mendojnë se përllogaritja duhet bërë në bazë të kohëve të namazeve dhe

Ata që e kanë farz agjërimin në këto vende, duhet të agjërojnë për çdo ditë, prej agimit të ditës e deri në perëndim të diellit në vendin e tyre ku jetojnë, nëse dita dallohet prej natës, dhe dita e nata së bashku zgjatin njëzetekatër orë.

agjërimin në Meke, e disa të tjerë janë të mendimit se përllogariten kohët e namazit, agjërimin dhe adhurimet e tjera në bazë të vendeve më të afërta, ku nata dhe dita dallohen brenda njëzetekatër orëve.⁴

MENDIMET E DIJETARËVE NË LIDHJE ME AGJËRIMIN NË KËTO ZONA

Kjo çështje është bërë temë debati në mesin e dijetarëve të shekujve të fundit,⁵ pasi myslimanët u përballën me këtë problem pas vendosjes së tyre në vendet të cilat kanë zona të këtilla të kohëzgjatjes së disbalansuar të natës dhe të ditës në periudha të caktuara gjatë vitit. Nëse analizohen mendimet e dijetarëve, do të shihet se mund të përmblidhen kryesisht në këto mendime:

Që njerëzit në këto vende të agjërojnë aq orë sa agjërojnë banorët e Mekës, atëherë kur është dita më e gjatë atje. Ata do të çelin iftar kur ta plotësojnë këtë numër orësh, edhe nëse dielli ende nuk ka perënduar. Këtu mund të përmenden dijetarët: Muhamed Abduhu, Reshid Rida,⁶ Mahmud Sheltut, Xhadul Hakk Ali Xhadul Hakk, Abdulatif Hamza, Atijje Sakër, Mustafa ez Zerka, Bessam Xherar, si dhe shumë dijetarë tjerë të Al Az'harit.⁷

Banorët e këtyre vendeve duhet të agjërojnë aq orë sa agjërojnë banorët e vendeve më të largëta që myslimanët kanë

arritur t'i çlirojnë, kur dita është më e gjatë atje, e që nuk e kanë këtë disbalans kaq të madh. Apo, do të agjërojnë sipas kohës së vendeve më të afërta që i kanë, kur dita është më e gjatë, e që nuk e kanë këtë disbalans kaq të madh në kohëzgjatjen e ditës dhe të natës gjatë vitit.⁸

Ata që e kanë farz agjërimin në këto vende, duhet të agjërojnë për çdo ditë, prej agimit të ditës e deri në perëndim të diellit në vendin e tyre ku jetojnë, nëse dita dallohet prej natës, dhe dita e nata së bashku zgjatin njëzetekatër orë. Ata mund të hanë, të pinë dhe të kenë marrëdhënie legale intime vetëm gjatë natës, edhe nëse nata është e shkurtër. E kush nuk ka mundësi të agjërojë për shkak të gjatësisë së ditës, apo e di nga simptomat, apo nga përvoja, apo e lajmëron ndonjë mjek profesionist dhe besnik, apo më tepër ia merr mendja se agjërimi do ta bëjë që të sëmuret rëndë, apo do t'ia shtojë sëmundjen, apo do ta ngadalësoj shërimin e tij, ai nuk agjëron, por ditët i mbetura pa i agjëruar do t'i kompensojë kurdo që të mund ta bëjë këtë. Ky është qëndrimi që e ka miratuar Këshilli i Akademisë së Fikhut Islam pranë Ligës së Botës Islame, Shoqata e Dijetarëve të Mëdhenj në Arabinë Saudite,⁹ si dhe ky qëndrim është adaptuar edhe nga Këshilli Evropian për Fetva dhe Gjurmime.¹⁰ Anëtarë të këtyre dy institucioneve janë dijetarë të shquar.

JUSTIFIKIMET E QËNDRIMEVE

Dijetarët të cilët e lejojnë analogjinë në këtë çështje, gëgjësisht dijetarët që e përfaqësojnë mendimin e parë dhe të dytë dhe lejojnë që kohëzgjatja e agjëritimit në zonat e këtilla të disbalansuara në kohëzgjatjen e ditës dhe të natës, në disa periudha kohore gjatë vitit, mendimin e tyre e justifikojnë si vijon:

-Rregulla se për rastet e rralla, nuk vlejnë rregullat e përgjithshme, por rregulla të veçanta. Këto zona, nuk janë pjesë e zonave të cilat njihen si normale në zbatimin e dispozitave që kanë të bëjnë me kohët e adhurimeve, dhe për këtë, për këto vende vlejnë dispozita të veçanta. Për këtë edhe duhet bërë analogji me vende të tjera, qoftë me Mekën, sipas disa dijetarëve, apo me zonat më të afërta që i kanë afër, dhe që këto zona e marrin statusin e zonave normale, sipas disa dijetarëve të tjerë. Koha e përcaktuar për agjërim në legjislacionin islam, e që është prej agimit e deri në perëndim të diellit, komform ajetit: *"...dhe hani e pini derisa qartë të dallohet peri i bardhë nga peri i zi në agim, e pastaj agjërimin plotësojeni deri në mbrëmje..."* (El Bekare, 187), vlen për zonat që nuk kanë disbalans të madh në kohëzgjatjen e ditës dhe të natës gjatë vitit.

-Parimi i jo vështirësisë dhe lehtësisë të dispozitave islame, i cili është parim bazë i të drejtës islame që gjeneron nga tekste fetare, si: *"... dhe nuk ju obligoi në fe me ndonjë vështirësi..."* (El Haxh, 78); *"... Allahu me këtë dëshiron lehtësim për ju, e nuk dëshiron vështirësim për ju..."* (El Bekare, 185).

Agjërimi në këto vende, sipas parimit të agimit të ditës dhe perëndimit të diellit, shkakton vështirësi evidente për agjëruesit, dhe kryesisht është i papërballueshëm, pasi arrin deri 18 orë apo edhe më shumë se atë.

Hadithi që flet për kohën kur do të vjen Dexhalli, dhe se ditët e para të tij do të jenë jo të zakonshme në kohëzgjatje, ashtu që do të duhet të bëhet llogaritja e kohës së namazeve, e për rrjedhojë edhe e agjëritimit.¹¹

Mbështetësit e mendimit të tretë kanë replikuar ndaj këtij argumenti me atë se në kohën për të cilën flet hadithi, pra në ditët e para që nuk do të jenë të zakonshme në kohëzgjatje, nuk do të ketë shenja që e përcaktojnë fillimin dhe mbarimin e ditës. Kjo për dallim prej zonave me disbalans, ku në disa prej tyre ka agim të ditës dhe perëndim të diellit, por koha prej agimit të ditës, e deri në perëndim të diellit, është mbi 18 orë.

Dijetarët të cilët e përfaqësojnë mendimin e tretë, qëndrimin e tyre e arsyetojnë me parimet bazë të përcaktimit të kohës së syfytit dhe iftarit në Ramazan, e që lidhen me fillimin e agimit dhe perëndimin e diellit. Sipas Akademisë së Fikhut Islam pranë Ligës së Botës Islame, për zonën e parë, vlen ajo që banorët duhet t'u përmbahen kohëve të namazit të përcaktuara sipas Sheriatit, si dhe kohës së agjëritimit, po ashtu të përcaktuar sipas Sheriatit, e që nënkupton agjërimin prej daljes së agimit të vërtetë, e deri në perëndim të diellit, duke iu përmbajtur teksteve fetare që përcaktojnë kohët e agjëritimit. Ata që nuk mund të agjërojnë, apo nuk mund ta plotësojnë agjërimin e ndonjë dite për shkak të orëve të gjata të agjëritimit, nuk do të agjërojnë, por këtë agjërim, do ta kompensojnë në kohë të tjera të përshtatshme gjatë vitit. Kjo zonë shtrihet ndërmjet paraleleve 45 shkallë dhe 48 shkallë në Veri dhe Jug. Në këtë zonë dallohen shenjat e dukshme të kohëve brenda njëzetekatër orëve, pa marrë parasysh, a janë dita dhe nata të gjata apo të shkurtra.¹² Në një vendim tjetër të Akademisë së Fikhut Islam pranë Ligës së Botës Islame, thuhet: *"Ndërkaq, për sa i përket agjëritimit të muajit Ramazanit, ata që e kanë farz agjërimin në këto vende, duhet të agjërojnë për çdo ditë prej agimit të ditës e deri në perëndim të diellit në vendin e tyre ku jetojnë, nëse dita dallohet prej natës, dhe dita dhe nata së bashku zgjatin njëzetekatër orë. Ata mund të hanë, të pinë dhe të kenë marrëdhënie legale intime vetëm gjatë natës, edhe nëse nata është e shkurtër. Kjo, ngase Sheriati islam vlen për të gjithë njerëzit, në çdo vend. Allahu i Madhërishëm ka thënë: *"...dhe hani e pini derisa qartë të dallohet peri i bardhë nga peri i zi në agim, e pastaj agjërimin plotësojeni deri në mbrëmje..."* (El Bekare, 187).*

E kush nuk ka mundësi të agjërojë për shkak të gjatësisë së ditës, apo e di nga simptomat, apo nga përvoja, apo e paralajmëron ndonjë mjek profesionist dhe besnik, apo më tepër ia merr mendja se agjërimi do ta bëjë që të sëmuret rëndë, apo do t'ia shtojë sëmundjen, apo do t'ia ngadalësojë

Përzgjedhja e një mendimi, ngelet çështje relative, e cila përputhet me qasjen e atij që bën përzgjedhjen.

shërimin, ai nuk agjëron, dhe ditët i mbetura pa i agjëruar do t'i kompensojë kurdo që të mund ta bëjë këtë. Allahu i Madhërishëm ka thënë: *“E kush e përjeton prej jush këtë muaj, le të agjërojë, ndërsa kush është i sëmurë ose në udhëtim, le të agjërojë aq ditë nga ditët e mëvonshme...”* (El Bekare, 185). Po ashtu, Allahu i Madhërishëm ka thënë: *“Allahu nuk e obligon asnjë njeri përtej mundësisë së tij...”* (El Bekare, 286).¹³

Ndaj këtij argumentimi është replikuar se lidhja e fillimit dhe mbarimit të agjërimit të një dite me agimin e ditës dhe perëndimin e diellit, u referohet zonave të cilat kanë një kohëzgjatje normale të ditës dhe natës, apo që janë të afërta me zonat normale, por nuk u referohet zonave të cilat kanë disbalans të madh të kohëzgjatjes së ditës dhe natës gjatë ndonjë periudhe brenda vitit, apo që për një periudhë të caktuar, nuk dallohen shenjat e fillimit dhe mbarimit të ditës dhe të natës.

REKOMANDIM (NË VEND TË PËRZGJEDHJES SË MENDIMIT MË TË SAKTË)

Në çështjet e këtyra diskutabile, të cilat i takojnë kohës më të re, ku nuk ka argumente decizive dhe konkrete që u referohen çështjeve të këtyra, nuk është lehtë të thuhet për një mendim se është më i saktë se mendimet e tjera. Megjithatë, përzgjedhja e një mendimi, ngelet çështje relative, e cila përputhet me qasjen e atij që bën përzgjedhjen.

Personalisht anoj kah mendimet e institucioneve që dalin me qëndrime kolektive, siç është rasti i Akademisë së Fikhut Islam, Këshillit Evropian për Fetva dhe Gjurmime, etj., dhe nëse qëndrimi i këtyre institucioneve është unik, rekomandoj të përzgjidhet.

Për çështjen në fjalë, si dhe për çështjet e tjera diskutabile të kësaj natyre, ku nuk ka argumente decizive dhe konkrete për çështjen në fjalë, si dhe ka debat që merret në konsideratë nga të gjitha palët, është më e rrugës që të arrihet konsensus sa më i gjerë i institucioneve dhe udhëheqësve fetarë në vendin përkatës, ku myslimanët

si komunitet nuk janë shumicë, fjala vjen si në rastin e vendeve skandinave dhe në vendet e tjera perëndimore. Qëndrimi unik i institucioneve dhe personaliteteve fetare të vendit përkatës, do të ishte vendimi më i drejtë për këtë çështje dhe për çështjet e tjera diskutabile të kësaj natyre. Në këtë vijë është edhe rekomandimi i Këshillit Evropian për Fetva dhe Gjurmime që: “Myslimanët e këtyre vendeve t’u drejtohen personave adekuatë për fetva-përgjigje fetare në vendet e tyre, për vështirësitë të cilat e lejojnë mos agjërimin për shkak të orëve të shumta të agjërimit gjatë ditës.”¹⁴

1 Hadithin e ka transmetuar Muslimi në *Sahih*, libri i fitneve, kapitulli: *Dexhalli dhe përshkrimi i tij dhe atyre që do të jenë me të*. Shih: Ebu Zekerija Muhjuddin Jahja ibën Sheref en Nevevij, *El Minhaxh sherhu Sahihi Muslim ibn El Haxhxhaxh*, Bejrut, Daru ihjai et turath el arebij, bot. i dytë, vëll. XVIII, f. 65.

2 Këtë ndarje e ka bërë Akademia e Fikhut Islam pranë Ligës së Botës Islame me seli në Meke të Arabisë Saudite. Shih: Liga e Botës Islame - Akademia e Fikhut Islam, *Vendime të Akademisë së Fikhut Islam*, përkthet nga arabishtja: Bashkim Aliu, Shkup, Furkan ISM, 2020, f. 96-97.

3 Dejraniije, Muxhahid Mahmud, “*Problemi i agjërimit në vendet e veriut të largët*”. Burimi: <https://islamsyria.com/ar/> (parë për herë të fundit: 05.01.2023).

4 Shih: Rida, ibidem.

5 Kjo kuptohet edhe nga fjalët e jurishtit të shquar hanefi, Ibën Abidin, i cili thotë: “Nuk kam parë që ndonjë nga dijetarët e shkollës sonë juridike ta ketë trajtuar çështjen e agjërimit në këto vende ku dita agon menjëherë pas perëndimit të Diellit, apo shkurt kohë pas tij”. Shih: Ibën Abidin, Muhamed Emin, *Reddul muhtar ala ed derr el muhtar: sherhu temviril ebsar*, Egjipt, botim i Mustafa el Babi el Halebij ve euladuhu, bot. i dytë, 1966, vëll. I, f.366.

6 Shih: Rida, ibidem.

7 Shih: Musa, Ali, “*Kohët e namazit dhe agjërimit në vendet veriore*”, f.2. Burimi: https://arsco.org/Ebooks/_ShowDocument/?filename=070519041616.zip. Krahajo: Liga e Botës Islame-Akademia e Fikhut Islam, op. cit., f.214, Dejraniije, ibidem.

8 Shih: Ibën Abidin, ibidem.

9 Liga e Botës Islame - Akademia e Fikhut Islam, op. cit., 96, 98-99.

10 Këshilli Evropian për Fetva dhe Gjurmime, *Vendimet dhe fetvatë e publikuara nga viti 1997-2017*, përkthet nga arabishtja: Bashkim Aliu, Lozanë, Qendra Shqiptare për Integritim, Kulturë dhe Religjion, 2021, f.138.

11 Shih: Musa, op. cit., f.2-3.

12 Liga e Botës Islame - Akademia e Fikhut Islam, op. cit., f.211-212. Krahajo: Këshilli Evropian për Fetva dhe Gjurmime, op. cit., f.138.

13 Ibidem, f.98-99.

14 Këshilli Evropian për Fetva dhe Gjurmime, ibidem, f.139.

Përfitimet shëndetësore të agjërimit

Dren Qerimi

Agjërimi është një nga pesë shtyllat e Islamit, dhe si i tillë, konsiderohet të jetë një praktikë shpirtërore dhe fizike. Gjatë muajit Ramazan, myslimanët abstenojnë nga ushqimi dhe pijet nga lindja e diellit e deri në perëndim të tij, si një formë adhurimi dhe nënshtrimi ndaj Zotit. Ky shkrim do të eksplorojë përfitimet e ndryshme shëndetësore të agjërimit, duke përfshirë efektet e tij në humbjen e peshës, diabetin, sëmundjet kardiovaskulare dhe funksionin e trurit, si dhe përfitimet shpirtërore të agjërimit nga këndvështrimi islam. Por, paraprakisht duhet thënë se arsyeja kryesore dhe e vetme se pse myslimanët agjërojnë është sepse ata synojnë nënshtrimin ndaj urdhrit të Allahut të Madhërishëm dhe

adhurimin ndaj Tij, i Cili në Kuranin famëlartë thotë: *“O ju që keni besuar! Ju është bërë obligim agjërimi, ashtu siç ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm.”* (El-Bekare, 183). Duke pasuar këtë logjikë, duhet kuptuar edhe disa nga përfitimet shëndetësore të agjërimit që janë ilustruar në këtë artikull.

Vitet e fundit, hulumtimet kanë treguar se agjërimi mund të ketë një sërë përfitimesh shëndetësore. Studimet kanë zbuluar se agjërimi mund të përmirësojë shëndetin kardiovaskular, të përmirësojë funksionimin e trurit, madje të ndikojë edhe në humbjen e peshës. Në veçanti, agjërimi me ndërprerje, i cili përfshinë periudha të alternuara të të

Kur trupi është në gjendje agjërimi, ai kalon nga djegia e glukozës për energji në djegien e yndyrës së ruajtur. Kjo mund të çojë në një ulje të peshës trupore dhe masës yndyrore.





ngrënit me periudha agjërimi, rezulton të jetë një metodë efektive për përmirësimin e shëndetit të përgjithshëm dhe parandalimin e sëmundjeve kronike. Ky lloj agjërimi me ndërprerje është synet i praktikuar në ditën e hënë dhe të enjte nga Profeti Muhamed, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të!

Një nga përfitimet më të njohura të agjëritit është humbja e peshës. Kur trupi është në gjendje agjërimi, ai kalon nga djegia e glukozës për energji në djegien e yndyrës së ruajtur. Kjo mund të çojë në një ulje të peshës trupore dhe masës yndyrore.¹

Agjërimi mund të përmirësojë gjithashtu ndjeshmërinë ndaj insulinës, e cila mund të ndihmojë në parandalimin dhe menaxhimin e diabetit. Insulina është një hormon që rregullon nivelet e sheqerit në gjak dhe ndihmon trupin të përdorë glukozën për energji. Kur ndjeshmëria ndaj insulinës përmirësohet, trupi është më i aftë të rregullojë nivelet e sheqerit në gjak dhe të përdorë glukozën për energji.²

Agjërimi është treguar gjithashtu se ka efekte pozitive në shëndetin e zemrës. Studimet kanë zbuluar se agjërimi me ndërprerje mund të ulë presionin e gjakut dhe të përmirësojë

nivelet e kolesterolit, gjë që mund të ulë rrezikun e sëmundjeve të zemrës.³

Përveç përfitimeve fizike, agjërimi është zbuluar se ka edhe përfitime për shëndetin mendor. Agjërimi mund të rrisë prodhimin e një faktori neurotrofik, që rrjedh nga truri (BDNF), e që është një proteinë që mbështet rritjen dhe mbijetesën e qelizave nervore në tru. Kjo mund të çojë në përmirësimin e kujtesës dhe funksionit kognitiv.⁴

Agjërimi gjithashtu mund të rrisë prodhimin e endorfinës, të cilat janë kimikate në tru që nxisin ndjenjat e mirëqenies dhe lumturisë. Kjo mund të çojë në një humor të përmirësuar dhe ulje të simptomave të depresionit dhe ankthit.⁴

Agjërimi është treguar se përmirëson proceset e riparimit qelizor dhe rrit prodhimin e disa hormoneve të rritjes, të quajtur hormonet e rritjes njerëzore (HGH), që ndihmojnë në ruajtjen, ndërtimin dhe riparimin e indeve të shëndetshme në tru dhe në organe të tjera. Studimet kanë zbuluar se agjërimi me ndërprerje mund të çojë në një rritje të konsiderueshme të niveleve të HGH.^{5,6} Agjërimi përmirëson funksionin e trurit dhe mbron nga çrregullimet neurodegenerative si sëmundja e Alzheimerit. Agjërimi mund të përmirësojë edhe sistemin imunitar. Studimet kanë zbuluar se agjërimi mund të çojë në një rritje të konsiderueshme të qelizave të bardha të gjakut, të cilat janë të rëndësishme për të luftuar infeksionet dhe sëmundjet.⁷

Agjërimi ka efekte anti-inflamatore. Studimet kanë zbuluar se agjërimi mund të ulë prodhimin e citokineve pro-inflamatore, të cilat janë kimikate që kontribuojnë në inflamacionin në trup.⁸

Agjërimi gjithashtu rrit nivelet e testosteronit te meshkujt. Studimet kanë zbuluar se agjërimi me ndërprerje mund të çojë në një rritje të konsiderueshme të niveleve të testosteronit. Kjo mund të jetë për shkak të faktit se kur trupi është në gjendje agjërimi, ai kalon nga djegia e glukozës për energji në djegien e yndyrës së ruajtur. Ky proces çon në një rritje të prodhimit të hormonit luteinizues (LH), i cili është një

Studimet kanë zbuluar se agjërimi mund të ulë prodhimin e citokineve pro-inflamatore, të cilat janë kimikate që kontribuojnë në inflamacionin në trup.

hormon që stimulon prodhimin e testosteronit.⁹ Agjërimi mund të ndihmojë gjithashtu në rritjen e efekteve të stërvitjes së rezistencës dhe përmirësimit të rritjes së muskujve. Studimet kanë zbuluar se kombinimi i agjëritit me ndërprerje me stërvitjen me rezistencë mund të çojë në rritje më të mëdha të masës dhe forcës së muskujve, si dhe në një reduktim të yndyrës së trupit, krahasuar vetëm me stërvitjen me rezistencë.¹⁰ Nga ky kuptim, shumë atletë të sporteve luftarake dhe të peshëngritjes e praktikojnë këtë lloj agjërimi në mënyrë që jenë në formën më të mirë të mundshme.

Ndërsa në sferën e përfitimeve shpirtërore, agjërimi në Islam shihet si një mënyrë për të pastruar shpirtin dhe për të zhvilluar vetëkontrollin. Agjërimi mund të ndihmojë në kontrollimin e dëshirave të dikujt, të tilla si dëshira për ushqim, pije dhe marrëdhënie intime, në mënyrë që t'i ridrejtojë ato dëshira ashtu si duhet. Ky proces i ri drejtimit të dëshirave drejt Zotit rrit ndërgjegjësimin shpirtëror dhe afërsinë me Zotin. Agjërimi në Islam ndihmon në zhvillimin e ndjeshmërisë dhe dhembshurisë ndaj atyre që janë më pak me fat. Duke përjetuar ndjenjën e urisë dhe etjes, myslimanët kujtojnë betejat me të cilat përballen ata që nuk kanë ushqim dhe ujë të mjaftueshëm, dhe inkurajohen të japin për bamirësi

dhe të ndihmojnë ata që kanë nevojë. Përveç kësaj, agjërimi është një mënyrë për të pastruar mendjen dhe trupin nga çdo mendim, ndjenja dhe sjellje negative. Agjërimi konsiderohet si një mënyrë për të 'pastruar' brendësinë nga çdo energji negative, dhe është një mënyrë për t'u fokusuar në aspektet shpirtërore të jetës dhe për të arritur një nivel më të lartë të vetëdijes dhe ndërdijes. Gjithashtu, agjërimi ndihmon në rritjen e ndërgjegjes dhe në aftësinë për t'u përqendruar në momentin aktual. Ky ndërgjegjësim i ndihmon myslimanët të jenë më të vetëdijshëm për veprimet dhe mendimet e tyre dhe të marrin vendime më të vetëdijshme gjatë gjithë ditës.

Si përfundim, agjërimi në Islam nuk është vetëm një praktikë fizike, por është një praktikë shpirtërore. Është një mënyrë për

të pastruar shpirtin, për të zhvilluar vetëkontrollin, ndjeshmërinë dhe dhembshurinë, për të pastruar mendjen dhe trupin nga çdo mendim, ndjenjë dhe sjellje negative, për të rritur vëmendjen dhe për t'u fokusuar në aspektet shpirtërore të jetës. Gjithashtu, agjërimi ka një gamë të gjerë përfitimesh shëndetësore. Hulumtimet kanë zbuluar se agjërimi me ndërprerje mund të ndihmojë në humbjen e peshës, të përmirësojë metabolizmin e glukozës dhe të ulë rrezikun e sëmundjeve kronike si sëmundjet kardiovaskulare dhe diabeti. Për më tepër, agjërimi është zbuluar se rrit funksionin e trurit, rrit jetëgjatësinë dhe madje ka efekte anti-inflamatore. Agjërimi gjithashtu ka përfitime shpirtërore në këndvështrimin islam, ai konsiderohet si një mënyrë e vetëdisiplinës, vetëkontrollit dhe përkushtimit ndaj Zotit. Në përgjithësi, agjërimi mund të jetë një mjet efektiv për përmirësimin e shëndetit të përgjithshëm dhe parandalimin e sëmundjeve kronike.

Referencat:

1. Varady, K. A., & Hellerstein, M. K. (2009). Alternate-day fasting and chronic disease prevention: a review of human and animal trials. *American Journal of Clinical Nutrition*, 90(1), 1–8. <https://doi.org/10.3945/ajcn.2009.26736K>.
2. Longo, V. D., Mattson, M. P. (2014). Fasting: molecular mechanisms and clinical applications. *Cell Metabolism*, 19(2), 181–192. <https://doi.org/10.1016/j.cmet.2013.12.008>.
3. Trepanowski, J. F., Kroeger, C. M., Barnosky, A., Klempel, M. C., Bhutani, S., Hoddy, K. K., ... Varady, K. A. (2013). The effects of alternate-day fasting on body composition and clinical health markers in obese adults: a randomized clinical trial. *International Journal of Obesity*, 37(8), 991–1007. <https://doi.org/10.1038/ijo.2012.204>.
4. Mattson, M. P., & Wan, R. (2005). Beneficial effects of intermittent fasting and caloric restriction on the cardiovascular and cerebrovascular systems. *Journal of Nutritional Biochemistry*, 16(3), 129–137. <https://doi.org/10.1016/j.jnutbio.2004.11.005>.
5. Mattson, M. P., Duan, W., Guo, Z., Li, Y., and others. (2002). Meal frequency and timing in health and disease. *Proceedings of the National Academy of Sciences of the United States of America*, 99(suppl 2), 17211–17212. <https://doi.org/10.1073/pnas.242603899>.
6. Cheng, C., Dhahbi, J., Mote, P., & Spindler, S. (2007). Intermittent fasting dissociates beneficial effects of dietary restriction on glucose metabolism and neuronal resistance to injury from calorie intake. *Proceedings of the National Academy of Sciences of the United States of America*, 104(31), 12987–12992. <https://doi.org/10.1073/pnas.0705290104>.
7. Lee, C., Rucker, R., & Tilmont, E. (2002). Caloric restriction increases neurotrophic factor levels and attenuates neurochemical and behavioral deficits in a primate model of Parkinson's disease. *Proceedings of the National Academy of Sciences of the United States of America*, 99(20), 13030–13035. <https://doi.org/10.1073/pnas.202396199>.
8. Lee, J., Duan, W., Longo, V., & Mattson, M. (2000). Dietary restriction increases the number of newly generated neural cells, and induces cerebral neurogenesis. *Journal of Neurochemistry*, 75(6), 1567–1575. <https://doi.org/10.1046/j.1471-4159.2000.751567.x>.
9. Halagappa, V. K., Guo, Z., Pearson, M., Matsuoka, Y., Cutler, R. G., Laferla, F. M., ... Mattson, M. P. (2007). Intermittent fasting and caloric restriction ameliorate age-related behavioral deficits in the triple-transgenic mouse model of Alzheimer's disease. *Neurobiology of Disease*, 26(1), 212–220. <https://doi.org/10.1016/j.nbd.2006.09.006>.
10. Tinsley, G. M., La Bounty, P., & Paoli, A. (2015). Effect of intermittent fasting on muscle mass: a systematic review. *Journal of the International Society of Sports Nutrition*, 12(1), 1–15. <https://doi.org/10.1186/s12970-015-0070-y>.

Agjërimi në Islam nuk është vetëm një praktikë fizike, por është një praktikë shpirtërore. Është një mënyrë për të pastruar shpirtin, për të zhvilluar vetëkontrollin, ndjeshmërinë dhe dhembshurinë.



Komentimi i kaptinës El-Fet'h (2)

Sabri Bajgora

RRETHANAT QË I PARAPRINË MARRËVESHJES SË HUDEJBIJES¹

Pas luftës së Hendekut, që ndryshe quhet edhe El-Ahzab, dhe tërheqjes së turpshme të idhujtarëve mekas, së bashku me aleatët e tyre nga fiset arabe dhe ato çifute, i Dërguari i Allahut pati thënë: “Prej sot, ata nuk do të na luftojnë më, por ne do t'i luftojmë ata...”² Ky ishte përgëzimi i parë i Pejgamberit a.s. për myslimanët, se tashmë kishte ardhur koha e ngritjes së tyre në vendin që e meritojnë, në cilësinë e njerëzve të ngarkuar për lartësimin e Fjalës së Allahut në Tokë.

Para se të hyjmë në komentimin e kësaj sureje, do të kthehemi vetëm pakëz prapa në kohë, që të analizojmë rrethanat që i paraprinë marrëveshjes së Hudejbijes. Në njërën prej netëve të vitit të 6-të hixhrij, i Dërguari i Allahut kishte parë një ëndërr të mirë (ru'ja), se i kishte zbritur një melek dhe i kishte thënë: “Me siguri, ju do të hyni në Xhaminë e Shenjtë, dashtë Allahu, të sigurt, kokërruar dhe flokëshkurtuar, pa kurrfarë frike.”³

Nuk vonoi shumë dhe ky sihariq u përhap me të shpejtë në të katër anët e Medinës. Myslimanët, e në veçanti muhaxhirët, i kaploi një ndjenjë e pa përshkruar e lumturisë, e cila sakaq i mallëngjeu zemrat e tyre të thyera, sepse nga kjo ëndërr e bekuar, atë kuptuan se shumë shpejt, do ta shihnin vendlindjen e tyre Mekën, nga e cila dhunshëm ishin detyruar të shpërnguleshin. Ata ende i kishin të freskëta mundimet dhe vuajtjet e përjetuara nga idhujtarët mekas, i

kishin të freskëta në kujtesë edhe betejat e Bedrit e të Uhudit, e sidomos atë të fundit, të Hendekut, kur kurejshët me ushtri të mëdha, së bashku me aleatët e tyre nga fiset arabe dhe çifutët përreth Medinës, ia kishin mësyre Medinës që të shkatërronin çdo gjurmë të Islamit.

Por, Allahu i Madhërishëm, i kishte shpartalluar ushtritë idhujtare me erëra të forta dhe me ushtri të padukshme, kështu që kurejshët, së bashku me aleatët e tyre, ishin kthyer kokulur, pa mundur të thyenin moralin e lartë të myslimanëve dhe, pa arritur ta pushtonin Medinën. Po atë ditë, kur ushtria mekase po tërhiqej zvarrë nga paralagjet e Medinës, një ushtri tjetër, tash ajo myslimane, ia kishte mësyre fortifikatave të fisit çifut Benu Kurejdha, të cilët kishin shkelur marrëveshjen e lidhur me Muhamedin a.s., në atë që njihet sot si Karta e Medinës, dhe kishin hyrë në aleancë të haptë me kurejshët për shfarosjen e myslimanëve. Më në fund, kishte ardhur koha e qërimit të hesapeve edhe me tradhtarët dhe besë-shkelësit.

Pas një rrethimi të hekurt, që zgjati për gati njëzetepesë ditë,⁴ fortifikatat e Benu Kurejdhas ranë në duart e myslimanëve, dhe Medina, përfundimisht u pastrua nga këto fise hipokrite, që për asnjë çast nuk i ndalën intrigat dhe armiqësitë ndaj Pejgamberit a.s..

Kaluan disa muaj pas kësaj ngjarjeje, dhe i Dërguari a.s., siç e përmendëm në fillim, u përgëzua në ëndërr se do të hynte në Mekë dhe do të bënte tavaf, për ta kryer umren. Ishte muaji dhulhixhe, dhe i Dërguari a.s., e

Në njërën prej netëve të vitit të 6-të hixhrij, i Dërguari i Allahut kishte parë një ëndërr të mirë (ru'ja), se i kishte zbritur një melek dhe i kishte thënë: “Me siguri, ju do të hyni në Xhaminë e Shenjtë, dashtë Allahu, të sigurt, kokërruar dhe flokëshkurtuar, pa kurrfarë frike.”

shpalli botërisht lajmin se po nisej për në Mekë së bashku me 1400 besimtarë⁵, si umrexhi, e jo për të luftuar. Ata, përveç deveve dhe kafshëve të tjera që i kishin shënjuar për t'i flijuar si kurbanë, nga armët kishin marrë vetëm ato që njihen se “arma e udhëtarit”, që nënkuptonte shpatën në këllëf (mill). Nëse ata do t'i ndalonin me forcë myslimanët në krye me të Dërguarin e Allahut, që të hynin në Mekë për ta vizituar Qabenë, kjo do të ishte kundër traditave arabe, sepse në këta muaj të shenjtë, askush nuk privohej nga vizita e Shtëpisë së shenjtë, e nëse do t'i lejonin ta kryenin umren, ata do të humbnin autoritetin dhe do të binin poshtë në sytë e fiseve të tjera arabe. Myslmanët në të dyja rastet ishin palë fituese, moralisht dhe politikisht.⁶

Idhujtarët kurejshë sapo morën vesh për nisjen e tyre, u besatuan njëzëri që të mos e lejonin Muhamedin a.s. të hynte në Mekë, madje i dërguan 100 kalorës në krye me Halid ibn Velidin si pararojë, që ta ndalonin atë për ta realizuar qëllimin e tij. Halidi ishte përqendruar në vendin e quajtur “Kura’a-l Gamim”. Ndërkohë, i Dërguari i Allahut që tashmë kishte arritur në Usfan⁷, u njoftua për daljen e Halidit në “Kura’a-l Gamim”, dhe menjëherë u këshillua me sahabët e tij më të ngushtë se si të vepronin. Për t'i ikur një konflikti të mundshëm, e mos të derdhej gjak, ai vendosi ta shmangte Halidin në “Kura’a-l Gamim”, dhe ndoqi një rrugë tjetër shkëmbore shumë më të mundimshme drejt Mekës, derisa arriti në Hudejbije.⁸ Aty u detyruan të ngrinin një kamp të përkohshëm. Arsyeja e ndaljes së tyre aty, ishte deveja e Pejgamberit a.s., e cila me të arritur në Hudejbije, u gjuhëzua dhe refuzoi të bënte edhe një hap përpara, drejt Mekës. Njerëzit filluan të thoshin se “El-Kasva-ja” - deveja e Resulullahut s.a.v.s. po shfaqte mosbindje.

- Jo, - tha i Dërguari i Allahut: “Ajo nuk po tregon mosbindje, sepse nuk është në natyrën e saj, por e ka ndaluar Ai që e pati penguar të ecte elefantin e Ebrehesë të marshonte drejt Mekës për ta rrënuar Qabenë.” Kjo ishte një shenjë hyjnore për Pejgamberin a.s., prandaj menjëherë iu drejtua besimtarëve që ishin me të duke thënë: “Dijeni se çfarëdo marrëveshje që do të më ofrojnë sot kurejshët, do ta pranoj për hir të lidhjeve familjare.”⁹ Pastaj i urdhëroi njerëzit që të ngrënë tendat e tyre në Hudejbije. Myslmanët pranuan një gjë të tillë me

shpresë se në mëngjesin e së nesërme do të hynin në Mekë, të papenguar.


Ndonëse ishte muaj i shenjtë, megjithatë, paria mekase kishin vendosur që myslimanët të mos hynin në Mekë. Madje ata, i madh e i vogël, së bashku me luftëtarë abisinas, të paguar enkas për luftë, ishin mobilizuar dhe kishin dalë jashtë Mekës, të gatshëm për ta penguar hyrjen e Muhamedit a.s. në Mekë, qoftë edhe me forcë.

Kur i Dërguari i Allahut mori vesh për frikën dhe shqetësimin e kurejshëve, dërgoi Uthmanin r.a. që edhe njëherë t’ua përcillte atyre se nuk kishte ardhur me nijet të luftës, por vetëm për ta kryer umren, që ta falënderonte Allahun dhe t’i madhëronte shenjat e Shtëpisë së shenjtë. Uthmani r.a. ua kishte përcjellë kurejshëve mesazhin e të Dërguarit të Allahut, dhe po ashtu i kishte përgëzuar edhe myslimanët e mbetur në Mekë, që të duronin edhe pak, sepse tashmë ishte afuar koha që së shpejti do të ishin të lirë në kryerjen e adhurimeve. Ndërkohë, për të fituar pak në kohë, kurejshët i kishin propozuar Uthmanit r.a. që nëse dëshironte, mund ta kryente tavafin e umres së bashku me njerëzit që i kishte në përcjellje, por ky refuzoi me ngulm, duke thënë se nuk mund ta bënte një gjë të tillë, pa qenë aty edhe i Dërguari i Allahut me myslimanët e tjerë.¹⁰

Siç duket, kurejshët duke u konsultuar mes vete, e kishin zvarritur pak kthimin e përgjigjes nëpërmjet Uthmanit r.a., kështu që në mesin e myslimanëve ishte përhapur një lajm i rremë se Uthmanin e kishin vrarë, prandaj, i Dërguari i Allahut u ngrit dhe kërkoi besatim prej myslimanëve që të marshonin drejt Mekës për t’u hakmarrë ndaj kurejshëve, sepse kthim prapa nuk do të kishte. Ishin vënë para dy zgjidhjeve të vështira: ose të binin si dëshmorë në luftë, ose ta çlironin Mekën e të hynin në të si çlirimtarë.

Nën hijen e një peme, aty në Hudejbije, të gjithë myslimanët një nga një, u besatuan duke ia dhënë dorën të Dërguarit të Allahut, se ishin të gatshëm edhe të vdisnin, për t’u hakmarrë për vrasjen e Uthmanit r.a. dhe shoqëruesve të tij. Ky besatim në histori njihet si “Be’atu-r-Rridvan”¹¹ Në lidhje me këtë, Allahu xh.sh. në ajetin e 18-të të kësaj sureje thotë: “Vërtet Allahu që i kënaqur me besimtarët, kur ata nën hijen e asaj





peme, të jepnin besën. Ai e dinte se çkishte në zemrat e tyre, prandaj u dhuroi qetësi dhe i përgëzoi me një fitore të afërt (çlirimin e Hajberit).”

Kur kurejshitët e kuptuan seriozitetin e situatës, e përcollën Uthmanin r.a. dhe menjëherë pas tij, urgjentisht e dërguan Suhejl bin Amrin që të lidhte një marrëveshje me Muhamedin a.s., por, me një kushtëzim që marrëveshje nuk do të kishte nëse myslimanët nuk kthehen menjëherë në Medinë, e të vinin vitin e ardhshëm. Suhejli shkoi te Pejgamberi a.s., e kur i Dërguari i Allahut e pa atë, tha: “Me siguri ky do të na e lehtësojë situatën, kurejshët me siguri dëshirojnë armëpushim pasi që e kanë dërguar këtë njeri.”¹² Pasi që Suhejli negocioi gjatë me Pejgamberin a.s., ata më në fund u pajtuan me kushtet e armëpushimit, të cilat përafërsisht, ashtu siç i ka përmbledhur e përpunuar autori i veprës “Mevsuatu-l gazevati-l kubra – Sulhu-l Hudejbijeh”, i shkroi në dy kopje, dhe i hodhi në letër, Ali ibn Ebi Talibi. Marrëveshja parashihte:

Bismike Allahumme - Me emrin Tënd o Allah!

Kjo marrëveshje e paqes (es-sulhu) është marrëveshje mes Muhamed ibn Abdullahut dhe Suhejl ibn Amrit (të cilët pajtohen që):

Myslimanët të kthehen në Medinë pa hyrë në Mekë, në këtë vit.

Myslimanët kanë të drejtë të vijnë në Mekë vitin e ardhshëm për të kryer umren.

Kurejshët janë të obliguar që mos t'i pengojnë myslimanët me asnjë gjest, gjatë hyrjes dhe qëndrimit të tyre në Mekë.

Myslimanët e kanë për obligim që gjatë hyrjes dhe qëndrimit në Mekë, të mos bartin me vete asnjë armë tjetër përveç armës së udhëtarit - shpatën në këllëf, dhe që mos t'i nxjerrin ato haptazi nga këllëfi.

Myslimanët e kanë të përcaktuar kohën e qëndrimit në Mekë, vetëm tri ditë, dhe menjëherë pas kryerjes së umres, duhet ta lëshojnë Mekën.

Gjendja e luftës dhe e armiqësisë në mes myslimanëve dhe kurejshëve pezullohet për një afat kohor prej 10 vitesh. Pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje të paqes, njerëzit do të jenë të sigurt që të lëvizin lirshëm.

Muhamedi a.s. pas nënshkrimit të marrëveshjes, obligohet që nëse ndonjëri prej bijve të kurejshëve i bashkohet atij, pa lejen e familjes së tij, ta kthejë menjëherë në Mekë, madje edhe nëse kërkuesi për strehim (azilanti) qëllon të jetë mysliman.

Në anën tjetër, kurejshët nuk janë të detyruar ta kthejnë te Muhamedi a.s. atë që dezerton prej myslimanëve dhe u bashkohet atyre.

Fiseve arabe rreth Mekës, u jepet liri e plotë e zgjedhjes që t'i bashkohen cilitdo kamp, dhe të hyjnë nën protektoratin e cilitdo prej dy taborëve.

Fisi i cili i bashkohet njërit tabor, tash e tutje konsiderohet si pjesë e atij tabori që i është bashkuar, me të gjitha të drejtat dhe obligimet që i parashohin nenet e kësaj marrëveshjeje.

Çdo armiqësie që mund t'i ekspozohet ndonjëri prej këtyre fiseve, konsiderohet si armiqësi ndaj kampit apo taborit nënshkrues të marrëveshjes. Një akt i tillë i armiqësisë nga cilado palë qoftë, nënkupton me automatizëm, prishjen dhe pavlefshmërinë e mëtutjeshme të kësaj marrëveshjeje.¹³

Madje ajo që i çuditi edhe më shumë myslimanët e pranishëm, ishte fakti se i Dërguari a.s. nuk konsultoi asnjërin prej njerëzve të tij të afërt, lidhur me këtë çështje. Në realitet, kjo nuk ishte një praktikë e tij. Ata e vërenin Resulullahun s.a.v.s. tek sillej me aq butësi e takt ndaj ndërmjetësit kurejshit, dhe kur nuk mbeti diçka tjetër përveç nënshkrimit të marrëveshjes paqësore me ta. Disa nga myslimanët filluan të hutoheshin, e në mesin e tyre edhe Omeri r.a., i cili ishte

kategorik kundër kësaj marrëveshjeje. Madje ai, krejtësisht i hutuar, konfuz dhe i përhumbur nga dëshpërimi e pyeti të Dërguarin a.s.:

- A nuk je ti i dërguar i Allahut?
- A nuk jemi ne myslimanë?
- A nuk janë idhujtarët armiq të tanë?

Ndërsa i Dërguari a.s. secilës prej këtyre pyetjeve iu përgjigj me: - Po.

Omeri r.a., i tronditur, filloi sërish të pyeste:

- Atëherë përse të lëshojmë pe në fenë tonë?¹⁴

Përgjigjja e Pejgamberit a.s. ishte: “Unë jam rob i Zotit dhe i dërguari i Tij, dhe kurrë nuk do ta thyej urdhrin e Tij, po as Ai nuk do të më lë të humbë. Ai do të më ndihmojë të ngadhënjëj.”¹⁵

Kuptimi i fjalëve të tij ishte: respektoni dhe nënshtrojeni asaj që unë po e bëj, pa ndonjë kundërshtim a polemikë, dhe duroni pakëz. Dhe vërtet, ditët që erdhën pas kësaj marrëveshjeje, vërtetuan largpamësinë e Resulullahut s.a.v.s.. Kjo marrëveshje e cila shkaktoi gjithë ato polarizime në mesin e myslimanëve, ishte fitorja më e rëndësishme politike të cilën e kishin realizuar myslimanët. Ishte kjo një betejë politike në mes dinakërisë së kurejshëve dhe urtësisë së Pejgamberit a.s..

Në shikim të parë, kjo marrëveshje ndoshta edhe dukej si një lloj humbje apo dorëzim para kushteve të parashtuara nga kurejshët, por megjithatë pas disa muajsh të paktë, do të evoluonte në diçka krejtësisht tjetër.

I Dërguari i Allahut pas nënshkrimit të marrëveshjes, i urdhëroi sahabët e tij t'i prisnin ose t'i thernin kurbanet e tyre dhe të rruanin ose të shkurtonin flokët, në mënyrë që të liroheshin prej obligimeve të ihramit të umres dhe pastaj të ktheheshin në Medinë. Për çudi, asnjëri nga ata nuk u ngrit për ta çuar në vend këtë urdhër të tij!! Ai e përsëriti këtë urdhëresë tri herë në mesin e myslimanëve, të cilët kishin ngelur të shtangur e të hutuar nga nënshkrimi i marrëveshjes së “disfavorshme” për ta, sipas mendimit të tyre. Ai hyri i mërrolur në tendën e tij, ndërkohë që gruaja e tij, Nëna e besimtarëve, Umu Seleme, e këshilloi të mos i fliste më njeriu, por të ngrihej i pari e të flijonte-therte devenë e tij e pastaj të rruante flokët dhe të lirohej nga ihrami. Kur myslimanët e panë Pejgamberin a.s., të mërrolur, duke u paraprirë me zhveshjen e ihramit dhe përfundimin e umres, ata shpejt e shpejtë u ngritën për t'i flijuar devetë dhe kurbanet e tyre, dhe i rruan ose ia shkurtonin flokët njëri-tjetrit. Ata vazhdonin të ishin ende të dëshpëruar e të thyer shpirtërisht për shkak të marrëveshjes.¹⁶ Por, ditët që erdhën në vazhdim, vërtetuan bindshëm të kundërtën e asaj që e kishin menduar dhe përfytyruar myslimanët rreth marrëveshjes. Kjo marrëveshje në fakt ishte ngadhënjim i madh e kurrësi humbje-disfatë. Ishte çlirim (fet'h) e jo dorëzim. Aleanca e jobesimtarëve në Siujdhesën Arabike filloi të shkatërrohej që prej nënshkrimit të marrëveshjes së Hudejbijes. Fiset idhujtarë filluan të shkapërderdheshin gjithandej nëpër Gadishull. Në anën

tjetër, kur aktiviteti i kurejshëve u ndal plotësisht, aktiviteti i myslimanëve shpërtheu e gufoi me tërë forcën eruptive të tij. Në taborin e tyre filluan të hynin të gjithë ata që kishin forcë e vullnet për ta parë të vërtetën e ndritshme të Islamit. I Dërguari i Allahut ndërkohë u shkroi mbretërve të botës së atëhershme, mbretit bizantin, persian, egjiptian, atij të Abisinisë, dhe shumë prijësve të fiseve arabe, duke i ftuar në Islam. Kishin kaluar vetëm dy vite të nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, e në Islam hynë shumëfish më shumë njerëz se që kishin hyrë më parë. Argument i kësaj është se i Dërguari i Allahut pati dalë në Hudejbije në krye të 1400 burrave myslimanë, ndërsa në vitin e çlirimit të Mekës, ishte aty me 10 mijë myslimanë. Myslimanët kishin shumëfishuar radhët e veta, falë urtësisë dhe largpamësisë së Pejgamberit a.s.. I Dërguari i Allahut nga kjo betejë politike, doli ngadhënjimtar, ndërsa kushtëzimet e disfavorshme për myslimanët, u shndërruan sakaq të disfavorshme për vetë kurejshët.

Marrëveshja e Hudejbijes i mundësoi Pejgamberit a.s. që të ishte i qetë nga sulmet-ngacmimet e kurejshëve. Hebrenjtë, kurrësi të ndalnin tradhtitë dhe intrigat e tyre ndaj Islamit. Armëpushimi i lidhur në Hudejbije u dha rast të volitshëm myslimanëve për t'u ballafaquar përfundimisht me çifutët dhe me tradhtitë e tyre¹⁷, siç ndodhi menjëherë pas Hudejbijes, me çlirimin e Hajberit etj.

- vijon -

- 1 Lidhur me Marrëveshjen e Hudejbijes, shih më gjerësisht: *Es-Siretu-n-nebevijeh li Ibni Hisham*, Bejrut, 1990, vëll. III, ff. 255-273; Ibn Kethir, *Es-Siretu-n-nebevijeh*, Bejrut, 1976, vëll. III, ff. 312-336; Tekijjudin Ahmed bin Ali el Makrizi, *Imtau-l Esma' e bima li-r-rresuli minel ahval*, Bejrut, 1999, vëll. I, ff. 274-306; Musa bin Rashid el Azmij, *El-Lu'elu'ul meknun fi sireti-n-nebiji-l me'mun*, Rijad, 2013, vëll. III, ff. 272-374; Munir Muhamed Gadban, *Fikhu-s-sireh*, Mekë, 1992, ff. 507-523.
- 2 Sahihul Buhari (2/590); Shih: Safi-ur-Rrahman El-Mubarekfuri, *Nektari i vulosur i Xhenetit*, Prishtinë, 2004, f. 368.
- 3 Dr. Ahmed es-Sejjid el Kumi, *Tefsir suretil Fet'h*, Kajro, 1976, f. 7.
- 4 Ibnul Ethir el Xhezerij, *El-Kamil fi-t-Tarih*, Bejrut, 1987, vëll. II, f. 75.
- 5 Rreth numrit të besimtarëve që e shoqëruan Muhamedin a.s. në Hudejbije, ka mospajtime nëse ishin 1300, 1400 apo 1500. Sidoqoftë, referencat më relevante anojnë kah mendimi se numri i tyre ishte 1400, e mbase edhe pak më shumë.
- 6 Shih: Dr. Ekrem Dijaë el Umeri, *Es-Siretu-n-nebevijetu-s-sahihatu*, Medinë, 1994, vëll. I, f. 439.
- 7 *Ufsani* gjendet rreth 60 km. larg Mekës.
- 8 *Hudejbija* ndodhet në veri-perëndim të Mekës, rreth 22 km larg saj. Sot ky vend njihet me emrin *Shumejsi*.
- 9 *Es-Siretu-n-nebevijeh li Ibni Hisham*, vëll. III, f. 257.
- 10 Muhamed es-Sujani, *Es-Siretu-n-nebevijetu kema xhaet fil ehadith es-sahihah*, Rijad, 1424 h., vëll. III, f. 175.
- 11 Imam Ibnu-l Imad el Hanbelij, *“Shedheratu-dh-dheheb fi ahbar min dheheb”*, Damask, 1986, vëll. I, f. 123 (redaktuar nga shejh Abdulkadr el Arnauti dhe shejh Mahmud el Arnauti).
- 12 Sahihul Buhari (*El-Fet'h*, nr. 2731 dhe 2732).
- 13 Muhamed Ahmed Bashmil, *Mevsuatu-l gazevati-l kubra – Sulhu-l Hudejbijeh*, Kajro, 1985, vëll. V, ff. 223-225.
- 14 Hafidh ibn Muhamed Abdullah el Hakemi, *Mervijatu gazveti-l Hudebjijeti*, Medinë, 1406 h., f. 171.
- 15 Imam Muhamed bin Jusuf es-Salihi esh-Shami, *Subulu-l huda ve-r-rreshad fi sireti hajru-l ibad*, Kajro, 1992, vëll. V, f. 86.
- 16 *Tefsir suretil Fet'h*, f. 24.
- 17 Ahmed Behxhet, *Të Dërguarit e Allahut*, Prishtinë, 2009, ff. 684-685.

Vlera e muajit Shaban dhe e natës së Beratit

Dr. Jusuf el Kardavi

VLERA E MUAJIT SHABAN

Muaji Shaban është muaj gjatë të cilit Pejgamberi a.s. agjëronte më shumë tij sesa gjatë muajve të tjerë. Tradita e Pejgamberit a.s. që ashtu siç e transmetojnë shokët e tij: “Agjëronte (vullnetarisht) përderisa thoshim se nuk do ta lë atë dhe nuk agjëronte një kohë të gjatë sa që thoshim se nuk do të agjëronte fare.”¹ Ai agjëronte më shumë gjatë muajit Shaban, sa që thuhet se e agjëronte shumicën e tij, madje në disa transmetime thuhet se ai e agjëronte tërë muajin Shaban, mirëpo disa transmetime të tjera thonë se ai nuk e ka agjëruar një muaj të tërë përveç muajit Ramazan. Usume ibën Zejdi r.a. e kishte pyetur Pejgamberin a.s.: “O i dërguar i Allahut, nuk vërej se agjëron në ndonjë muaj më shumë se që agjëron gjatë muajit Shaban.” Ai i tha: “Ky muaj, të cilin njerëzit e harrojnë (janë të pavëmendshëm ndaj tij), është mes Rexhebit dhe Ramazanit, është muaj që gjatë tij ngrihen veprat tek Allahu xh.sh., e dëshiroj që veprat e mia të ngrihen gjersa jam duke agjëruar.”²

Gjithashtu, transmetohet se Pejgamberi a.s. agjëronte çdo të hënë dhe të enjte për çdo javë. Kur Usume ibën Zejdi r.a. e pyeti atë për sekretin e kujdesit të agjërimin të këtyre dy ditëve, ai iu përgjigj: “Ato janë dy ditë që gjatë tyre veprat paraqiten para Allahut, dëshiroj që veprat e mia të paraqiten gjersa jam duke agjëruar.”³

Agjërimi e afron robin tek Allahu xh.sh., dhe e bën të përshtatshëm për pranimin e lutjes dhe veprës së tij. Për këtë arsye, Pejgamberi a.s. është kujdesur që të agjërojë sa më shumë gjatë muajit Shaban. Agjërimi gjatë muajit Shaban ka vlerë të madhe, sidomos agjërimi i atyre që u ka mbetur ndonjë ditë pa agjëruar nga Ramazani paraprak, për shkak të sëmundjes, udhëtimit, ose femrës për shkak të ciklit

Të gjithë muajt janë muaj të Allahut xh.sh., muaj të njerëzve, pra edhe muaji Shaban është muaj i atyre që përfitojnë prej tij.

menstrual. Ata duhet t'i agjërojnë ditët e mbetura para se të vije Ramazani i ardhshëm.

VLERA E NATËS SË BERATIT

Sa i përket natës së Beratit (në gjysmën e këtij muaji), janë cekur disa hadithe që i kanë përmendur disa dijetarë, e që kanë thënë se ato hadithe arrijnë shkallën e haditheve “hasen” - të mira, si hadithi i Muadh ibën Xhebelit: “Vërtet Allahu xh.sh. në natën e gjysmës së muajit Shaban u drejtohet robërve të Tij, ua falë mëkatet të gjitha krijesave të veta, përveç idhujtarit ose grindavecit.”⁴

Allahu u drejtohet krijesave të veta dhe i shikon ato me një shikim mëshirues e falës. Ai nuk është i pavëmendshëm ndaj robërve të Vet e as që i harron ata, mirëpo shikimi dhe drejtimi i Tij këtu do të thotë se Ai i


mëshiron ata, i falë ata dhe përkujdeset për ta me një përkujdesje të veçantë. Allahu u drejtohet krijesave të Tij në këtë natë dhe ua falë mëkatet e tyre, përveç idhujtarit ose grindavecit. Sa i përket idhujtarit, Allahu xh.sh. thotë: “Është e vërtetë se Allahu nuk falë (mëkatin) t'i bëhet shok Atij, e pos këtij (mëkati), të tjerat i falë atij që dëshiron.” (En Nisa, 116). Ndërsa, grindaveci është ai që grindet me vëllain e tij mysliman, armiqësohet dhe i ndërpretë marrëdhëniet me të. Ky person ndalohet nga falja e Allahut për çdo javë. Pejgamberi a.s. ka thënë: “*Dyert e Xhenetit hapen ditën e hënë dhe të enjte, e Allahu ia falë mëkatet çdo robi të Tij që s'ka adhuruar askënd tjetër veç Tij, përveç personit që ka pasur grindje ndërmjet tij dhe vëllait (mysliman) të tij, do të thuhet: Shikoni këta të dy derisa të pajtohen (pra vononi ata në faljen e Allahut).*”⁵ Kjo ndodhë për çdo javë, pastaj një gjë e tillë vije në natën e Beratit, pra dera e faljes është e mbyllur para atyre që zemrat s'u janë pastruar nga zemërimet, ata që s'e dinë kuptimin e pastërtisë.

Vjen e hëna dhe e enjtja, vinë xhumatë dhe muajt, vjen nata e Beratit, vjen muaji Ramazan, ndërsa inatet janë ato të njëjtat. Allahu ua falë mëkatet atyre që dëshiron, mirëpo Ai ua shtyn faljen inatçinjve, siç janë ziliqarët dhe të urryerit që s'i kanë pastruar zemrat e tyre.

NDËRRIMI I KIBLES NDODHI PIKËRISHT NË NATËN E BERATIT

Sipas transmetimeve, thuhet se në këtë natë është kishte ndodhur një ngjarje madhështore në vitin e dytë hixhri, ajo ishte ndërrimi i kibles prej Mesxhidi Aksasë (Kudsit) kah Qabeja e nderuar. Kjo ishte dëshira e Pejgamberit a.s., pasi që para saj, ai drejtohej për namaz kah Mesxhidi Aksaja – Kudsi, ashtu siç kishin bërë namaz edhe të gjithë pejgamberët e tjerë para tij. Pejgamberi a.s. gjersa ishte në Meke, mendohej të falej kah dy kible, kështu që falej ndërmjet dy rukneve, ndërmjet Gurit të Zi dhe ruknit Jemani, Qabeja ishte para tij, por edhe Mesxhidi Aksaja - Kudsi ishte para tij, mirëpo kur emigroi në Medine ishte e pamundshme ta bënte një gjë të tillë, për atë shpresonte nga zemra e tij që të drejtohej kah kibleja e Ibrahimit a.s., i cili ishte ndërtues i Qabesë bashkë me të birin e tij Ismailin a.s.. Pejgamberi a.s. e shpresonte atë dhe e priste shpalljen nga Allahu xh.sh., shikonte kah qielli pa shqiptuar gjuha e tij asgjë, derisa Allahu ia përgatiti atij atë që dëshironte dhe ishte i kënaqur me të. Për këtë çështje zbriti fjala e Tij: *“Ne shumë herë po shohim kthimin e fytyrës tënde kah qielli, e Ne gjithqysh do të drejtojmë ty në drejtim të një kibleje (Qabeja) që ti e do atë.”* (El Bekare, 144). Shikoni këtë dashuri, iu realizua Muhamedit a.s. ajo që kënaqej me të në këtë botë, e Allahu i premtoi atij për dhënien e asaj që do kënaqet me të në botën tjetër. Allahu xh.sh. i tha Pejgamberit a.s.: *“E Ne gjithqysh do të drejtojmë ty në drejtim të një kibleje (Qabeja) që ti e do atë. Pra kthehu anës së xhamisë së shenjtë (Qabesë), dhe kudo që të jeni (o besimtarë) kthehuni kah ajo anë. E atyre që u është dhuruar libri, ata e dinë sigurisht se kjo (kthesë) është e vërtetë nga Zoti i tyre. E Allahut nuk mund t'i fshihet ajo që veprojnë ata.”* (El Bekare, 144).

Këtu shpërtheu shamata, që e shpërthyen hebrenjtë në Medine, duke thënë se Muhamedi për çdo ditë ka nga një mendim, dhe për çdo ditë ka nga një kible, si po drejtohet për namaz kah Qabeja, pasi që më parë drejtohej kah Mesxhidi Aksaja - Kudsi?! Nëse namazet e kaluara kanë qenë të pavlefshme, atëherë namazet e atyre që janë falur më parë janë të humbura, e nëse ka qenë e vërtetë, atëherë si e ka ndërruar sot këtë të vërtetë? Për t'u kthyer atyre, në Kuranin famëlartë, zbritën ajete të shumta që e rregulluan këtë çështje, duke pohuar së pari të drejtën e Allahut xh.sh. në shfuqizimin e dispozitave dhe ajeteve të cilat Ai dëshiron, siç ka thënë Allahu: *“Ne nuk abrogojmë (pezullojmë) asnjë nga argumentet tona, apo ta hedhim në harresë e të mos sjellim edhe më të*



dobishëm se ai, ose të ngjashëm me të. A nuk e ke ditur se Allahu është i plotfuqishëm për çdo send.” (El Bekare, 106).

Pastaj nga një aspekt tjetër, Allahu i kritikoi ata mendjelehtë që e shfrytëzojnë çdo rast për nxitjen e dyshimeve dhe ndryshimin e thënieve pa dije dhe pa argumente, iu drejtua atyre duke u thënë: *“Disa mendjelehtë nga njerëzit do të thonë: Çka i ktheu ata (myslimanët) prej kibles (drejtimit) në të cilin ishin ata (Kudsi)? Thuaj: Të Allahut janë lindja dhe perëndimi, Ai e vë në rrugën e drejtë atë që do.”* (El Bekare, 142). Të Allahut janë lindja dhe perëndimi, të gjitha anët janë të Allahut, Mesxhidi Aksaja - Kudsi dhe Qabeja barazohen, Allahu është Ai që veçon dhe urdhëron, përndryshe drejtimit janë të barabarta.

Sa i përket asaj, pse Qabeja ka qenë kibleja e dytë, e Mesxhidi Aksaja - Kudsi kibleja e parë, kjo është fshehtësia e sprovimit, për këtë, Kurani thotë: *“E kiblen nga e cila ti u drejtove nuk e bëmë për tjetër, vetëm se për të provuar atë që shkon pas të dërguarit, nga ai që kthehet prapa.”* (El Bekare, 143).

Ata që falën më parë namaze kah Mesxhidi Aksaja - Kudsi, namazet e tyre nuk humbën, namazet e tyre kanë qenë të vlefshme për atë kohë. Mirëpo, sikur të falnin namaz kah Mesxhidi Aksaja - Kudsi pas këtij ajeti të zbritur, namazi i tyre do të ishte i pavlefshëm, sepse çdo dispozitë është e vlefshme në kohën e vet, e kur të shfuqizohet nuk lejohet të punohet më me të.

Përktheu: Mr. Faruk Ukallo (Burimi: “Predikimet e shejh Jusuf el Kardavit”, përgatitur nga Halid Essaid, mektebetu vehbeh, Kajro, 1997, vëllimi I).

- 1 Transmetojnë Buhariu, Muslimi dhe Ebu Davudi.
- 2 Transmeton Nesaiu.
- 3 Transmetojnë Ebu Davudi dhe Nesaiu.
- 4 Transmetojnë Taberaniu dhe Ibën Hibbani.
- 5 Transmeton Muslimi nga Ebu Hurejreja r.a..

Muhamedi a.s., një pejgamber i përkushtuar ndaj paqes

VITET E PROFETËSISË NË MEDINE

Phd. Flamur Vehapi

Vrik pas ardhjes së Profetit a.s., njerëzit, si vendasit ashtu edhe mërgimtarët, e quajtën qytetin e tyre Medinetu 'n-Nebi (Qyteti i Profetit) ose thjesht Medinë. Në këtë fazë, kishte disa grupe të dallueshme që jetonin në Medine. Aty ishin dy fiset kryesore ndërluftuese vendase, Evs dhe Hazrexh. Brenda këtyre fiseve kishte anëtarë që ishin bërë myslimanë dhe të tjerë që kishin mbetur paganë. Ata që ishin bërë myslimanë quheshin ensarë (mbështetës). Në mesin e tyre kishte edhe një grup që kishin pandehur se hynin në Islam për qëllimet e tyre të fshehta, por në të vërtetë ishin të dyfytirshëm. Përveç kësaj, kishte edhe mërgimtarë myslimanë nga Meka, të cilët njiheshin si muhaxhirunë ose emigrantë. Atje kishte edhe tri fise të fuqishme hebreje.

Duke pasur parasysh këtë larmi fisnore dhe fetare në atë që ishte një qytet i vogël, nuk ishte e lehtë të ruaje paqen ndërmjet të gjitha grupeve. Megjithatë, Profeti e bëri këtë duke përpiluar dokumentin e famshëm që tani quhet Karta e Medinës ose Kushtetuta e Medinës. Dokumenti që ka mbijetuar deri më sot ishte një seri marrëveshjesh formale për mossulmim midis të gjitha grupeve të ndryshme në Medine asokohe. Ai "përcaktoi marrëdhëniet e ndërsjella midis myslimanëve dhe hebrenjve me një deklaratë të së drejtës së secilës palë në funksionimin civil të qytetit".¹ Këtu, siç vë në dukje edhe Yahya Emerick, qëllimi kryesor i dokumentit ishte krijimi i një ndjenje të përbashkët vetvetësie (identiteti)

si qytetarë të një shteti. Vetvetësia e përbashkët në asnjë mënyrë nuk do të thoshte se hebrenjve iu kërkua të hiqnin dorë nga feja e tyre ose ta pranonin Muhamedin si profet. Pakti thjesht pohonte se myslimanët dhe hebrenjtë do të kishin status të barabartë para ligjit.²

Kjo marrëveshje, që daton gjashtë shekuj para Magna Carta-s angleze, ishte ndoshta kushtetuta e parë e shkruar e prodhuar ndonjëherë kudo në botë, që parashikonte një shoqëri të larmishme. Ajo, jo vetëm që e bashkoi gjithë Medinën, por gjithashtu ishte në gjendje të mbante çdo armiqësi të huaj nga dëmtimi i ndonjërit prej qytetarëve për dhjetë vitet e ardhshme. Tani e gjithë Medina i dha betim besnikërie Profetit a.s., dhe pikërisht në këtë fushë shoqëria e parë myslimane, ymeti, i vendosi rrënjët e veta dhe gjithashtu mu aty Profeti a.s. krijoi selinë e parë të qeverisjes islame.

Profeti a.s. u përfshi shpesh në shtjellime fetare me çifutët që nga ditët e para në Medine. Një ditë, një delegacion prej gjashtëdhjetë priftërinjsh të krishterë nga rrethina e Nexhranit shkoi të debatonte e të mësonte nga njeriu, mësimet e të cilit po tërhiqnin kaq shumë nga bashkëfetarët e tyre.³ Kështu, të tria besimet abrahamike u takuan në një vend. Ky "Kuvend i Tri Feve ishte i gjallë teksa secila palë u përpoq të bënte të ditur vendin e vetë".⁴ Ata debatuan kryesisht mbi natyrën e Isait (Jezuit) dhe çështjen e profetësisë së Muhamedit. Në ato çaste, Profeti a.s. u kujtoi mysafirëve të

Kjo marrëveshje, që daton gjashtë shekuj para Magna Carta-s angleze, ishte ndoshta kushtetuta e parë e shkruar e prodhuar ndonjëherë kudo në botë, që parashikonte një shoqëri të larmishme.


tij se Islami i njeh shpalljet e mëparshme, si Ungjijtë dhe Tevratin, siç rrëfen Kurani: *“...Allahu! Nuk ka zot tjetër (që meriton adhurimin) përveç Tij, të Gjallit, të Përjetshmit, Mbajtësit të gjithçkaje. Ai të ka shpallur ty Librin, me të vërtetën e saktë, duke vërtetuar shpalljet e mëparshme. Ai i ka zbritur Tevratin dhe Ungjillin, më parë si udhërrëfyes për njerëzit dhe ka zbritur edhe Dalluesin (e së vërtetës nga e pavërteta)...”(Ali Imran, 1-4).*

Më pas, gjatë Kuvendit, Profeti a.s. i thirri ata që të lypnin ngjashmëritë midis besimeve të tyre, sepse Islami është besim në një Zot, siç na pohon vetë Kurani: *“Thuaj: “O ithtarët e Librit, ejani të biem në një fjalë të përbashkët mes nesh dhe jush: se do të adhurojmë vetëm Allahun, se nuk do t'i shoqërojmë Atij asgjë (në adhurim) dhe se nuk do ta mbajmë për zot njëri-tjetrin, në vend të Allahut!” Nëse ata nuk pranojnë, atëherë thuaju: “Dëshmoni se ne i jemi nënshtruar Allahut!” (Ali Imran, 64).*

Pas këtij Kuvendi, para se të merrnin leje, të ftuarit e krishterë kërkuar të luteshin dhe Profeti i lejoi të luteshin në xhaminë e tij, e cila sot është vendi i dytë më i shenjtë në Islam. Për më tepër, të mahnitur me mësimet e Islamit, mysafirët e krishterë e ftuan Profetin a.s. që të dërgonte me ta një lajmëtar që do të jetonte me ta, do t'u përgjigjej pyetjeve të tyre dhe, po qe nevoja, të gjykonte disa nga punët e tyre.⁵ Që një bashkëbisedim i tillë shumëfetar u zhvillua 1400 vjet më parë, është dëshmi e natyrës mirëkuptuese dhe paqësore të Profetit Muhamed a.s..

Më pak se dy vjet pas shpërnguljes në Medinë dhe pesëmbëdhjetë vjet pas zbritjes së ajeteve të para, u shpallën këto vargje të Kuranit: *“Atyre që janë sulmuar, u lejohet (që të mbrohen), sepse u është bërë padrejtësi dhe, në të vërtetë, Allahu është i Fuqishëm, që t'i ndihmojë ata, që janë dëbuar nga vatrat e tyre padrejtësisht, vetëm sepse thanë: “Zoti ynë është Allahu.” Sikur Allahu të mos u kishte dhënë njerëzve mundësinë për t'u mbrojtur nga njëri-tjetri, do të shkatërroheshin manastiret, kishat, sinagogat dhe xhamitë, në të cilat përmendet shumë emri i Allahut...” (Haxh, 39-40).*

Kështu, pas pesëmbëdhjetë vjetësh pa dhunë, Vetë Krijuesi u dha myslimanëve leje për vetëmbrojtje dhe leje për të luftuar për të drejtat e tyre fetare. Është me vend të pyesim përse erdhi urdhri për vetëmbrojtje kur myslimanët tani mund të zbatonin besimin e tyre në Medinë pas dhunës që kishin duruar në Mekë. Edhe pse myslimanët e kishin kaluar periudhën e vështirësive të rënda dhe dhunimit në nivel individual, ata ishin ende subjekt i gërmushjes së vazhdueshme të sulmit nga hebrenjtë dhe hipokritët brenda Medinës, si dhe fiset arabe brenda rrethinës, të cilët nuk do të kishin dashur asgjë më shumë se të shkatërronin Profetin a.s. dhe grupin e tij në rritje të ndjekësve të kësaj feje të re. Tekembramja, Islami kërcënoi ekzistencën e hebrenjve dhe stilin e jetës dhe zakonet e privileguara të arabëve. Hipokritët udhëhiqeshin nga Abdullah ibën Ubeji, i cili do të kishte qenë mbret i Medinës nëse Profeti nuk do të ishte udhëheqës.



Veç kësaj, myslimanët ende po shqetësoheshin nga mekasit. Ata kishin vendosur ndëshkime për jetesën e tyre dhe kufizime fetare për ata kur donin të vizitonin Smaren në Mekë për të kryer haxhin. Kështu, nëse nuk do të ishin shpallur ajetet që lejojnë vetëmbrojtjen, është më se e qartë se shteti i vogël mysliman nuk do t'i mbijetonte këtyre armiqësive.

Fillimisht, Profeti a.s. dërgoi ekspedita zbulimi çdo dy muaj ose më shumë për t'u njohur me zonën përreth Medinës dhe fiset e ngulura atje. Ishte në natyrën e këtyre fiseve që të fillonin bastisjet ndaj fqinjëve, kështu që këto ekspedita të para u dërguan jashtë për të mbledhur informacione, jo për të luftuar. Njëmend, Profeti a.s. ishte në gjendje të lidhte marrëveshje paqeje me një numër fisesh që jetonin atje, në mënyrë që në rast të një lufte me kurejshët, këto fise të mos anonin me mekasit.⁶ Grupe të vogla myslimanësh dolën gjithashtu për të kërcënuar karvanët në rrugët tregtare të kurejshëve mekas. Kjo nuk u bë për përfitime materiale, pasi karvanët mbetën kryesisht të paprekura dhe nuk pati viktima. Qëllimi kryesor i këtyre ekspeditave ishte t'u tërhiqte vëmendjen kurejshëve se rrugët e tyre tregtare nuk ishin të sigurta, me shpresën se do të arrinin marrëveshje me myslimanët. Megjithatë, vlen të përmendet në këtë pikë se, kur myslimanët u larguan nga Meka, ata gjithashtu lanë kamjen, pronën dhe bagëtinë e tyre pas, të cilat u kapën frik e frik nga kurejshët. Kështu që nuk ishte nocion krejtësisht i paligjshëm që myslimanët të përpiqen të ndreqnin disa nga humbjet e tyre.

Pikërisht në mbrojtje të një prej karvanëve të tyre, kurejshët mblodhën një ushtri prej njëmijë burrash kundër myslimanëve. Profeti Muhamed a.s. u dërgoi një mesazh kurejshëve, duke këmbatisë se lufta ishte e panevojshme dhe këshilloi një ujdi paqeje. Beteja e Bedrit nisi vetëm kur ajo kërkesë u shkagua dhe kurejshët bënë lëvizjen e parë. Edhe në atë grimë, Profeti Muhamed, i urdhëroi treqind luftëtarët e tij që të mos i vrisnin ata të ushtrisë mekase që kishin qenë dashamirës ndaj myslimanëve në erën mekase. Beteja përfundoi me një fitore myslimane dhe humbjen e tetëdhjetë e katër jetëve.

Vitin pasues, myslimanët pësuan humbjen e tyre të vetme në Betejën e Uhudit. Pas përfundimit të betejës, gratë e kurejshëve filluan të gjymtojnë trupat e pajetë të luftëtarëve myslimanë. Ata u prenë hundët dhe veshët trupave të vdekur dhe i lidhën në qafore. Një grua e quajtur Hind, preu kurmin e ungjit të Profetit duke përtypur mëlçinë dhe zemrën e tij.⁷ Profeti a.s. iu copëtua zemra kur pa trupin e mixhës së tij në këtë gjendje dhe për një çast të ndjeshëm u zotua të hakmerrej. Por që, me këtë rast u shpallën ajetet e mëposhtme të Kuranit: *“Nëse ndëshkoni, ndëshkoni aq sa jeni ndëshkuar, por, nëse duroni, kjo është më e mira (rrugë) për të durueshmit. Prandaj duro! Durimi yt është vetëm me ndihmën e Allahut. Dhe mos u pikëllo për ta e mos u ngushto për shkak të dredhive të tyre!”* (Nahl, 126-127).

Profeti a.s. i fali kurejshët dhe i ndaloi myslimanët që të gjymtojnë të vdekurit.⁸ Profeti e drejtoi urdhëresën e tij ushtarake me një frymë dhembshurie. Strategjia e tij nuk ishte të shkaktoje shkatërrim sipëror të jetës, pronës dhe tokës, ose të kryente mizori për ta zhbirë armikun. Ai punoi në atë mënyrë që pikësëpari t'i dekurajonte kundërshtarët nga luftimi. Një shembull i kësaj është Beteja e Hendekut, ku myslimanët u përballën me gërmushjen e ushtrive të shumta hebreje, të pajisura mirë dhe shtatë fise arabe që pushtuan Medinën. Një sahabi pers i Profetit a.s., Salman el Farsiu, dha mendim që myslimanët të hapnin një hendek të gjerë dhe të thellë rreth qytetit – një taktikë e padëgjuar tek arabët. Ushtritë nuk ishin në gjendje të arrinin në qytet dhe armiqësitë duhej të pushonin me vdekje pakësore në fushën e betejës.

Etika islame dikton që myslimanët nuk mund të kryejnë një sulm të beftë ndaj armikut dhe Profeti a.s., edhe pse përdori elemente befasi, nuk e shfrytëzoi atë për t'i shkakuar vdekjen armikut ose për të shënuar një fitore sakaqherë. Mbështetur në informacionin që kishte marrë, Profeti a.s. dhe të tijtë dolën në Mustalik, përpara se armiku të përgatitej për betejë. Ai u ofroi marrëveshje paqeje e kur kjo u shkagua, filluan luftimet. Në mënyrë të ngjashme, në Betejën e Hajberit, çifutët nuk prisnin që ushtria myslimane të shfaqej menjëherë pasi ata ishin duke u kujdesur për fushat e tyre. Profeti u dha atyre kohë të mbylleshin në kullat e tyre. Hebrejtë i mbyllën gratë dhe fëmijët në dy kulla, rraquet e tyre me vlerë në kullën e tretë dhe luftëtarët pushtuan kalanë



e katërt. Ushtria myslimane nuk iu afrua tre kalave të para, kjo sipas udhëzimit të Sheriatit që gratë, fëmijët dhe pasuria e armikut të mos ngucen gjatë luftimeve. Ai gjithashtu nuk mësynte një ushtri që stepej pasi ajo kishte pranuar humbjen. Ai e linte armikun të largohej pa tutën e një sulmi nga prapa. Kur Profeti a.s. luftoi kundër hebrejve, është regjistruar se ai hoqi dorë nga luftimi në Shabat për shkak të nderimit për besimin hebre.⁹

Ai kishte një standard moral po kaq të lartë kur bëhej fjalë për trajtimin e robërve të luftës. Pas betejës së Bedrit, myslimanët patën robër lufte për herë të parë. Profeti Muhamed i urdhëroi ithtarët e tij që t'i trajtonin me mirësi ata që ishin të privuar nga liria. Vërtet, Profeti a.s. mori gjithsej 6564 robër lufte gjatë viteve të tij ushtarake, prej të cilëve vetëm dy u ekzekutuan për krime. 6347 u liruan, ndërsa 215 të tjerët pranuan vullnetarisht Islamin atje dhe më pas.¹⁰

Profeti Muhamed parapëlqente zgjedhjen e paqes ndaj asaj të luftës dhe një rast në të cilin ai bëri shumë kompromis për të mbrojtur paqen, ishte në Hudejbije, në vitin 628 e.s.. Kishin kaluar gjashtë vjet që kur myslimanët kishin mërguar në Medinë dhe ata dëshironin të ktheheshin në Mekë për të kryer haxhin dhe për të vizituar Smaren. Një mijë e katërqind myslimanë iu afruan Mekës me petk të thjeshtë haxhiu prej dy copash të pa qepura, pa armë (përveç shpatave që mban çdo udhëtar në shkretëtirë) dhe me devetë e tyre flijuese. Kurejshët e Mekës refuzuan që t'i linin myslimanët të hynin për kryerjen e umres ose “haxhin e vogël” dhe mblodhën një ushtri të gatshme për të luftuar. Por Profeti nuk kishte ardhur për të luftuar dhe kështu ai filloi bisedimet e gjata e të mundimshme me kurejshët, të cilat çuan në Besëlidhjen e Hudejbijes. Disa nga kushtet e besëlidhjes ishin:

1. Lufta do të pezullohej për dhjetë vjet dhe asnjë palë nuk do të përfshihej në armiqësi, të hapur apo të fshehtë, kundër tjetrit.
2. Nëse gjatë asaj periudhe dikush nga kurejshët dezertonte në kampin e Muhamedit, pa lejen e kujdestarit të tij, ai

do të kthehej përsëri në Mekë. Por nëse një sahabi i Muhamedit do të kalonte te kurejshët, nuk do të kishte asnjë kërkesë për kthimin e tij.

3. Çdo fis arab do të kishte mundësinë të bashkohej me secilën palë si aleat i tij dhe të hynte në besëlidhje.
4. Muhamedi dhe njerëzit e tij do të ktheheshin në Medinë atë vit. Ata mund të vinin vitin e ardhshëm për umre dhe të qëndronin në Mekë për tri ditë, me kusht që të sillnin vetëm një shpatë të mbështjellë secili dhe asnjë armë tjetër luftarake. Në ato tri ditë, mekasit do ta lironin qytetin për ta (që të mos kishte mundësi për larjeje), por ata nuk do të lejoheshin të merrnin me vete asnjë mekas në kthim.¹¹

Myslimanët e morën si fyerje dinjiteti që ata të kthehen në Medinë, 400 km larg, pa kryer haxhin atë vit, pavarësisht se ishin fare pranë Smares. Ata mendonin se Profeti a.s. kishte bërë shumë kompromise. Megjithatë, Profeti e dinte se nuk kishte zgjidhje tjetër për paqen. Pra, ai parapëlqeu një pengim të përkohshëm për të vazhduar luftën. Edhe pse besëlidhja pohonte një periudhë dhjetëvjeçare paqeje midis dy palëve, vetëm dy vjet kaluan para se mekasit ta shkëllnin besën. Si përgjigje, Profeti a.s. mori me vete dhjetë mijë myslimanë dhe marshoi paq në Mekë, vendlindjen e tij të dashur dhe qytetin e Smares (Qabesë) së Shenjtë. Ai nuk donte përgjakje dhe luftime këtu.

Siç ndodhi, myslimanët arritën të hynin në Mekë pa qëndresë. Profeti Muhamed a.s. hyri në qytet në atë mënyrë që teksa përkulej me përulësi, koka e tij prekte shalën e devesë së tij. Ai ngriti një tendë për të qëndruar në të (shtëpia e tij mekase ishte shitur nga kurejshët kur ai mërgoi), pastaj kreu haxhin.

Të nesërmen, kurejshët u mbledhën për të mësuar se cili do të ishte fati i tyre dhe si do të hakmerrej Profeti a.s. për armiqësitë njëzet e një vjeçare që ai dhe pasuesit e tij kishin duruar nga duart e tyre. Profeti a.s. i pyeti ata: “O kurejshë, çfarë mendoni se do t’ju bëj?” Ata u përgjigjën: “Ti je një vëlla zemërmadh e kushëri fisnik”. Kësaj, Profeti ia ktheu: “Shkoni, të gjithë jeni njerëz të lirë”.

Dhe me këto fjalë të thjeshta, Profeti a.s. fali gjithçka që ai dhe njerëzit e tij kishin duruar ndonjëherë – talljet, mashtrimet, vrasjet, torturat dhe dëbimin nga shtëpitë e tyre. Madje ai e fali Hindin, e cila kishte gjymtuar kurmin e mixhës së tij. Ai nuk kërkoi që dikush të konvertohej në Islam¹² dhe nuk mori asgjë nga mekasit. Në të vërtetë, kur i mori çelësat e Smares nga kujdestari pagan për ta pastruar, ai ia ktheu çelësat me të kryer punë. Kur u pyet nga kujdestari që u çmerit se pse Profeti a.s., kur pushtoi Mekën i kishte kthyer çelësat, Profeti a.s. u gjeji me vargje nga Kurani: “Allahu ju urdhëron që amanetet t’ua ktheni atyre që u përkasin dhe, kur të gjykoni midis njerëzve, të gjykoni drejt. Vërtet, Allahu ju këshillon mrekullueshëm dhe vërtet, Allahu dëgjon çdo gjë dhe vështron të gjitha punët!” (Nisa, 58).

Ishte një falje pa kushte, e cila erdhi nga një njeri i jashtëzakonshëm. Falja nuk u dha nga dobësia, sepse Profeti a.s. kishte dhjetë mijë njerëz nën udhëheqje për të marrë hak, por nga mëshira. Dhe pikërisht ajo mëshirë e drejtësi është mishërimi i Islamit dhe ajo, që Profeti a.s. u dërgua të përçonte, siç pohon Kurani rreth tij: “Dhe Ne nuk të kemi dërguar ty (o Muhamed), veçse si mëshirë për botët.” (Enbija, 107).

Në tetë vitet midis marrjes së ajeteve të vetëmbrojtjes dhe vdekjes së tij, Profeti Muhamed a.s. e drejtoi vetë ushtrinë e tij në njëzet e tetë raste. Në nëntëmbëdhjetë prej tyre, nuk pati luftime apo gjakosje, sepse armiku do të zbythej para se të fillonin luftimet.¹³ Në shumicën e të tjerave, luftimet dhe viktimat ishin të pakta për shkak të taktikave të përdorura nga Profeti a.s.. Përnjëmend, gjatë gjithë kësaj periudhe humbja krejtësore e jetëve ishte 255 myslimanë dhe 759 jomyslimanë, ku asnjë prej të cilëve nuk ishte jo luftues.¹⁴ Si një vlerësim i përafërt, përqindja e vdekjeve në tërësinë e pjesëmarrësve në këto luftëra është afërsisht 1.5%. Më domethënësja këtu është se ai kurrë nuk e theu një marrëveshje të lidhur me fqinjët apo armiqtë duke e ditur se Islami ndalon rreptësisht thyerjen e çdo marrëveshjeje apo besatimi (Kuran, 8:55-56).¹⁵

Larg nga të qenit luftëtar gjakatar që mbante një shpatë në dorën e tij dhe një Kuran në tjetrën, Profeti a.s. ishte njëmend paqedashës. “I vetëm, Muhamedi kishte sjellë paqe në Arabinë e shkatërruar nga lufta”¹⁶, dhe askush nuk kishte arritur një sukses të tillë më parë, kur bëhet fjalë për bashkimin e një populli në një periudhë shumë të shkurtër kohore dhe vendosjen e një sundimi të përhershëm në rrethinë. Më shumë se kaq, ai zbuloi adhurimin e idhujve dhe zëvendësoi arrogancën e dhunën, dehjen dhe pandershmërinë e arabëve, me përulësi e dhembshuri, harmoni dhe bujari, duke krijuar një shoqëri vërtet të ndriçuar.¹⁷

1 Yahiya Emerick, Muhammad, 2002, fq. 131-132.

2 Ibid.

3 Ibn Ishaq, 2004, fq. 269-277.

4 Emerick, 2002, fq. 146.

5 Tariq Ramadan, In the Footsteps of the Prophet, 2007, fq. 116.

6 Al-Isma'il, 2006, fq. 188.

7 Sardar, 2007, fq. 43.

8 Al-Isma'il, 2006, fq. 255.

9 Sardar, 2007, fq. 46.

10 Doi & Clarke, Shari'ah: The Islamic Law, 2008, fq. 677.

11 Muhammad Malik, Al-Qur'an (in introduction to Surah 48), 1997, fq. 564.

12 Karen Armstrong, Islam, 2000, p. xiv.

13 Adil Salahi, Muhammad: His Character and Conduct, 2013, fq. 229.

14 Doi & Clarke, 2008, p. 677.

15 Shih dhe Kur'an, 17:34, ose 2:177, etj.

16 Armstrong, 2000, fq. 23.

17 Abdalhaqq Bewley, The Natural Form of Man, 2016, fq. 30-31.

Loja dhe dëfrimi si metodologji edukuese në edukimin parashkollor

BOTIME DHE KËRKIME PËR FILOZOFINË E EDUKIMIT PARASHKOLLOR

Phd. Melihate Zeqiri

Loja, në përgjithësi, duket sikur nuk ka ndonjë përfitim, Le mund të përkufizohet si aktivitet i kryer për ta shijuar kohën e lirë. Ky përkufizim në përgjithësi tregon pikëpamje që kanë të rriturit në lidhje me lojërat e fëmijëve. Ndërsa po ta shikojmë nga aspekti i fëmijës, për ta është një përpjekje e një punë e rëndësishme.¹

Fëmija e fillon lojën bashkë me lindjen. Te fëmijët parashkollorë loja është angazhimi i tyre i vetëm. Fëmijët, një pjesë të mirë të kohës ia kushtojnë lojës. Loja për fëmijët është kapërcimi i lodhjes së trupit dhe shpirtit për të shpenzuar energjitë e tepërta, përgatitje për jetën, për të fituar kënaqësi, etj.. Fëmijët në formimin e lojërave shikojnë klimën, kulturën, gjininë dhe efektin e moshës. Jetesa në gjeografi të ndryshme, zotërimi i një shoqërie ndryshe, të qenit djalë dhe vajzë, të qenit në moshë të ndryshme, janë një arsye e mirë për të luajtur lojëra. Psikologu i famshëm Piageti, tregon se ka një lidhje midis lojës dhe zhvillimit mendor, përshtatja me lojën, loja me pretendime dhe klasifikimi i rregullave duke qenë si lojë.²

Loja mprehë ndjenjat, zhvillon aftësitë, përmirëson mundësitë. Ajo është përgjegjëse për krijimtarinë e fëmijës, aftësinë e zgjidhjes së problemeve dhe zhvillimin e gjuhës. Në sajë të lojës, fëmijët shpëtojnë nga ankthi, pastrojnë instinktin, manifestojnë, e në këtë mënyrë tentojnë të edukohen.³

Loja në një kohë të përshtatshme bën gjimnastikën e inteligjencës së fëmijës. Kjo përmirëson aftësinë për të ndihmuar të kuptuarit e zhvillimit mendor. Aspekti më i rëndësishëm është që loja mund të përcaktohet nga interesat e fëmijës. Arkitekt Sinani në fëmijëri luante me ndërtesa të vogla me harqe, kur u rrit me anë të magjive, ndërtuar prej duarve të tij, u bë një nga arkitektët më të njohur në të gjitha shoqëritë e botës, kjo falë zbulimit të interesit të tij në lodra gjatë fëmijërisë. Fëmija duhet të vëzhgohet mirë, me çfarë luan, të zgjedhë lojërat që të mësojë prej tyre, ato të jenë relaksuese, pse jo duhet të orientohen drejt lojërave që përforcojnë imagjinatën e tyre. Për t'u kujdesur nga lojërat me telefona, fëmijës duhet t'i krijohet mundësia të argëtohet

me diçka tjetër. Dimensioni tjetër në lojën e fëmijës është shoku i tij. Një lojë e veçantë është loja nga e cila fëmija nuk heq dorë. Miqtë rrinë vazhdimisht me fëmijët, ato gjithmonë krahasohen me të mëdhenjtë. Kjo përbën zhvillimin e personaliteti por luan një rol negativ në vetëbesim. Masa e duhur është që fëmijës të mos i gjendet një shok, por një shok i dobishëm.⁴

LOJA I MUNDËSON FËMIJËS SOCIALIZIMIN

Veçanërisht lojërat në grup janë mjeti më i mirë i socializimit. Fëmija, sikurse e njuh mjedisin përmes lojës, kupton rregullat e shoqërisë dhe detyrohet t'u përshtatet rregullave, përmes lojës mund të arrijë t'i realizojë të gjitha këto. Bile, ajo luan një rol të rëndësishëm për sa i përket tolerancës ndaj ndryshimeve, bashkëpunimit në punë, altruizmit dhe fitimit të shpejtë të tjera të ngjashme. Fëmija që e njuh mjedisin përmes lojës, po ashtu e transmeton atë



përmes saj. Ai imiton ato që shikon dhe identifikon vetën me njerëzit e marrë si shembull. Duke bërë këtë, njeh vetën, provon ndjenjat, zhvillohet, dhe në fund vendos marrëdhënie njerëzore. Si rezultat i kësaj, duke e zhvilluar fëmijën, ai fiton sjellje pozitive.⁵

Në arsimimin e fëmijës, miqësia me të tjerët në lojë, ka një vend të pazëvendësueshëm. Fëmija fiton shumë njohuri, sjellje dhe kuptime nga shoku me të cilin luan. Këto, edhe sikur mos të jenë të gjitha pozitive, presin që fëmijën ta ndihmojnë deri diku. Fëmija imiton gjërat që ka mësuar nga fëmija me të cilin luan, e këto lloj sjelljesh i përvetëson. Sidomos loja e prindërve me fëmijën është një nga mënyrat e afrimit dhe njohjes me të. Fëmija, duke u takuar mjaf-tueshëm me shokun e lojës, fiton përvoja dhe hap terren për sjelljet e pranueshme morale dhe mësimin e tyre.⁶

Përzgjedhja e lojërave dhe lodrave është një nga çështjet ku duhet treguar më së shumti kujdes. Gjërat, që më së shumti fëmija kalon kohën me to, janë mjetet të cilat shërbejnë dhe ndikojnë në zhvillimin e tij. Lojërat janë të rëndësishme, sepse nga njëra anë e përgatisin fëmijën për jetën, ndërsa nga ana tjetër e ndihmojnë atë të fitojë dhe ruajë normat kulturo-morale. Loja, është një nevojë shumë e natyrshme për fëmijën. Duhet kushtuar një kujdes i veçantë, kur fëmijës i lejohej të luajë, loja të ketë një qëllim, mos të jetë shpenzim i kotë i kohës.

Prindërit duhet të kalojnë shumë kohë me fëmijën, kurrsesi nuk duhet ta nënvleftësojnë lojën e fëmijës. Nënata, duhet t'i lejojnë fëmijët e tyre t'i ftojnë shokët në shtëpi, gjithashtu edhe fëmijët e tyre duhet t'i lejojnë të shkojnë në familjet e shokëve. Në mënyrë që t'i parandalojë fëmijët të shoqërohen me shokë e shoqëri të keqe, së pari duhet t'u japin mundësinë të shoqërohen me shokë dhe shoqëri të mirë. Lojërat shërbejnë si mjet për formimin e një discipline natyrale për fëmijën. Gjithashtu, ato janë një aftësim e trajnim gjatë procesit të zhvillimit të mendjes, shpirtit dhe trupit, shërbejnë si mjet për formësimin dhe orientimin e ndjenjave, mendimeve dhe sjelljeve. Cilido prind që dëshiron ta kuptojë fëmijën e tij, që tek ai të formësohen sjelljet e dëshiruara, duhet medoemos që në jetën e fëmijës së tij të inkuadrojë lojërat. Duhet që normat dhe vlerat e jetës t'i mbështjellë me ambalazhin e lojës, në mënyrë që të futen natyrshëm në jetën e tij.⁷

TREGIME DHE PËRRALLA

Historia, është një mjet pedagogjik i rëndësishëm për zhvillimin personal dhe shpirtëror në shumë fusha, që, është pranuar ndërkombëtarisht duke qenë se ndihmon zhvillimin psikologjik të fëmijët dhe të rinjtë. Roli i kuptimit të komunikimit merret parasysh në fusha të ndryshme, si në:

Historia nuk është vetëm një argëtim që merret përmes të lexuarit dhe dëgjuarit, në fakt ajo kthehet në një pjesë jete ku fëmija hyn te personazhi kryesor e jeton së bashku me të.

sociologjinë, letërsinë, historinë, antropologjinë, teologjinë dhe fenë.

Historia është një mjet që siguron përvetësimin dhe marrjen e shembujve në arsimim. Shpjegimi i temave fetare e morale me histori, i ndihmon fëmijët që të mësojnë më lehtë gjërat abstrakte. Historia i përfshinë të gjitha përjetimet brenda saj. Në mënyrë të shpejt u tregon fëmijëve ngjarjet e ndodhura. Domethënë, njeriu është heroi i historisë së tij. Po ashtu, të gjithë dëgjojnë nga fillimi historitë e shkuara të të tjerëve. Për këtë arsye, historia rrit interesin e njerëzve në përgjithësi, por sidomos fëmijëve në veçanti.⁸

Empatia, është kuptimi i drejtë i mendimeve duke e vendosur vetën në vend të atij që ke përballë. Për të marrë ndjenja dhe emocione prej historisë mund të arrihet vetëm përmes mjetit të empatisë. Njeriu që dëgjon apo lexon historinë, zgjedh një nga heronjtë e saj si model dhe pothuajse fillon të jetojë me karakterin e tij.

Fëmija merr si shembull sjelljet që dëshiron nëse i sheh ato edhe te dikush tjetër. Në këtë drejtim, shembulli i parë i fëmijës është familja dhe fëmijët në mjedisin rrethues. Leximi dhe shpjegimi i historisë fëmijës, do të thotë t'i shpjegosh ngjarje, prej të cilave mund të nxjerrë mësim. Historia nuk është vetëm një argëtim që merret përmes të lexuarit dhe dëgjuarit, në fakt ajo kthehet në një pjesë jete ku fëmija hyn te personazhi kryesor e jeton së bashku me të. Fëmijët, në përgjithësi, kanë tendencë të bëjnë empati me protagonistin që luan rolin e mirë, e në vend të tij vendosin vetën. Duke pëlqyer karakteristikat e tyre personale, fillon të mendojë protagonistin, fillon të ndjehet si ai. Legjendat përbëhen kryesisht nga protagonistë që i përkasin krijesave të tjera, të cilat edhe pse janë ngjarje imagjinare shprehen verbalisht bindës për dëgjuesit.⁹ Legjendat nuk janë pohime për të besuar ato që shpjegohen, historia është rezultat i jetës reale. Te legjendat, heronjtë janë të mbinatyrshëm, subjekte imagjinare, ngjarje apo situata të paarsyeshme, por, duke i nxjerrë nga bota e tyre ndikojnë mbi dëgjuesin. Karakteristika kryesore dalluese midis legjendës dhe historisë është "imagjinata".¹⁰

Në historitë që u lexohen apo mësohen fëmijëve gjenden disa karakteristika, të cilat, Oğuzkan, i rendit në këtë mënyrë:

1. Të jetë temë e përshtatshme për interesat e fëmijëve, për përvojën e jetës si dhe për forcimin e mendimit;
2. Të ketë një plan të thjeshtë dhe realist, nuk duhet të jetë në kundërshtim me mendimet e fëmijëve;
3. Të përmbajë lëvizje dhe ngjarje mbi rezultate logjike;
4. Të jenë konkrete, të drejtpërdrejta dhe nuk duhet të shpërndajnë vëmendjen;

5. Të shpjegojnë mirë karakteristikat, nga pikëpamja e së vërtetës nuk duhet të lënë asnjë dyshim, heronjtë duhet të jenë të pranueshëm;
6. Me fjali të shkurtër e paragrafë të shkurtër, bazuar në biseda të bollshme, duhet të zotërojnë rrëfimi i vazhdueshëm;
7. Të specifikohet çdo pjesë emocionale e situatës;
8. Analizat mendore të jenë të përshtatshme për nivelin e fëmijës.¹¹

Kur interesat janë të bollshme dhe çdo gjë mësohet intësisht, fëmijët që duan të rrisin njohuritë dhe zhvillojnë përvojën, mund ta bëjnë këtë përmes simboleve konkrete, të cilët përfshijnë koncepte dhe simbole që mund të jenë abstrakte dhe të pakuptueshëm. Koncepte abstrakte janë: feja, patriotizmi, morali, miqësia, drejtësia dhe toleranca, që mund të transmetohen duke i konkretizuar në histori. Edhe pse mund të duken se po shqyrtohen në mënyrë kureshtare, kanë tendencë ta pranohen sistematikisht në filtrat e mendjes.¹²

Fëmijët individë që ndodhen në periudhën e pubertetit kanë perceptime e përgjigje emocionale të ndryshme lidhur me këtë, përballë njerëzve dhe institucioneve, mund të zhvillohen qëndrime të reja që formojnë sistemin e tyre të vlerave.¹³ Pas largimit nga familja, njerëzit kanë tendencën të lidhen dhe grupohen diku. Njeriu është i lumtur nga të qenit pjesëtar i këtij grupi dhe fillon të përvetësojë mendimet e vlerat e tij. Në të njëjtën mënyrë, personazhet e romaneve, historive dhe filmave tërheqin interesin e tyre.¹⁴

Duke përfutur nga ndjeshmëria dhe tendenca e tyre, me anë të rrugës së empatisë, bëhen shembuj dhe për të tjerët, sigurojnë qëndrime dhe sjellje sociale të drejta brenda shoqërisë së grupit.¹⁵ Për të dhënë vlerat e dëshiruara, ekspozohen si heronj në mesin e tyre shoqëror, të nxitur nga histori dhe ngjarje të përpunuara, orientohen duke e përcjellë mesazhin sipas nevojës. Në periudhën kur karakteri moral i fëmijës është në formësim e sipër, i duhet kushtuar një vëmendje e veçantë, duhet përfutur nga krahasimet e prekshme, përngjasimet, imazhet dhe tregimet. Tregimet dhe përrallat përmbajnë mesazhe të fshehta morale. Madje në shumë prej tregimeve, që shumica e njerëzve i dinë, gjenden mësim të ndryshme. P.sh., përralla e lepurit dhe breshkës, në shikim të parë të jep përshtypjen e qortimit ndaj të nxituarit. Pas gjithë asaj që duket, fshihet dhe një tjetër mesazh: breshka është simboli i durimit dhe i jetëgjatësisë. Ndërsa, lepurit është simboli i të riut që me fuqinë dhe shpejtësinë e tij nënvlerëson kundërshtarin, pra që nuk vlerëson fuqinë e durimit dhe këmbënguljes. Të tilla tregime dhe përralla, filtrohen në subkoshiençën e fëmijës, i japin atij mësim të dobishme morale. Duke u munduar, që me sjelljet tona, t'i tregojmë fëmijës se ne e përcaktojmë vetë fatin tonë, në këtë aspekt tregimet dhe përrallat luajnë një rol domethënës.¹⁶

LIBRI

Është shumë e domosdoshme që fëmija të njihet me librin qysh në moshë të vogël dhe me anë të tij të njohë heronjtë të cilët përfaqësojnë vlerat dhe kulturën tonë. Duhet treguar kujdes i veçantë në zgjedhjen e librave, me anë të të cilëve fëmijët njihen me personalitete dhe heronjtë idealë, të cilët mund t'i marrë si shembull për jetën e tij. Është e ditur se fëmijët pas një moshe të caktuar fillojnë të kërkojnë dikë që ta kenë dhe marrin si shembull. Krahas prindërve të tyre, fëmijët mund të marrin si shembull personalitete që prezantojnë shembuj dhe karaktere të larta morale, si heronjtë historikë, artistë, sportistë të suksesshëm dhe shkencëtarë. Personalitetin që marrin si shembull nuk e diskutojnë, kështu nga mënyra si flasin, si vishen, veset e mira deri te veset e këqija, medoemos që do të ndikojnë në personalitetin e brishtë të fëmijës. Njohja e fëmijës me dikë që ka arritur sukses, ka bërë diçka të dobishme për njerëzimin në një fushë apo lëmë të caktuar, personalitete të njohura publike, heronjtë, shkencëtarë e intelektualë, që kanë karakter moral të lartë, krijojnë dhe rrisin vullnetin e iniciativën te to. Puna, sakrifica dhe guximi që kanë treguar këto personalitete në arritjen e idealeve dhe objektivave të tyre, sa u tërheqin vëmendjen, po aq ndikon në formimin e karakterit të tyre. Duhet të theksojmë se marrja dhe pajisja për model nga ana e fëmijës së një personaliteti të duhur e të përshtatshëm ndikon në formimin dhe rritjen e tij në mënyrë të shëndetshme.¹⁷

1 Cole dhe Morgan, 1985: 228.

2 Aslanargun, E. (2007). Okul Aile İşbirliği ve Öğrenci Başarısı Üzerine Tarama Çalışma. Yavuzer, 2007: 173.

3 Aydın, M. Z. (2012). Ailede Ahlak Eğitimi. Timaş, İstanbul. Yörükoğlu, 2012: 67.

4 Beşoğlu, İ. (1993). Çocuk Bakımı ve Terbiyesi. Tuğra Yayınları, İstanbul. Fq.29.

5 Arslan, A. (2001). Felsefeye giriş. İstanbul, Vadi Yayınları. Senemoğlu, 2001: 80.

6 Aslanargun, E. (2007). Okul Aile İşbirliği ve Öğrenci Başarısı Üzerine Tarama Çalışma. Yavuzer, 2007: 185.

7 Atlı, G. (2002). Aile ve Çocuk Eğitimi Üzerine Sohbetler. Etüt Yayınevi, İstanbul. Fq. 119.

8 Aksoy, Ö. A. (1998). Atasözleri ve Deyimler Sözlüğü. C.1, I-II, İnkılap Yay., İstanbul. Ganzevoort, 1998: 23.

9 Po aty: Sakaoğlu, 1999: 2.

10 Po aty, Bilkan, 2001: 13-14.

11 Oğuzkan, 1997: 101-102.

12 Aslanargun, E. (2007). Okul Aile İşbirliği ve Öğrenci Başarısı Üzerine Tarama Çalışma. Cox dhe Eölley, 2007: 681.

13 Arslan, A. (2001). Felsefeye giriş. İstanbul, Vadi Yayınları. Yavuzer, 2001: 39.

14 Po aty, Cox-Wolley, 2007: 688.

15 Başaran, İ. E. (1990). Eğitim Psikolojisi. Gül Yay. Vitz, 1990: 709-720

16 Aydın, M. Z. (2012). Ailede Ahlak Eğitimi. Timaş, İstanbul. Aydın, 2012: 385.

17 Aydın, M. S. (1991). Tanrı-Ahlak İlişkisi. T.D.V. Yay., Ankara. Öcal, 1991: 88.

E drejta e gruas myslimane përballë ideologjisë së të drejtave të njeriut dhe feminizmit stereotipizues (2)

Edlira Durmishaj

Kur jemi tek e drejta e femrës për të manifestuar lirshëm bindjet e veta nëpërmes veshjeve të saj, domosdoshmërisht iu referohemi disa të drejtave universale, rreth të cilave kanë pajtim shumica e protagonistëve të këtyre fushave.

E DREJTA DHE LIRIA INDIVIDUALE

Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, mbulon aktet publike dhe private.¹ Neni 2 (e) i tij, trajton në mënyrë specifike detyrimin e shteteve për të trajtuar diskriminimin ndaj grave të kryera nga çdo person, organizatë ose ndërmarrje, dhe neni 2 (f), i tij ka të bëjë me modifikimin dhe heqjen jo vetëm të ligjeve dhe rregulloreve diskriminuese, por edhe të zakoneve dhe praktikave të tilla.

Neni 5 (a) i tij, u kërkon shteteve “të modifikojnë modelet sociale dhe kulturore të sjelljes së burrave dhe grave, me synimin për të arritur eliminimin e paragjyqimeve dhe zakoneve dhe të gjitha praktikave të tjera që bazohen në idenë e inferioritetit ose superioritetit të secilit prej gjinive ose në role të stereotipizuara për burrat dhe gratë”.

FEMINIZMI SI IDEOLOGJI QË DIKTON QËNDRIME PUBLIKE, STEREOTIPE DHE POLITIKA

Islamofobia është shumë më tepër se thjesht një frikë nga urrejtja ndaj myslimanëve. Siç e shpjegon Julian Hammer, ajo është një konstrukt ideologjik i prodhuar dhe

riprodhuar në kryqëzimin e ideologjisë imperialiste, përshtatshmërisë politike dhe shfrytëzimit të nacionalistëve, pasigurive racore dhe fetare.

Ndërkohë për gruan myslimane, një masë e konsiderueshme e diskursit revokon jo vetëm diskutimin mbi religionin dhe filozofinë e tij, por edhe çështjet gjinore, dhe shpeshherë në paralelizim me identitetin fetar islam, diskutimi vërsulet mbi shfaqjen e saj fizike islame në hapësirën publike, mbulesën.²

Aktivistet dhe gratë me zë të rrymave feministe të të gjitha llojeve të feminizmit, e portretizojnë gruan myslimane si një viktimë të burrit, si një grua pa botë personale, pa pavarësi, dhe të humbur në patriarkalizmin dhe fanatizmin e meshkujve të shtëpisë.

Investimi në imazhin e heronjve mediatik dhe publik, të cilët janë të fokusuar në shpëtimin e grave myslimane, është një kauzë imperialiste, e cila i portretizon gratë myslimane të mbuluara si viktima pasive të burrave dhe fesë dhe nga ana tjetër, ajo i portretizon gratë e bardha si çlirimtare të grave myslimane të viktimizuar.³ Çfarë ka ndodhur? Opinionistë dhe figura publike e politike të cilët e kanë bërë gruan myslimane në “një entitet absolut në formën e një imazhi, heshtja e të cilit bëhet shkak për të folur tonë.” - Rey Chou.

Në këtë formë mbajnë gjallë të njëjtat histori të vjetra, të cilat sillen dhe ri sillen si ushqim për të prodhuar në medime publike përfaqësimin e një Islami ekstremist e të

Aktivistet dhe gratë me zë të rrymave feministe të të gjitha llojeve të feminizmit, e portretizojnë gruan myslimane si një viktimë të burrit, si një grua pa botë personale, pa pavarësi, dhe të humbur në patriarkalizmin dhe fanatizmin e meshkujve të shtëpisë.



dhunshëm, prezenca e të cilit nuk pajtohet me vlerat e perëndimit, e madje është edhe inferior ndaj tij. Në këtë mënyrë, me vetëdije përjetësohen, e madje investohen stereotipat negative për myslimanët dhe fenë e tyre.

A thua vallë aktivistët e të drejtave të njeriut janë të paafte të kapërcejnë vetveten dhe të mos qëndrojnë indiferentë ndaj këtij fenomeni?

Atyre ua kujtojmë fjalën e Elie Wiesel, një e mbijetuar e Holokaustit, e cila duke folur për rreziqet e indiferencës, iu drejtua presidentit Clinton, më 1999: “Indiferenca nuk shkakton asnjë përgjigje. Indiferenca nuk është një përgjigje. Indiferenca nuk është një fillim, është një fund. Prandaj, indiferenca është gjithmonë miku i armikut, sepse i sjell dobi agresorit, e asnjëherë viktimës së tij, dhimbja e së cilës zmadhohet kur ndihet i harruar. I burgosuri politik në qelinë e tij, fëmijët e uritur, refugjatët e pastrehë - të mos i përgjigjesh hallit të tyre, të mos ua lehtësosh vetminë duke u ofruar atyre një shkëndijë shprese - është t’i dëbosh nga kujtesa njerëzore. Duke mohuar humanitetin e tyre, ne tradhetojmë tonën.”

Sërish në kujtesë të kolegëve të të drejtave të njeriut na vjen Eleanor Roosevelt, nëna e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, e cila në fjalimin e saj të famshëm “Lufta për të drejtat e njeriut” të vitit 1948, u shpreh: “Nuk duhet të ngatërrohem me konceptin se çfarë është liria. Të drejtat themelore të njeriut janë të thjeshta dhe lehtësisht të kuptueshme: liria e fjalës dhe shtypi i lirë; liria e fesë dhe e adhurimit; liria e tubimit dhe e drejta e peticionit; e drejta e burrave për të qenë të sigurt në shtëpitë e tyre dhe të lirë nga kontrolli dhe sekuestrimi i paarsyeshëm dhe nga arrestimi dhe dënimi arbitrar.”

E megjithatë, në këtë deklaratë të të drejtave, të bazuar mbi besimin e tre feve abrahاميke, duket se hartuesve ju ka shpëtuar krejt rastësisht përmendja e dy primareve, në të,

krejt rastësisht ndiejmë dy përjashtime të mëdha: Nuk përmendet as Zoti dhe as natyra.

Për sa i përket të parës, universaliteti i DUDNJ-së kërkon identifikim të bazuar në besim me parimet dhe vlerat e tij nga këndvështrimi i grupeve pluraliste fetare, duke përfshirë ato që e shohin burimin e arsyes dhe të ndërgjegjes jo te Zoti, por te vetë njerëzimi. Ndaj, baballarët themelues të DUDNJ-së (me nënën themeluese Eleanor Roosevelt në ballë), u përmbajtën nga çdo themelim më i thellë i atij besimi në dinjitetin dhe vlerën e personit njerëzor, të cilin preambula e ripohon. Mungesa e dytë ka të bëjë me kohën. Lufta e Dytë Botërore kishte treguar shkallën në të cilën qeniet njerëzore mund të cenonin dinjitetin njerëzor.

TË DREJTA E NJERIUT SI NJË IDEOLOGJI

Modeli i ideologjisë së të drejtave të njeriut që mund të gjurmohet përmes një procesi të institucionalizimit të ideologjisë së të drejtave të njeriut - i përjetësuar, i promovuar, i mbështetur dhe i përhapur përmes fuqisë organizative dhe doktrinës shtërënguese dhe kumulative - mund të na ndihmojë të hedhim dritë të re nëse ideologjia e të drejtave të njeriut është e aftë të prodhojë solidaritet në nivel mikro deri në masën e mobilizimit të aktorëve socialë në veprime të bazuara në të drejtat e njeriut.

Së fundi, duhet të hedhim dritë në të kuptuarit e të drejtave të njeriut përmes ideologjisë, e cila mund të sjellë disa njohuri novatore dhe të frytshme, veçanërisht në fushat që janë të nën-hulumtuara për shkak të fokusit aktual mbi të drejtat dhe gabimet në vend të fuqisë së të drejtave të njeriut si ideologji.

1 <https://hrpp.eu/alb/docs/CEDAw-a.pdf>

2 <https://religionnews.com/2021/09/29/muslim-women-more-likely-than-men-to-experience-islamophobia-survey-finds/>

3 https://www.scienceopen.com/hosteddocument?doi=10.13169/islastudj.3.1.0078Saving_muslim_women

Moderniteti dhe ideologjia në tekstet shkollore të Perandorisë Osmane (1)

Hasan Bello

Në tekstet shkollore të Perandorisë Osmane janë pasqyruar të gjitha etapat e modernizimit dhe ideologjia zyrtare e kohës. Në etapën e parë që përkon me periudhën e Tanzimatit (1839-1876), në tekstet dhe programet shkollore i kushtohet rëndësi identitetit osman. Kjo politikë ishte në përputhje me zhvillimet e ngjashme të ndërtimit të identiteteve perandorake në Evropë.

Në etapën e dytë, e cila përfshin periudhën e Abdylhamidit II (1876-1909), në tekstet dhe programet shkollore zë vend ideologjia panislamiste si element përbashkues i të gjithë popujve të perandorisë përballë rrymave nacionaliste (turke, arabe, shqiptare, kurde etj.), që krahas zhvillimit normal të tyre, nxiteshin edhe nga shtetet evropiane për diversion e presion.

Në etapën e tretë, e cila përfshin periudhën pas Revolucionit Xhonturk dhe shpalljes së Kushtetutës së dytë (1908), në tekstet dhe literaturën shkollore merr rëndësi gjithnjë e më të madhe politika e ndërtimit të identitetit kombëtar.¹ Një trajtim të ngjashëm lidhur me këtë trajektore, e ka bërë që në vitin 1904, edhe një nga themeluesit e nacionalizmit turk, Yusuf Akçura (Jusuf Akçura)*.² Në një seri të gjatë shkrimesh të botuara në gazetën “Türk” (“Turk”) që dilte në Kajro, ai shkruan se, në periudhën e Tanzimatit ishin bërë përpjekje për të krijuar popullin osman, në periudhën e Abdylhamidit II popullin islam, dhe pas kësaj periudhe kishte filluar krijimi dhe ndërtimi i një identiteti të ri kombëtar, atij turk.³

Në periudhën e Tanzimatit, përveç festave me karakter fetar, si ditë pushimi ishte edhe data e hipjes në fron të sulltanit, ndërsa në periudhën e Abdylhamidit II, u shtua si ditë pushimi ditëlindja e tij. Ndryshime thelbësore ndodhën sidomos pas Revolucionit Xhonturk të vitit 1908, kur në kalendar u shtua si festë kombëtare dita e shpalljes së Kushtetutës, ndërsa në tekstet shkollore u futën koncepte bashkëkohore të sistemit politik dhe shtetit kombëtar, si: atdheu, populli, shteti, kushtetuta, parlamenti, zgjedhjet, legjislacioni, sistemi gjyqësor etj..

Sipas disa studiuesve, teksti i parë për shkollat osmane u shkrua nga Sadık Rıfat Paşa (Sadëk Rëfat Pasha) në vitin 1847. Ai ishte një libër i vogël me karakter edukativ me titull “Libri i moralit” (“*Risale-i Ahlak*”).⁴ Ndërsa zyrtarisht, tekstet e para shkollore për historinë dhe gjuhën osmane filluan të shkruhen në vitin 1850.

Në Perandorinë Osmane, ashtu si në Evropë, institucionet arsimore shiheshin si mjet i disiplinimit social. Krijimi i Ministrisë së Arsimit në vitin 1857 lindi si rezultat i nevojës për të koordinuar veprimtarinë e shkollave shtetërore, për të rritur efektivitetin e tyre si dhe për të marrë nën kontroll shkollat e huaja.⁵

Në shkollat osmane gjatë Tanzimatit, bëhej përpjekje që brezi i ri të edukohej me dashurinë për “atdheun” (“*vatan-in*”). Ky koncept i përket kësaj periudhe. Por ai do të bëhet shumë shpejt një nga temat më të parapëlqyera për “Osmanët e Rinj”.⁶

Në etapën e dytë, e cila përfshin periudhën e Abdylhamidit II (1876-1909), në tekstet dhe programet shkollore zë vend ideologjia panislamiste si element përbashkues i të gjithë popujve të perandorisë përballë rrymave nacionaliste (turke, arabe, shqiptare, kurde etj.)

Një përhapje të gjerë në popull edhe te shtresa intelektuale, ai do të gjejë nga vepra teatrale e Namik Kemal-it “Atdheu ose Silstre” (“*Vatan yahut Silistre*”), subjekti i së cilës, përshkruhet nga patriotizmi romantik.⁷ Sipas shumë studiuesve të letërsisë osmane, kjo vepër është botuar në dy versione. Në versionin e pa censuruar të shtypur ilegalisht pjesa teatrale mbyllet me fjalët “Rroftë atdheu! Rrofshin osmanët!” (“*Yaşasın Vatan. Yaşasın Osmalılar*”), ndërsa në botimin zyrtar ajo mbyllet me urime drejtuar sovranit “Rroftë sultani! Rroftë sultani!” (“*Padişahım Çok Yaşa! Padişahım Çok Yaşa*”). Si rezultat i ndikimit që kjo pjesë pati kur u vu në skenë, Namik Kemal-i u internua, ndërsa vepra e tij u ndalua, për shkak se tentonte të zëvendësonte dashurinë dhe bindjen ndaj sultanit, me dashurinë për atdheun.



Tek osmanët e rinj, koncepti “atdhe” sinjifikohej me kërkesën për miratimin e Kushtetutës dhe hapjen e parlamentit, të cilat në thelb kufizonin pushtetin e sultanit dhe e kthenin Perandorinë Osmane në Monarki Kushtetuese.

Në mënyrë të organizuar tekstet e para për shkollat osmane filluan të shtypeshin nga fundi i vitit 1870.

Duke nisur nga viti 1880, në sistemin arsimor osman, lëndët e besimit fetar morën rëndësi të madhe. Në programet dhe në tekste shkollore, tani e tutje, filloi të propagandohej politika panislamiste. Kjo për shkak se nga shkollat në të cilat lëndët shkencore-pozitivistive ishin futur që nga koha e Tanzimatit po dilnin çdo ditë e më shumë kundërshtar të regjimit. Abdylhamidi II u përpoq që sistemin arsimor osman ta përdorte në funksion të politikës së tij panislamiste, për të formuar nëpunës të lidhur me sultanin dhe me islam

zyrtar. Ndërkohë që shtresa e dijetarëve (ulematë) u la jashtë këtij sistemi. Një dukuri e tillë nuk ishte specifike vetëm për Perandorinë Osmane, e njëjta gjë ishte duke ndodhur edhe në perandoritë fqinje dhe shtetet evropiane.⁸

Në tekstin për shkollat ruzhdije “Një histori e shkurtër e osmanëve” (“*Muhtasar osmanlı tarihi*”) që u botua në Stamboll në vitin 1891-1892 (1309), autori flet për përbërjen etnike të perandorisë. Sipas tij, shteti osman përbëhej nga 12 kombe myslimane dhe 8 jomyslimane, të cilët, që të gjithë ishin të bashkuar dhe jetonin në harmoni nën emrin e lavdishëm “osmanë”.⁹

Si institucione shtetërore perandorake socializuese, këto shkolla i edukonin individët me frymën e disiplinës, për t’i shërbyer sa më denjësisht politikës autoritariste dhe fetare. Në thelbin e tyre, të gjitha reformat në sistemin arsimor osman synonin edukimin e shtetasve me bindjen ndaj autoritetit qendror. Ato shiheshin si një mjet përçues dhe ruajtës i vlerave morale e fetare në përputhje me traditën.¹⁰ Synimi i shkollave dhe i programit mësimor ishte të krijonte një grup social të lidhur me sultanin dhe me shtetin osman.¹¹

Nga një vështrim i përciptë i teksteve osmane, vihet re se çdo epokë ka lënë gjurmët e saj. Në kapakun e botimit të dytë të tekstit shkollor “Gjeografia osmane” (“*Coğrafya-yı Osmani*”) theksohej rëndësia që Abdylhamidi II i jepte arsimit dhe se çdo “mrekulli industriale” që po ndodhte brenda perandorisë në këtë periudhë ishte rezultat i sistemit arsimor të ngritur prej tij.¹²

Në parathënien e tekstit “Ruajtja e Shëndetit” (“*Hıfz-ı Sihat*”), autori e quan Abdylhamidin II si sundimtarin më të lavdishëm dhe më të drejtë të kohës.¹³

Në tekstet shkollore përgjithësisht ushqehej fryma e tolerancës fetare. Kjo për shkak se në Perandorinë Osmane kishte edhe nënshtetas jomyslimanë, të cilët që nga koha e Mehmet Fatihut II njiheshin si komunitete më vete (*milete*). Fëmijëve myslimanë u ndalohej që të kritikonin fetë e tjera dhe në vend që t’u mësoheshin “gabimet” apo “mangësitë” e tyre, u mësoheshin urdhëresat, ndalesat dhe monoteizmi i pastër islam.¹⁴

Në kuadër të politikës panislamiste që ishte kthyer në doktrinë zyrtare të shtetit osman, në tekstet shkollore si sultani më i lavdishëm nuk cilësohej më Sulejman Kanuniu (1520-1566), por Javuz Selimi (1512-1520), sepse ky i fundit kishte transferuar qendrën e kalifatit nga Bagdadi në Stamboll dhe kishte pastruar Anadollin nga shiizmi duke e sunizuar.¹⁵

Besnikëria dhe bindja ndaj sultanit në tekstet shkollore konsiderohej jo vetëm si detyrë patriotike, por edhe si obligim fetar për çdo shtetas. Qëllimi kryesor i sistemit arsimor mbi të gjitha ishte edukimi dhe përgatitja e kuadrove besnikë ndaj sultanit e kalifatit.¹⁶ Krahësuar me periudhën e Tanzimatit ku vihej re një lloj liberalizmi, në epokën e Abdylhamidit II,

në tekstet shkollore të Perandorisë Osmane iu kushtua rëndësi e madhe përhapjes së sunizmit e sidomos shkollës hanefite*. Në disa tekste shkollore, tani bindja dhe besnikëria ndaj sulltanit konsiderohej si obligim fetar pothuajse kategorik (“vacib”),¹⁷ e në disa të tjera si kategorik (“farz”).¹⁸

Pas Revolucionit Xhonturk të vitit 1908, partia “Bashkim dhe Përparim” u përball me një nevojë më të madhe se sa regjimi i vjetër që t’i shpjegonte popullit të mirat që i sillte Kushtetuta dhe sistemi parlamentar. Prandaj, krahasuar me periudhën e mëparshme, tekstet shkollore osmane iu nënshtruan një kontrolli më të rreptë. Ato fillimisht u spastruan nga të gjitha simbolet e ideologjisë panislamiste të epokës së Abdylhamidit II; fjalët lavdëruese që shkruheshin për sulltanin u hoqën; ndërsa nga njëra anë ngrihej në qiell regjimi kushtetues, nga ana tjetër, kritikohej ashpër Abdylhamidi II, i cili kishte shfuqizuar Kushtetutën dhe kishte shpërndarë parlamentin.

Një dukuri tjetër që vihet re në tekstet shkollore të kësaj periudhe është edhe fakti se, ngjyrimi fetar tani zuri të zbehej dhe të zinte një vend gjithnjë e më të vogël se më parë.

Në ndonjë tekst, indirekt ose duke përdorur një gjuhë të kujdesshme kishte filluar të mbahej qëndrim kritik ndaj sulltanatit dhe të propagandohej se republika ishte formë më e përparuar se monarkia. Megjithatë, duke pasur parasysh rrethanat politike, kur pjesa dërrmuese e popullsisë ishte e lidhur prej shekujsh me dinastinë osmane e sulltanin, bëhej kujdes që kjo të mos ngjallte reagimin e masës myslimane. Po në të njëjtin tekst ku vlerësohej forma republikane e regjimit ishte vendosur edhe një tregim në të cilin djali pyeste babanë nëse kjo formë do të zbatohej edhe në Perandorinë Osmane. Përgjigjja ishte tej mase interesante, sipas “babait”, ky regjim politik ishte i pamundur të zbatohej në Perandorinë Osmane. Në radhë të parë për shkak se kjo perandori përbëhej nga kombe të ndryshme, të cilët do të kërkonin që presidenti i republikës të ishte nga kombi i tyre dhe në radhë të dytë për shkak se ky shtet ishte themeluar nga dinastia osmane, e cila kishte sakrifikuar shumë dhe i kishte shërbyer prej shekujsh këtij populli. Prandaj, autori i tekstit konkludonte se shteti osman nuk mund të bëhej republikë.¹⁹

Në përputhje me zhvillimet politike që ndodhën pas Revolucionit Xhonturk, në tekste, tani theksohej kontributi i ushtrisë në realizimin e revolucionit dhe hyjnizohej roli i Kushtetutës, duke e barazuar atë me lirinë. Koncepte të tilla si: atdheu, kombi, shteti, kushtetuta, parlamenti, zgjedhjet, ligji, gjykatat etj., ishin të pranishme kudo.²⁰

Në tekstet shkollore filloi të propagandohej një ideologji e re, e cila nga studiuesit është emërtuar si një “sintezë turko-islame”. Nxënësit nuk ishin më të detyruar të brohorisnin “Rroftë sulltani!”, por recitonin vjersha fetare e patriotike për atdheun dhe kombin osman. Abdylhamidi II konsiderohej si despot dhe periudha e tij si diktaturë kur populli vuante nga shtypja e mungesa e lirisë. Tani apologjizohej kontributi i

ushtrisë dhe i partisë “Bashkim dhe Përparim”, e cila kishte rrëzuar sulltanin, kishte shpallur Kushtetutën dhe i kishte rikthyer popullit lirinë.

Nga pikëpamja e kulturës politike, krahasuar me tekstet shkollore të periudhës së Abdylhamidit II, mbas vitit 1908 vihen re ndryshime thelbësore. Nëse më parë bindja dhe besnikëria ndaj sulltanit konsiderohej si obligim fetar, tani bëhej thirrje për besnikëri ndaj atdheut, kushtetutës dhe ligjeve. Shkolla nuk konsiderohej më vetëm si institucion shtetëror, por edhe si mjet socializues-partial, me anën e së cilës, xhonturqit propagandonin pikëpamjet e tyre politike. Madje, për të arritur objektivat e saj, partia “Bashkim dhe Përparim” në disa zona të caktuara hapi shkolla private me programe specifike.

- 1 Mehmet Ö. Alkan, “Osmanlı İmparatorluğu’nda Modernleşme ve Eğitim”, *TALID*, 6 (12), 2008, s.13-14.
- 2 Yusuf Akçura (1876-1835) një nga themeluesit dhe teoricienët më të njohur të nacionalizmit turk. Autor i disa librave dhe artikujve mbi këtë tematikë. Hamit Z. Koşay, “Yusuf Akçura”, *Belleten*, Ankara, 1977, Sayı: 162, s. 390;
- 3 Këto teza dhe shkrime ai i përmbodhi në librin e tij të njohur *Üç tarzi siyaset*, İstanbul, 1912. Sayim Türkman, “Yusuf Akçura ve Ziya Gökalp”, Atatürk Üniversitesi, Atatürk İlkeleri ve İnkılap Tarihi Enstitüsü, *Atatürk Dergisi*, vol.3, Ankara, 2003, s. 135-146.
- 4 Yaşar Semiz, “Sadık Rifat Paşa (1807-1857) Hayatı ve Görüşleri”, *Türkiyat Araştırmaları Dergisi*, say. 1, Konya 1994, s. 135-144; Selçuk Akşin Somel, *Osmanlı’da eğitimin modernleşmesi (1839-1908): İslamlaşma otokrasi ve disiplin*, İstanbul: İletişim yayımları, 2010, s. 238.
- 5 *Po aty*, s. 27.
- 6 Osmanët e Rinj (“Yeni Osmanlılar”) janë pararendësit e turqve të rinj ose xhonturqve. Kjo shoqëri gjysmë ilegale u themelua në vitin 1865 nga një grup intelektualësh osmanë, të cilët, nën shembullin e Revolucionit Francez dhe zhvillimeve politike e kulturore në vendet evropiane mendonin se, Perandoria Osmane mund të shpëronte vetëm duke u demokratizuar. Sungu İhsan, “Tanzimat ve Yeni Osmanlılar”, *Tanzimat I*, İstanbul 1940, s. 772; Enver Koray, “Yeni Osmanlılar”, *Belleten*, Say.186, Ankara, 1983, s. 563-582.
- 7 Namik Kemal (1840-1888) mendimtar dhe shkrimtar osman me origjinë shqiptare i gjysmës së dytë të shek. XIX. *Gül Akyılmaz*, “Birinci Jön Türk Hareketinin (Yeni Osmanlılar Cemiyeti) İdeolojisiine Bir Örnek: Namık Kemal Ve Fikirleri”, *Selçuk Üniversitesi Sosyal Bilimler Meslek Yüksek Okulu Dergisi*, Say.2, 1999, s. 243-244.
- 8 Duke nisur që nga viti 1884 Car Aleksandri i III e kishte shtuar numrin e orëve fetare në shkollat ruse. Robert Gilda, *Barricades and Borders Europe 1800-1914*, Oxford: Oxford University Press, 1987, p. 352.
- 9 Selçuk Akşin Somel, *Osmanlı’da eğitimin modernleşmesi (1839-1908): İslamlaşma otokrasi ve disiplin*, s. 250.
- 10 *Po aty*, s. 25.
- 11 Fatma Müge Göçek, *Rise of the Bourgeoisie, Demise of Empire: Ottoman Westernization and Social Change*, New York: Oxford University Press, 1996, p. 120-125.
- 12 Ahmet Celal, *Coğrafya-yı Osmani*, İstanbul: Mekteb-i Harbiye Mat., 1316 (1900).
- 13 Besim Ömer, *Hiçz-ı Sıhhat*, İstanbul: Karabet Mat., 1318 (1902), s. 1.
- 14 Ali Tevfik, *Yeni Coğrafya*, İstanbul, 1305, s. 18.
- 15 François Georçeon, *Sultan Abdülhamid*, İstanbul: Homer Kitabevi, 2006, s. 228.
- 16 Namik Sinan Turan, “Osmanlı Toplumunda Modernleşme ve Eğitimin İdeolojik Dönüşümüne Dair Gözlemler”, *Folklor Edebiyat*, Ankara 2008, c.14, Say.55, s. 123.
- 17 Ahmed Ziyaeddin, *Vesitü’n-Necat*, Dersaadet: Şirket-i Mürettebiye Mat, 1317, s.5-6.
- 18 Ahmed Cevdet, *Eser-i Ahd-ı Hamdi*, İstanbul: Matbaa-i Amire, 1309, s.26-29.
- 19 Ali Seyyidi, *Musâhebat-ı Ahlâkiye*, İstanbul: Şirket-i Mürettebiye Mat, 1332, s. 24.
- 20 Mustafa Gündüz, “II. Abdülhamid Dönemi Eğitimi ve İdeolojisi Üzerine Tartışmalar”, *TALID*, 6 (12), 2008, s. 266.

Leximi i librave -kuptimi i së vërtetës

Ma. sc. Refik Gërbeshi



Zoti na ka dhënë lirinë dhe mundësinë të zgjedhjes. Kemi shumë aktivitete tona, përmes së cilave identifikohemi dhe funksionojmë, siç janë adhurimi - ibadeti, gjumi e ushqimi, puna e lëvizja, argëtimet e ndryshme etj.. Aktivitetet tona në jetën e përditshme janë të ndryshme, dhe prej tyre ka të dobishme, të obligueshme etj., të cilat duhet t'i klasifikojmë sipas prioriteteve, sipas rëndësisë që kanë, sipas periudhës që jetojmë apo edhe dëshirës e pëlqimit tonë. Mundësia jonë për të lexuar është gjithashtu një dhunti, por edhe një prioritet që kërkon t'i jepet vendi i merituar, së paku në periudha të caktuara, për të mos thënë në çdo kohë. Që nga fillimi i shpalljes, leximi mbetet simbolika më madhështore e fesë sonë islame.

BESIMI NË LIBRA, KUSHT I BESIMIT

Përmes leximit, i Dërguari i Allahut ua sqaroi argumentet e Zotit, në mënyrë që t'ua ndriçonte rrugën e udhëzimit përmes së cilës do të arrijnë t'i shijojnë bukuritë e paimaginueshme që Allahu ka përgatitur për besimtarët e Tij. *“Të Dërguarin që ua lexoi ajetet e qarta të Allahut për t'i nxjerrë ata që besuan dhe bënë vepra të mira prej errësirave në dritë. Kush i beson Allahut dhe bën vepra të mira, Ai e shpie atë në xhenet nëpër të cilët rrjedhin lumenj; aty do të jenë gjithmonë e kurrë pakëputur. Allahu i ka dhënë atij furnizim të mirë...”* (Talak, 11).

Allahu xh.sh. e zgjodhi të Dërguarin e Tij për t'ua lexuar argumentet e qarta dhe për t'i hequr nga errësirat e informimeve të devijuara drejt dritës së argumentuar nga Krijuesi. Andaj me leximin e ajeteve të Zotit, individit bëhet besimtarë i denjë dhe posedues i të

gjitha cilësive të duhura për të. Pastaj duke lexuar të vërtetën e saktë e të argumentuar, e cila gjendet në librin e shpallur nga Zoti, ai plotëson vlerat e tij.

Njeriu sado i zgjuar që të jetë, nuk do të arrijë të kuptojë të vërtetën, andaj ka zbritur Kurani për t'ua lexuar dhe për t'ua orientuar përmes tij. Sikur njeriu të ishte vetë në gjendje të besonte Zotin ashtu siç duhet, dhe të bënte përzgjedhjen e veprave dhe klasifikimin e tyre në të mira dhe jo të mira, për të, për familjen dhe shoqërinë, atëherë mendja do të ishte zotëruese e çdo gjëje. Kjo teori nuk qëndron, ngase Allahu xh.sh., dërgoi peygamberë të shumtë dhe libra të shumtë me qëllimin e vetëm që ta mësonte njeriun për zgjedhjen e rrugës së drejtë, për besimin në Zotin Një dhe për kryerjen e urdhrave që vijnë prej Tij.¹

Pesë shqisat tona: të nuhaturit, shikimi, dëgjimi, prekje e shija, na bëjnë të mundshme që fizikisht të kërkojmë e kuptojmë vetëm botën rreth nesh. Mirëpo leximi na bënë të mundshme që të pasurohemi me informata edhe përtej botës që na rrethon.

Ajo çka përmendet në Kuran rreth organizimit të Universit është e rëndësishme, sepse këto thënie përbëjnë një fakt të ri të Shpalljes hyjnore. Kurani trajton këtë çështje në thellësi, megjithëse kjo nuk është trajtuar në shkrimet e shenjta të mëparshme.²

Me lexim arrin pasuri të madhe, e prej tyre është rregullimi i raporteve tua me Zotin, pasi që kupton atë që ka thënë Zoti. Pastaj përmes leximit arrin pasuri në familje, ku përveç qetësisë arrin edhe njohuri të reja, por edhe zhvillon debate për libra. Prandaj

Që nga fillimi i Shpalljes, leximi mbetet simbolika më madhështore e fesë sonë islame.



me lexim arrin shëndet e përmbushje, largohesh nga stresi dhe preokupimet e përditshme, arrin qetësinë mendore e trupore, shkon drejt meditimit, e freskon dhe e rigjallëron trurin. Leximi është relaksim, qetësim shpirti, orientim e përfitim i madh, leximi ofron më shumë se çdo veprimtari tjetër në jetë.

KUJDESI NË LEXIM MË SHUMË SE SA NË USHQIM

Libri aktual dhe i kohës i cili duhet të lexohet është Kurani. Lexuesit e librave të vjetër shpesh dalin qesharak kur sjellin shembuj nga librat e famshëm nga shekulli i kaluar, apo më të hershme, por këtu bëjnë përjashtim vetëm Kurani dhe Suneti. Këshillat e Kuranit asnjëherë nuk janë të vjetërsuara apo të shterura shkencërisht apo që u humb koha e leximit, praktikumit apo citimit të tyre.

Citimi nga Kurani apo jeta e Muhamedit a.s. është gjithnjë aktual dhe u përshtatet moshave dhe kohëve të ndryshme. Shpesh dëgjojmë për disa njerëz se janë udhëzuar apo janë kthyer për së mbari. Por çuditërisht si janë kthyer pa lexuar asnjë libër apo duke lexuar vetëm një të tillë. Mendoj se udhëzimi duhet të vije pikërisht nga leximi i librave, e jo vetëm nga dëgjimi i ndonjë ligjërate në internet apo në ndonjë takim. Këto mund të jenë shkëndija udhëzimi apo nxitje, por udhëzimi bëhet vetëm pasi që të kemi lexuar disa libra. Literatura e mirë ndikon te njeriu më shumë se çdo gjë tjetër, madje edhe më shumë se sa çdo medium tjetër. Libri të shetit nëpër kohë, duke angazhuar imagjinatën dhe

Citimi nga
Kurani apo jeta
e Muhamedit
a.s. është
gjithnjë aktual
dhe u
përshtatet
moshave dhe
kohëve të
ndryshme.

ndjenjat. Është e qartë se njeriu përmes librit mund të përballojë dhembjen dhe ndryshimin.³ Pra leximi i duhur është sikurse uji që pihet në burim. P.sh. Kurani, duhet të jetë burimi, dora e parë, pastaj librat e tjerë. Leximi është sikurse ushqimi. Kujdesi për ushqimin e pastër e kualitativ është i vogël, në krahasim me atë se sa duhet të jetë kujdesi në leximin e librit. Helmimi me ushqimin lë pasoja të gjata e shqetësuese edhe pas shërimit, e edhe më keq është puna e atyre që lexojnë libra të devijuar. Leximi apo studimi është më i rëndësishëm se sa të diplomoni. Derisa një hulumtim ka sqaruar se 30% e të diplomuarve nuk dinë të mbushin një aplikacion për punë, ngase nuk kanë lexuar apo dinë të lexojnë, kanë mundësinë, por nuk duan. Kurse përqindja e të arsimuarve që nuk dinë të

lexojnë është afër 80%. Secili duhet t'i bëjë vetes leximin si obligim strategjik, shprehi për të gjithë. Të lexuarit, bashkëjetesa me librin të shoqëruarit me të, të medituarit dhe rishqyrtuarit e tij përfaqësojnë njëren prej zgjidhjeve për gjendjen e komunitetit islam.⁴

1 Naim ef. Tërnavë, "Besimi Islam, shtyllat dhe veçoritë – 2", Prishtinë, 2020, f. 99.

2 Mustafa Mlivo, Kur'ani përpara shkencës dhe civilizimit, Ekzgjegjezat e 250 ajeteve kuranore", përktheu nga gjuha angleze Mimoza Sinani, SH.B "Dituria Islame", Prishtinë, 2008, f. 73.

3 Burke Hedges, "Lexo dhe bëhu i pasur", përktheu Ali Mehmetaj, Prishtinë, 2005, f. 65.

4 Dr. Abdulkerim Bekar, "Si të lexosh një libër", përktheu Agron Islami, Tetovë, 2018, f. 5.

Egjipti i Akifit në letrat e mërgimit

Abdullah Huruglica

“Po më ndjekin e po më spiunojnë. Nuk duroj të më trajtojnë si një njeri që ka shitur vendin e tij”.

(Mehmet Akifi)

Iashtuquajtur nga regjimi i asaj kohe si “poeti islamist”¹, deputeti i kuvendit të parë të Turqisë, Mehmet Akif Ersoy, gjatë viteve 1922-1925, pavarësisht punës që kishte bërë, ishte privuar nga paga e rregullt mujore. Edhe pse kishte marrë pjesë, bashkë me të birin 12 vjeçar, në luftën turke për pavarësi, ishte autor i himnit të Turqisë dhe deputet i kuvendit të saj, Mehmet Akifi, e konsideronin opozitar brenda shumicës. Qeveria e re nuk ishte mjaftuar vetëm me privim nga paga, por, Mehmet Akifi, ishte në vëzhgim të policisë dhe shërbimit sekret gjatë gjithë kohës, për çdo lëvizje të tij ekzistonte një raport i veçantë në sigurimin e shtetit. I lodhur nga këto rrethana, i rënduar nga varfëria dhe gjendja e rëndë shpirtërore, Mehmet Akifi, që kishte kaluar të pesëdhjetat, vendosi të pranonte ftesën e Abbas Halim Pashës dhe të migronte në Egjipt.²

“Po më ndjekin e po më spiunojnë. Nuk duroj të më trajtojnë si një njeri që ka shitur vendin e tij”, - tha, dhe u largua për të mos u kthyer kurrë më.

Në shtator të vitit 1925, Mehmet Akifi, mori rrugën për Egjipt,³ ndërsa udhëtimin po e bënte bashkë me gruan dhe dy djemtë e tij, Eminin dhe Tahirin. Këtë vendim ai e mori me shumë vështirësi, sepse mëtanë detit i duhej t'i linte tri vajzat e tij, Xhemilen, Suaden dhe Feriden, bashkë me nipërit dhe mbesat.

Me të kaluar Mesdheun, ata u strehuan në Hilvan, një qytet afër Kajros.⁴ Duke mos pasur mundësi tjetër komunikimi, Mehmet Akifi, mallin për familjen

mundojë ta largonte duke këmbyer fotografi e letra që bartnin plot mall, letra këto që ia shkruante vajzës së tij, Suades, dhëndrit të tij, Ahmetit dhe mbesës së tij, Ferdasë, të cilën e përmendte vazhdimisht.⁵

Letërkëmbimi ishte i vazhdueshëm, për më shumë se dhjetë vjet, aq sa qëndroi Akifi në Egjipt, megjithatë numri i letrave nuk arrin të jetë tre shifrorë. Njëra nga arsyt kryesore duhet të jetë intervali kohorë prej njëzet e pesë ditësh, aq sa nevojitej që një letër të shkonte nga Hilvani në Milas. Mes disa letrave të plota, të shlyera apo të shqyera, mund të gjejmë një përshkrim interesant të Mehmet Akifit për Egjiptin e asaj kohe, fatkeqësisht konsistent edhe me Egjiptin e ditëve të sotme.

SI DUKEJ EGJIPTI NË SYTË E AKIFIT?

Klima e nxehtë e Egjiptit përmendej shpesh në letrat e Akifit. Ai në një rast i referohet duke thënë: “...jashtë ka njerëz që digjen në diell...”⁶ Ai tregon se gjashtë muajt e verës së nxehtë i kalonte duke u dremitur në Hilvan, muajt të cilëve u referohej me fjalët: “jetojmë disi”, për arsye se gjendja e rëndë ekonomike nuk ia largonte diellin nga koka asnjëherë, qoftë edhe në stinën e dimrit. Madje fotografitë e borës i dukeshin të çuditshme.⁷ “Fotografia juaj në borë më dukej shumë e çuditshme, sepse nuk kam parë diçka të tillë tash e dymbëdhjetë vjet. Gati se ndjeva të ftohtë. Unë tashmë jam i dobët fizikisht, mirëpo falë Zotit, ende mund të shkoj në punë” - i thoshte vajzës së tij, Suades, në njërën nga letrat.



Akifi tregohej i përmalluar edhe për zërin e bilbilave,⁸ pasi që në Kajro nuk kishte bilbila, “...dikush po thonë që ka disa vetëm në rrethinën e Aleksandrisë...” Megjithatë, fjalët që kishte bilbila në Aleksandri nuk e ndryshonin faktin se Mehmet Akifi nuk po e shijonte fare pranverën. Akifi, me kohën edhe u mësua me motin e nxehtë, mirëpo jo dhe miqtë e tij që vinin në Egjipt. Në rrëfimin e tij për Eshref beun, mikun e Akifit, që shkoi nga Stambolli në Egjipt si pjesëmarrës në një trajnim, trajnim nga i cili edhe mund të fitonte pak para, ai tregon përballjen e hidhur të shokut me nxehtësinë e Hilvanit dhe mushkonjat e bezdisshme, si shkaktarë numër një për pagjumësinë e mikut të tij.

Përveç diellit përvëlues, përvëlues për Akifin ishte edhe malli për familjen e tij. Ai vazhdimisht i bënte ftesë Suades, Ahmetit dhe Ferdasë, të vinin në Egjipt dhe t’ia shuanin mallin që po e digjte, si atë, ashtu edhe të shoqen e tij. Ai madje iu thoshte atyre se do t’i shëtiste nëpër Egjipt, do t’iu bënte mirë moti i nxehtë dhe mund ta dërgonin edhe Ferdanë në shkollë, që mos të ngele mbrapa. Akifi mundohej t’ua bënte Egjiptin interesant edhe përmes fotografive të kopshtit zoologjik që i dërgonte Suades, djali i tij, Emini. Megjithatë, të gjitha këto compromise ai i bënte vetëm t’i kishte një herë afër, mirëpo mundësitë e kufizuara financiare nuk ia mundësonin familjes së Suades të udhëtonin për në Egjipt sa herë që babai i saj donte ta kishte afër.

Përderisa fotografia konsiderohej mënyra më e sofistikuar se letërkëmbimi në shuarjen mallit, për Mehmet Akifin, ishte një sfidë e madhe të bënte fotografi. Sfidë fillonte duke kërkuar një nga fotografët që endeshin rrugëve të Hilvanit, pastaj shpenzonte shumë kohë derisa fotografi të shkrepse fotografinë ideale për Akifin, ndërsa për fëmijët e tij kishte edhe sfida të tjera, si për shembull, pajisja me rroba. “...ne do t’ua dërgojmë fotografinë tonë pasi ta marrim letrën tuaj, si

përgjigje për këtë letër. Fëmijëve janë duke iu qepur rroba, sepse gjendja e tyre aktuale është paksa e mjerueshme.”

Në një nga letrat që Mehmet Akifi i dërgoi dhëndrit të tij, Ahmetit, shpreh në mënyrë të drejtpërdrejtë mos zhvillimin ekonomik të Egjiptit. Ai i drejtohet Ahmetit me këto fjalë: “Biri im, Egjipti është bërë shumë keq në këto vitet e fundit. Edhe ata që kanë ardhur nga e kaluara nxjerrin një copë bukë me një mijë telashe. Nuk ka absolutisht asnjë punë për ata që vijnë rishtas. Prandaj, nuk do t’i thosha kujt kurrë që të kalonte në këtë anë. Biznesi është plotësisht i ndenjur për shkak të mungesës së parave. Nuk ka shpresë se kriza do të zbutet në një të ardhme të afërt. Pothuajse të gjithë qytetarët tanë, të cilët erdhën për të gjetur ndonjë punë këtu në vitet e fundit, janë shkatërruar. Për këtë arsye, ai nuk duhet të vijë në këto anë, për të rënë në shpresa të kota. Edhe pse armenët, grekët, hebrejtë dhe italianët kanë një organizim të shkëlqyer këtu, edhe ata me vështirësi po gjejnë punë këtu. Krahasoni vështirësitë që do t’i kishin turqit, të cilët nuk kanë organizatë!”

Problemet e Akifit nuk ndaleshin vetëm te financat, ai vuante edhe nga disa shqetësime shëndetësore, të cilat e kishin lodhur shumë, “...edhe pse më ka lodhur pak malaria, temperatura e trupit është stabilizuar...” pastaj, “...Emini, biri im është i sëmurë...”. Përveç Mehmet Akifit dhe birit të tij Eminit, e sëmurë me sëmundje të rëndë nervore ishte edhe gruaja e tij, zonja Ismete. Megjithatë problemet shëndetësore nuk i ndalën asnjërin nga këta që të bënte atë që i takonte. Emini shkonte vazhdimisht në shkollë, zonja Ismete kryente punët e shtëpisë, aq sa mungesën e saj në shtëpi Mehmet Akifi e konsideronte telashe të madhe për vetën e tij, ndërsa Akifi, shkonte vazhdimisht në xhami, punonte në përkthimin e Kuranit dhe ishte profesor i letërsisë gjuhës dhe letërsisë turke në Universitetin e Egjiptit.

Egjipti ishte vendi që i bëri strehë Mehmet Akifit për më shumë se një dekadë, pavarësisht sfidave me të cilat u përballë gjatë kësaj periudhe. Ai ishte vend i thatë, por i bereqetshëm për Akifin, e gjithësesi edhe Akifi ishte i bereqetshëm për të.

1 Shih. Muharrem Coşkun, Kod Adı: İrtica 906 Mehmet Akif Ersoy, (Yeditepe Yayınevi, Stamboll, 2015), 44.

2 Shih. Dünya bizim, “Mehmed Akif Mısır’a neden gitmişti?“, (Parë për herë të fundit më 15 dhjetor 2022). <https://www.dunyabizim.com/kitap/mehmed-akif-misir-a-neden-gitmişti-h23548.html>

3 Shih. M. Ertuğrul Düzdağ, Mehmet Akif Ersoy, (Kapı yayınları, Stamboll, 2013), 132.

4 Shih. M. Orhan Okay – M. Ertuğrul Düzdağ, Mehmed Akif Ersoy, TDV İslâm Ansiklopedisi, 28/432-439. (Ankara: TDV Yayınları, 2003).

5 Shih. Mehmet Akif Ersoy, Mektuplar, (Atlas Kitap Yayınevi, Ankara, 2016), 7.

6 Ky citim dhe të gjithë citimet e tjera në këtë punim janë marrë nga libri: Mehmet Akif Ersoy, *Letra nga mërgimi*, A PUBLISHING, Prishtinë, 2023.

7 Mehmet Akif Ersoy, Mehmet Akif Ersoy’un Aile Mektuplar, (Mehmet Akif Ersoy Üniversitesi Yayınları, Burdur, 2010), 131.

8 Shih. Mehmet Akif Ersoy, Fıraklı Nameler - Akif’in Gurbet Mektupları, (Timaş Yayınları, Stamboll, 2011), 4.



Kontributi i El Batanit (858 – 929) në zhvillimin e shkencave

M.sc Artan S. Mehmeti

Ebu 'Abd Allah Muhamed ibën Xhabir ibën Sinan el Rakki el Harrani es-Sabi' el Battani, lindi në qytetin Harran në Mesopotami e Epërme, e që në kohët moderne i takon Turqisë. Në Perëndim është i njohur si Albategnius. Ai ishte një matematikan, astronom, astrolog, por një kontribut të madh e dha edhe në zhvillimin e shkencës së kozmografisë dhe gjeografisë.

El Batani njihet si astronomi më i madh i kohës së tij, gjithashtu ai ishte një nga astronomët më të njohur gjatë kohës së Mesjetës. Konsiderohet si një nga 20 astronomët më të famshëm të botës. Ishte pjesëtar i familjes mbretërore Sa'bit Harranit. Mësimet e para i mori nga i ati i tij (Xhabir ibën Sinan el Batani), i cili gjithashtu ishte një shkencëtar i njohur. Për t'u avancuar edhe më tej në shkencë, El Batani, shkoi në qytetin El Raka, i ndodhur në brigjet e lumit Eufrat. Gjatë qëndrimit në qytetin El Raka (877-929), ai bëri zbulime të rëndësishme në shkencën e astronomisë. Sipas profesor Filip Hitit, El Batani, bëri përmirësime të studimeve të Ptolomeut, duke i korrigjuar lëvizjet e Hënës dhe të disa planetëve. Ai përpiloi edhe disa tabela të reja rreth lëvizjes së Diellit dhe Hënës. Këto tabela për një kohë të gjatë janë pranuar nga studiuesit si tabela të sakta duke u bazuar në to.

Duke vëzhguar hapësirën qiellore, El Batani ishte në gjendje të klasifikonte saktësisht 489 yje. Tabelat e tij përmbajnë katalog të yjeve të palëvizshëm për vitet 880-81 (jo 911-12). Ai gjithashtu studioi eklipsin diellor, ku nga këto studime përpiloi të dhënën më të saktë për sa i përket stinëve të vitit, llogarit orbitën ekliptike (me pamje vezake), bëri llogaritjen e stinëve dhe vitit tropikal si dhe mesataren e vitit tropikal. Një nga arritjet më të mëdha të El Batanit në astronomi është llogaritja e saktë që i bëri vitit diellor. Sipas tij, viti diellor ka 365 ditë, 5 orë, 46 minuta e 24 sekonda. Kjo vlerë është më e ulët për dy minuta dhe dy sekonda se vlera e matjeve të fundit (365 ditë, 5 orë, 48 minuta e 46 sekonda).

El Batani gjithashtu zbuloi që largësia e Diellit kishte ndryshuar për rreth 16 gradë e 47 minuta që nga koha e matjeve të Ptolomeut. Zbulimi shpjegon lëvizjen e planetëve rreth Diellit, si dhe ndryshimin e vogël që kanë pësuar që nga koha e matjeve të Ptolomeut e deri në kohën e matjeve të El

Batani. Disa nga matjet e tij ishin më të sakta se matjet e kryera nga Koperniku, shumë shekuj më vonë. Hulumtuesit këto matje më të sakta të El Batanit në dallim nga studiuesit e tjerë, i arsyetojnë se El Batani ka qenë në një pozicion gjeografik që ka qenë më afër me gjerësinë jugore, e cila mund të ketë qenë më e favorshme për vëzhgimet e tij. Ndryshimi më i theksuar në vëzhgimet e Ptolomeut nga ato të El Batanit, është variacioni i diametrit të dukshëm këndor të Diellit, e që solli shpjegime të ndryshme mbi eklipsin. Mbasi që e rishikoi orbitën e Hënës dhe planetëve, ai solli një teori vërtet të vlefshme mbi përcaktimin e kushteve për lindjen e Hënës së re. Studiuesi i njohur, Dunthorn, në vitin 1749, e përdori studimin e El Batani mbi eklipsin e Hënës dhe të Diellit, për të përcaktuar shpejtësinë e lëvizjes së Hënës. El Batani ka zbuluar se drejtimi apogje (largësia maksimale e Tokës prej Diellit që ndryshe quhet Ahel) i Diellit është ndryshe nga drejtimi që e ka përshkruar Ptolomeu (në modelin heliocentrik kjo ndodh për shkak të ndryshimit ekscentricitet të vektorit të orbitës së Tokës). Ai gjithashtu paraqiti ndoshta në mënyrë të pavarur nga astronomët indianë të shekullit V, (të cilët e quanin Aryabhata), përdorimin e sinusit në përlogaritje, si dhe pjesërisht atë të tangjentës. El Batani përcaktoi me saktësi këndin e ekuinoksit në 54.5" ose 1° në 66 vjet, si dhe pjerrësinë ekliptike në 23° 35'. Koperniku, pesë shekuj pas tij, tha se ishte 23°. Pra El Batani mundi të gjente vlerën e njohur të këndit me një ndryshim prej rreth gjysmë minute. Ai gjithashtu prezantoi zgjidhjen e shumë problemeve të trigonometrisë sferike me përdorimin e projekteve ortografike. Ishte puna e El Batanit në përcaktimin lëvizjeve fikse të disa yjeve, që i ndihmoi Heveliusit të zbulonte variacionet rrethore të lëvizjes së Hënës.

El Batani shpjegon në dy mënyra shkencore rrotullimin e Tokës rreth Diellit. Po ashtu, ai përsosi studimet astronomike të El Hvarizmit më anë të kërkimeve të freskëta mbi sipërfaqen e Hënës së re, mbi eklipsin e Diellit dhe Hënës mbi paralakset. Llogaritja më saktësi më të madhe e formës oblike të eklipsit ka bërë të mundur që ai të zbuloi metoda të reja, e të posaçme për përcaktimin e gjerësisë gjeografike të një vendi. Kalkulimet e tij të eklipsit të Hënës dhe të Diellit u



kanë shërbyer astronomëve të shekullit XVIII. Sipas të dhënave të deritanishme, El Batani është shkencëtari i parë që ka përcaktuar ekliptikën, vitin tropik dhe stinët.

Librat shkencor të El Batanit në fushën e astronomisë dhe gjeografisë janë:

- Libri më i njohur i El Batanit është libri më titull “Kitab ez Zixh es Sabi”. Ky libër është i bazuar kryesisht në teorinë e Ptolomeut dhe në burimet e tjera greko-siriane, por shumë pak, ai është bazuar edhe në burime indiane dhe perse. Në këtë libër, El Batani përshkruan disa të dhëna për instrumentin astronomik të quajtur Kitara;

- “Kitab ez Zixh es Sabi”, është pa dyshim njëra ndër librat e tij më të rëndësishme. Ky libër përmban zbulimet e vërtetimit të planetëve, që ai i drejtoi në vitin 299 h, si dhe tabelat e lëvizjes së trupave qiellorë. El Batani zbuloi gjithashtu edhe vepra të ndryshme astronomike të cilat i ndërmori nga viti 264 deri në vitin 306 h. Ai përmbante “zixh-in” ose efemeridin e parë (“zixh” është një term persisht, që ka të bëjë me efemeridet e vjetra), i cili përmbante një informacion të vjetër dhe të saktë. Ky libër pati ndikim të madh në zhvillimin e astronomisë dhe matematikës, gjatë rilindjes arabe-islame ose në fillim të rilindjes evropiane. Disa shkencëtarë arab u mbështetën në të për llogaritjet e tyre, ndërsa disa prej tyre cituan ose interpretuan pjesë të përmbajtjes së tij. Ky libër është përkthyer në latinisht nga Tivok Platof në shekullin XII me titull “Scienza de Stellarum” dhe është shtypur në Nuremberg në vitin 1573. Në shekullin XIII, mbreti i Kastiljes, Alfonso X, urdhëroi përkthimin e këtij libri nga arabishtja në spanjisht. Një dorëshkrim jo i plotë i këtij përkthimi gjendet në Paris. Një kopje e këtij libri gjithashtu gjendet edhe në Vatikan. Karlo Nellino botoi një tirazh të origjinalit në arabisht, të marrë nga kopja e El Eskorial në tri vëllime në Romë (1899-1907), të shoqëruar me përkthimin në latinisht dhe komente në disa çështje;

- Në dy librat e titulluar “Risale fi Mikdar el Ittissalat” dhe “Risale fi Tahkik Akdar el Ittissalat”, El Batani merret me çështjen e harmonisë së dy planetëve, si në gjerësi ashtu dhe në gjatësi, qoftë nëse ata janë në të njëjtën orbitë, qoftë nëse njëri prej tyre është jashtë kësaj sfere;

- Libri me titullin “Sherhu el Mekalat el Arba’ Libatlimus”, është komentim që El Batani i bënë “Almagestin” të Ptolemeut;

- Libri me titull “Tadil el Kevakib”, është një libër tjetër që El Batani i studioi dallimet mes lëvizjeve të planetëve brenda orbitave të tyre, si një vlerë konstante dhe për lëvizjet e tyre të vërteta të cilat ndryshojnë nga një pozicion në tjetër.

Puna e El Batanit është konsideruar si shumë e rëndësishme për zhvillimin e astronomisë. Koperniku e citoi El Batanin në librin e tij, nga është nisur revolucioni i Kopernikut me titull “De Revolutionibus Orbium Coelestium”, jo më pak se 23 herë, si dhe në librin tjetër të tij më titull “Commentariolus”. El Batani u citua shpesh mes të tjerash edhe nga autorët të tjerë si: Tycho Brahe, Riccioli etj.. Kepler dhe Galileo kanë shprehur interes për disa vëzhgime të tij. Disa të dhëna të El Batanit vazhdojnë të përdoren në gjeofizikë. Për nder të punës së madhe që bëri zhvillimin e astronomisë, krateri i Hënës i njohur si Albategnius, është emetuar me emrin e El Batanit, autori i romanit “Night of the Humans”, i autorit Doctor Who, një sistem diellor e quan si Batani 045.

Burimet:

1. *Kontributet myslimane në qytetërimin botëror*, përgatitën për botim: M. Basheer Ahmed, Md; Ambassador Syed A. Ahsani; Dilnawaz A. Siddiqui, Phd, përktheu: Festime Mehdiu Gashi, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam (AIITC), Tiranë 2019,
2. Sigrud Hunke, *Dielli i Allahut shkëlqen mbi Perëndimin*, Trashëgimia jonë arabe, Shqipëri nga frëngjishtja Ornella Ademovi, Tiranë 2007.
3. Sami Frashëri, *Qytetërimi Islam*, LOGOS-A, Shkup, 2009.
4. Xhorxh Sarton, *Historia e shkencës islame*, Përktheu, plotësoi me shtojcë dhe përgatiti për botim: Ermal BEGA, Botoi: Qendra Shqiptare për Studime Orientale – A.C.E.O.S. B-O-O-K-S, (botimi i dytë) Tiranë 2020.
5. HALIMA AL-GHRARI, ARKITEKTËT E MENDIMIT SHKENCOR NË QYTETËRIMIN ISLAM Vula nga biografitë e dijetarëve myslimanë në periudha të ndryshme, Nga arabishtja në anglisht e përktheu: Abdulaziz HAUARIA, Përktheu nga gjuha angleze: Ermal BEGA, Botoi: Qendra Shqiptare për Studime Orientale – A.C.E.O.S. B-O-O-K-S, (botimi i dytë) Tiranë 2020.
6. Dr W. Hazmy C.H. Dr Zainurashid Z. Dr Hussaini R., *BIOGRAPHY Muslim Scholars and Scientists*, Published by: Islamic Medical Association of Malaysia N. Sembilan, (<https://docs.google.com/file/d/0B-e6qHPbXsDNd1oxMUVCVG82a0E/edit>).
7. Dr. Muhamad Adil Afridi, *CONTRIBUTION OF MUSLIM SCIENTISTS TO THE WORLD: AN OVERVIEW OF SOME SELECTED FIELDS*.
8. (http://irep.iium.edu.my/8415/1/Contribution_of_Muslim_Scholars_to_the_world.pdf).
9. Muslim Scientist & Their Contribution, Muslim Scientist & Their Contribution. (<http://www.cspoint.yolasite.com/resources/Muslim%20Scientist%20%26%20Their%20Contribution.pdf>).
10. Islamic Science 3 Stephen R. Addison September 30, 2003, (<https://faculty.uca.edu/saddison/SciBiog/Names.pdf>).
11. <https://en.wikipedia.org/wiki/Al-Battani>.
12. <http://www-history.mcs.st-andrews.ac.uk/Biographies/Al-Battani.html>.
13. <http://www.muslimheritage.com/article/impact-al-battani-european-astronomy>.
14. <http://www.lchr.org/a/49/as/dijetare/al-batani.html>.
15. <https://www.zaman.mk/al/nga-jeta>.

Bota solidarizohet me të prekurit nga tërmeti

Bajram Pomak

Më 6 shkurt 2023, Turqia, e bashkë me të edhe shteti i saj fqinj – Siria, u zgjuan në orën 04:17, në një mëngjes tragjik që ndryshe u emërua edhe si ‘Katastrofa e shekullit’. Turqia më shumë, madje edhe shteti sirian, u tronditën nga një tërmet prej 7.7 shkallësh. Shteti turk që gjendet në rripin sizmik, në të kaluarën përjetoi shumë tërmete, çdo 6 apo 7 vite ndodh nga një tërmet prej 7 ballësh, por ky ishte shumë i ndryshëm. I ndryshëm, sepse tërmeti i përfshiu dhjetë qytete dhe nga ky u prekën 13.5 milion njerëz. Turqia pra është shtet i tërmeteve, dhe sipas studimeve të bëra, kësaj radhe ky ishte kaq i ndryshëm dhe rrënues, sepse në të njëjtin rajon brenda ditës së njëjtë i pari ndodhi në orën 04:17, me një fuqi prej 7.7 ballësh, kurse i dyti në ora 13:24 me një fuqi prej 7.6 ballësh. Veçse tërmetet nuk ishin të kufizuara vetëm me këta dy tragjikët, sepse pos tyre, brenda ditës së njëjtë ngjanë edhe dy tërmete të tjera, njëri në 6.6 ballë dhe tjetri në 6.0 ballë. Duke u bazuar në studimet e bëra nga shkencëtarët që më parë, gjejmë se ata veç kishin prognozuar se këtu pritej një tërmet. Veçse shkenca nuk ia doli mbanë ende ta kuptojë kur dhe në çfarë përmasash do të ndodhë tërmeti. Duke u bazuar në paralajmërime (Drejtoria për Katastrofa dhe Menaxhim të Emergjencave), para tri vitesh e zgjodhi qytetin Kahramanmaraş si pilot rajon dhe realizoi ushtrime për mundësitë e manovrimit në rast të një tërmeti të vërtetë. Prej kësaj që ndodhi e kuptuam se askush s’e priste tërmetin të jetë kaq i fuqishëm. Një deklaratë e një profesori ishte e tillë: “Turqia nuk pa tërmet të tillë, kurse në nivel botëror ky është i rrallë”.

Një tërmet kaq i fuqishëm, gjithsesi që në nivel të shtetit solli rrënime dhe dëme materiale e shpirtërore. Sipas shifrave të deklaruara së fundmi, më shumë se 41 mijë njerëz (dhe ato kanë tendencë të rritjes të mëtejshme) ndërruan jetë dhe më shumë se 115 mijë janë të plagosur. Dëmi material nuk është vlerësuar ende. Parashikimet thonë se dëmi material është në mes të 100 dhe 150 miliard dollarë. Mirëpo, për ta



ditur dëmin në mënyrë të saktë, duhet të bëhen edhe shumë punë dhe të kalojë edhe shumë kohë. Këtu duhet të themi se edhe ata që vrapuan t’ju ndihmojnë të tjerëve në momentet e tërmetit, u viktimizuan prej tij. Për këtë arsye, punimet për kërkim-shpëtim mund të nisin 3 orë pas tërmetit. Fuqia e tërmetit ishte aq e madhe sa që u çka toka, u fundosën rrugët dhe u prishën pistat e aeroporteve. Kjo situatë e vështirësoi punën e ekipeve të kërkim shpëtimit. Për shkak të prishjes së rrugëve nuk mund të arrihej në shumë vende dhe për shkak të prishjes së pistave të aeroporteve ndihmat nuk arritën në kohë. Gjatë orëve të para rajoni ishte i përfshirë nga kaosi. Pra, jo vetëm Turqia, por edhe shteti sirian në shiritin kufitar pësoi nga ky tërmet, ani pse, jo në të njëjtat përmasa të tragjedisë. Por pas organizimit të mirë të Republikës së

Turqisë, këto pengesa u larguan sa më parë dhe u përshpejtuan punimet për kërkim-shpëtim. Pas kësaj ngjarjeje, shteti shpalli alarm të nivelit të 4-të. Alarmi i nivelit të 4-të nënkupton pranim të çdo lloji ndihmese që vjen nga shtetet fqinje. Shumë vende të botës deklaruan se janë gati ta përkrahin Turqinë dhe thuajse nga të gjitha vendet e botës erdhën ekipe të kërkim shpëtimit. Ndoshta për rrethanat e njohura politike këtë fat nuk e gëzoi edhe Siria.

Natyrish që një ndër këto shtetet që ofruan ndihmë për zonat e prekura nga tërmeti, është edhe Kosova. Madje Kosova dhe Shqipëria nuk u kufizuan me dërgimin e ekipeve ndihmëse, por Kosova, datën 8 shkurt, e shpalli ditë zie, kurse Shqipëria e shpalli 13 shkurtin. Natyrish që këto vendime ishin shumë të rëndësishme në kuptim të solidarizimit simbolik me Turqinë. FSK-ja, në zonën e prekur nga tërmeti, kreu detyra shumë të rëndësishme, duke i nxjerrë viktimat nga gërmadhat dhe kështu na bënë të ndihemi krenarë. Natyrish që dërgimi i kaq grupeve të kërkim shpëtimit në Turqi, ndërlidhet me politikën e jashtme të saj. Kudo që pati kriza në botë, Turqia ndërhyri me kapacitetet humane dhe kontribuoi në zgjidhjen e tyre. Kundruar nga ky prizëm, gjatë viteve të fundit, Turqia ishte shteti që dhuroi më së shumti krahasuar me GDP-në e saj. Në sajë të kësaj politike të jashtme të ndjekur nga Turqia dhe fuqisë së saj të butë, shtetet e ndryshme thuajse hynë në radhë për ta ndihmuar këtë shtet. Prej ditësh televizionet folën për mrekullitë që dilnin prej nën gërmadhave. Madje kishte njerëz që dilnin gjallë edhe pas dhjetë ditësh. Gjithsesi këto ishin lajme të gëzueshme, por numri i viktimave është i madh. Ata që shkuan në atë zonë, thonë se nuk mund të kenë fotografi apo ndonjë video me të cilën mund ta tregojnë gjendjen.

Për shkak të kësaj katastrofe, shumë fëmijë mbetën bonjakë. Shumë prindër i humbën fëmijët e tyre. Numri i tyre që e humbën tërë familjen, është i madh. Ballafaqimi me këto vuajtje është jashtëzakonisht i vështirë. Veçse këta njerëz që i shihnim në televizione nuk revolttoheshin. Thoshin se tërë kjo është sprovë dhe përpiqeshin të qëndronin të fortë. Pas këtij qëndrimi të fortë, natyrish se qëndron besimi i fortë. Në fakt, pas kësaj katastrofe, po sprovohet tërë njerëzimi. Në atë vend thuajse çdo kush u përpoq të bëjë diç, me aq sa mundej. Në mesin e tyre ishte edhe Kosova, e cila u organizua në mënyrë të jashtëzakonshme. Sa e sa OJQ dhe institucione nisën fushatat humanitare. Njëra ndër më të rëndësishmet prej tyre ishte fushata e Bashkësisë Islame që e realizoi gjatë ditës së premte, pas namazit të xhumasë. Këtu e pamë dhe u emocionuam nga gjallëria dhe ndjenja e solidarizimit të xhematit. Shikuar nga aspekti i solidarizimit me zonat e prekura nga tërmeti në Turqi, Kosova e shprehu miqësinë e saj në të gjitha aspektet. Informatat që i ndanë me ne ekipet e kërkim-shpëtimit, ofronin mjaft për ta kuptuar nivelin e

“Më së vështiri ishte t’i dëgjosh zërat poshtë gërmadhave e të mos mund t’ju ndihmosh.”

*Egzon Syla,
komandant i FSK-së,*

katastrofës. Gjatë një interviste të realizuar, një pjesëtar i ekipeve të kërkim-shpëtimit nga Bosnjë e Hercegovina, tha se para se të niseshim e kishim një imazh të gjendjes së atjeshme, por kur arritëm mbetëm gojë hapur.

Egzon Syla, që ishte prej komandantëve të FSK-së, tha se më së vështiri ishte t’i dëgjosh zërat poshtë gërmadhave e të mos mund t’ju ndihmosh. Në të njëjtën mënyrë edhe ekipet e tjera të kërkim-shpëtimit i tregonin vështirësitë me të cilat ballafaqoheshin, kur i nxirrnin kufomat nën gërmadha. Mes të tjerash, thanë se i gjetën tri kufoma, që ishin të nënës, babait dhe vajzës të përqafuar me njëri-tjetrin, dhe se këtë nuk do ta harrojnë kurrë. Kjo ngjarje dhe shumë të tjera, janë

vulosur në mendjet e njerëzve dhe se të tillat do t’i ndjekin ata njerëz gjatë tërë jetës së tyre. Pasi që shteti i përfundoi angazhimet në kërkim-shpëtim, i nisi punët për mbulim të plagëve. Presidenti Erdogan, tha se brenda një viti do ta rindërtojë atë zonë. Mes të tjerash, gjithashtu, tha se punimet nuk do të kenë përfundim të ndërtesave, por rindërtim nga zeroja. Në të njëjtën mënyrë, edhe ministri i Ambientit, Urbanizmi dhe Ndryshimeve klimatike, Murat Kurum, tha se punimet do të nisin brenda tre muajve dhe se brenda një viti do t’ia dorëzojnë shtëpitë e të prekurve nga tërmeti. Dalja nga një rrënim i tillë i fuqishëm brenda një kohe kaq të shkurtër, e tregon fuqinë e Republikës së Turqisë. Sikurse e theksuam edhe më parë, dëmet materiale edhe mund të maten, por jo ato transcendentale, të cilat është vështirë të riparohen. Për shkak të kësaj ngjarjeje u përgjysmuan shumë familje që i humbën të afërmit. Kjo nuk përshkruhet, sepse ata që shkuan nuk kthehen mbrapa, kurse atyre që mbetën pas, i dëshirojmë durim. Ky tërmet nuk e goditi vetëm Turqinë, por edhe Sirinë, e cila u dërrmua prej vitesh nga lufta. Por fatkeqësisht, për shkak të vështirësive për të arritur atje, nuk po merren as prej aty informata të shëndosha. Vuajtjet e përjetuara aty, bota nuk munda t’i dëgjojë aq dhe nuk mundi t’i dërgojë ndihmat. Dramë e madhe po ndodh edhe në atë vend, por bota atë nuk po e sheh aq.

Uroj që bota të nxjerr mësim nga kjo katastrofë. Ndërtesat i bëjnë në përputhje me ligjin dhe pjesën tjetër t’ia lejmë Allahut xh.sh.. Këtë e themi sepse sado që tërmeti në Turqi të jetë i fuqishëm, kjo gjendje është edhe rezultat i mospërfilljes së njerëzve. Për shkak të kësaj, edhe policia edhe prokuroria, po i realizojnë angazhimet e tyre dhe po i arrestojnë ndërtuesit mashtrues. Nesër këta njerëz do të japin llogari për këto ndërtesa të qelbura dhe jetë e humbura të njerëzve. Pra kjo është ana tjetër e medaljes. Njerëzve që ndërruan jetë nga tërmeti në Turqi dhe në Siri, ua shprehim ngushëllimet tona dhe lutemi për ata. Urojmë që Allahu xh. sh. të mos e sprovtojë më askënd dhe askund në këtë mënyrë. Kurse njerëzve ju takon të nxjerrin mësim nga këto katastrofa.

Muhamed Naim Jasin (1943 – 2023)

JETA DHE VEPRA E TIJ

Mr. Artan Musliu

Prof. dr. Muhamed Naim Jasin ishte një prej dijetarëve, studiuesve dhe autorëve më të njohur bashkëkohorë në botën islame. Ai rrjedh nga një familje me tradita të hershme islame, familje me virtyte dhe me traditë të lashtë palestineze. Muhamed Naim Jasin lindi më 11.06.1943 dhe ishte me origjinë nga Palestina.

SHKOLLIMI I TIJ

Muhamed Naim Jasin, shkollimin e tij fillor e kishte kryer në vendlindjen e tij. Pastaj, më 1964, diplomoi në Fakultetin e Sheriatit në Universitetin e Damaskut. Në vitin 1965, në po të njëjtin universitet, diplomoi në Fakultetin e Drejtësisë. Në vitin 1968, diplomoi në shkallën master në drejtimin Fikh el Mukaren, në Universitetin e Az'harit. Po të njëjtin vit, pra më 1968, diplomoi për herë të dytë në master në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Kajros. Ndërsa, në vitin 1972, përfundoi studimet e doktoratës në Fakultetin e Sheriatit në Universitetin e Az'harit, në drejtimin Fikh el Mukaren.

Si një student i dalluar, ai ishte përfitues i bursave studentore si në fakultet, ashtu edhe në master dhe në doktoratë. Prej tij ishte kërkuar edhe botimi i disertacionit të doktoratës. Ai fitoi çmimin e parë në fushën e fikhut të mjekësisë, çmim ky që ndahet nga Departamenti i të Arriturave Shkencore të Ministrisë së Arsimit në Kuvajt. Këtë çmim e fitoi në vitin 1989.

VEPRIMTARIA E TIJ AKADEMIKE

Muhamed Naim Jasin ushtroi disa veprimtari akademike. Ai ishte profesor i rregull në Universitetin e Jordanisë, në Fakultetin e Sheriatit, që nga viti 1992 e deri në vdekje; profesor në Universitetin e Katarit, në Fakultetin e Drejtësisë (1995 – 1998); profesor i rregullt në Universitetin e Kuvajtit, në Fakultetin e Sheriatit (2000 – 2001); Profesor në Universitetin Botëror të Shkencave Islame, në Fakultetin e Sheriatit (2008 – 2009); ndihmës profesor në Universitetin e Jordanisë dhe të Kuvajtit, në Fakultetin e Sheriatit (1978 – 1992); ndihmës profesor në Universitetin e Jordanisë, në Fakultetin e Sheriatit (1972 – 1978); dekan i Fakultetit të Sheriatit dhe Politikës Islame në Universitetin e Kuvajtit (1986 – 1990); dekan i Fakultetit të Sheriatit në Universitetin e Jordanisë (1977 – 1979); dekan i Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin Botëror të Shkencave Islame (2008 – 2009); themelues i Fakultetit të Sheriatit pranë Universitetit të Kuvajtit; pjesëmarrës në grupin punues të hartimit dhe përpilimit të kurikulës mësimore për studimet e larta të Fakultetit të Sheriatit dhe Drejtësisë pranë Universitetit të Jordanisë, Katarit dhe Kuvajtit; anëtar i Komisionit Shkencor për Enciklopedinë e Fikhut, të botuar nga Ministria e Vakëfit të Kuvajtit (1980 – 1990); anëtar i Komisionit Shkencor për Ekonomi Islame, Konferenca

Si një student i dalluar, ai ishte përfitues i bursave studentore si në fakultet, ashtu edhe në master dhe në doktoratë. Prej tij ishte kërkuar edhe botimi i disertacionit të doktoratës. Ai fitoi çmimin e parë në fushën e fikhut të mjekësisë, çmim ky që ndahet nga Departamenti i të Arriturave Shkencore të Ministrisë së Arsimit në Kuvajt.



e parë rreth zeqatit, e mbajtur në maj të vitit 1984, në Kuvajt; anëtar i Komisionit për Zhvillimin e Sistemit të Investimeve Kolektive dhe Fondeve për të Mitur pranë Ministrisë së Drejtësisë në Kuvajt, në vitin 1985; anëtar i Këshillit për Fetva pranë Ministrisë së Vakëfit në Jordani (1990 – 1995); anëtar i Komisionit për editim të revistës shkencore që nxirrej nga Fakulteti i Sheriatit pranë Universitetit të Jordanisë, për studentët e studimeve të larta (1992 – 1995); anëtar i Komisionit për themelimin e Fakultetit të Sheriatit pranë Universitetit të Kuvajtit, në vitin 1982; anëtar i Komisionit për editim të revistës shkencore që nxirrej nga Fakulteti i Sheriatit pranë Universitetit të Katarit, për studentët e studimeve të larta (1995 – 1998); anëtar i Komisionit për Konferenca dhe Simpoziume Shkencore, pranë Fakultetit të Sheriatit në Universitetin e Katarit, në vitin 1995; anëtar i Komisionit për themelimin e Fakultetit të Gjyqësorit Islam pranë Universitetit të Katarit, në vitin 1996; anëtar i Komisionit për kurikulat, tekstet dhe plan programet mësimore, si dhe për udhëzuesit praktik për mësimdhënësit, pranë Komitetit të Studimeve të Larta dhe Politikave Arsimore që vepronte në kuadër të Ministrisë së Arsimit të Katarit, në vitin 1996; anëtar i Komisionit për Bibliotekat e Katarit, në vitin 1997; ishte anëtar i shumë bordeve dhe komisioneve për studime islame, revista shkencore, botime të ndryshme, recensime, redaktime, etj.

Është autor dhe bashkautor i dhjetëra librave të botuar brenda dhe jashtë vendit. Prej librave të tij më të njohur janë *“Besimi - bazat, esenca dhe negacioni”*, i botuar në vitin 1978.

PUNIMET E TIJ SHKENCORE

Prof. dr. Muhamed Naim Jasin është autor i shumë punimeve shkencore të publikuara në revistat prestigjioze, si brenda po ashtu edhe jashtë vendit.

Është autor dhe bashkautor i dhjetëra librave të botuar brenda dhe jashtë vendit. Prej librave të tij më të njohur janë *“Besimi - bazat, esenca dhe negacioni”*, i botuar në vitin 1978. Ky libër është përkthyer në shumicën e gjuhëve të botës dhe është një prej librave më të njohur që është mësuar në pothuajse në të gjitha universitetet e botës.

Ky libër ka gjetur përkrahje nga të gjithë myslimanët pa dallim bindjeje, fraksioni, gjuhe apo vendi. Po ashtu, ky libër është përkthyer edhe në gjuhën shqipe dhe ka disa ribotime.

Ka me dhjetëra libra të tjerë të cilët kanë qenë të përfshirë në kurrikula të vendeve të ndryshme, qoftë brenda apo jashtë vendit, duke filluar nga nxënësit e deri te studentët e studimeve të larta. Ishte mentor dhe anëtar i shumë disertacioneve të ndryshme për student të studimeve master dhe doktoratë, si brenda po ashtu edhe jashtë vendit.

VDEKJA E TIJ

Prof. dr. Muhamed Naim Jasin vdiq më 02.01.2023 në Aman të Jordanisë. Ai vdiq pas një sëmundje të rëndë duke lënë kështu një zbrazëti të madhe në botën islame, por që pas vetes ka lënë shumë punime shkencore, libra dhe shumë studentë anëmbanë botës, duke mos përjashtuar as trojet shqiptare.

Lusim Allahun xh.sh. që ta ketë mëshiruar dhe ta shpërblejë për mundin dhe kontributin e tij!

<https://www.odabasham.net>
<https://islamonline.net>
<https://ar.wikipedia.org/wiki>
<https://profyaseen.com/about/>
<https://arabi21.com/story>
<https://al-maktaba.org/book/31616/81963>

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM KRYETARIN E PRISHTINËS, Z. PËRPARIM RAMA



Më 8 shkurt 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim kryetarin e komunës së Prishtinës, z. Përparim Rama. Në fokus të këtij takimi qe diskutimi për projektet e

përbashkëta ndërmjet dy institucioneve gjegjëse, Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Komunës së Prishtinës, për të mirën e qytetarëve të Prishtinës. Myftiu Tërnavë falënderoi kryetarin Rama për bashkëpunimin e

deritanishëm me BIK-un dhe shprehu gatishmërinë e tij dhe të institucionit që ai drejton për një vazhdimësi të mëtejme të këtij bashkëpunimi.

MYFTIU TËRNAVA: “BASHKËNDIEJME DHEMBJE ME POPULLIN TURK”

Më 10 shkurt 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, vizitoi Ambasadën e Turqisë në Kosovë, për të shprehur ngushëllime për viktimat e tërmeteve që ndodhën në disa zona të Turqisë. Myftiu Tërnavë gjatë kësaj vizite takoi edhe zv.ambasadorin e Turqisë në Kosovë, znj. Seyda Cimeli Aydin. Ai tha se ne bashkëndiejmë dhembje me popullin turk, duke lutur Zotin që të vdekurit t'i shpërblejë me Xhenet, të lënduarve t'u japë shërim të shpejtë, ndërsa familjarëve të viktimave t'u japë durim që ta përballojnë sa më lehtë këtë provë. Po ashtu, për të shprehur ngushëllime, Myftiu Tërnavë qe për vizitë edhe në Zyrën për Çështje Fetare pranë Ambasadës së Turqisë, në të cilën u mirëprit nga këshilltari, z. Bunjamin Albayrak.



PROGRAM KULTUROR PËR NATËN E ISRASË DHE MIRAXHIT DHE PËRVJETORIT TË PAVARËSISË

Më 10 shkurt 2023, KBI i Prishtinës, organizoi tribunë me rastin e Natës së Israsë dhe Miraxhit dhe përvjetorit të 15-të të Pavarësisë së Kosovës. Ky program nisi me leximin e një pjese nga Kurani famëlartë dhe me intonimin e himnit të flamurit. Në këtë ngjarje mori pjesë, Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, i cili përgëzoi organizatorët për programin. Ai mbajti një ligjëratë të shkurtër rreth vlerës dhe rëndësisë që kanë këto dy ngjarje. Një fjalë rasti e mbajti edhe kryetari i KBI-së së Prishtinës, Hetem ef. Sopjani, si dhe mualimja Kadrije Dragusha-Ademi. Në fund të këtij programi u kënduan ilahi e këngë patriotike, si dhe monologë të përgatitur nga nxënësit e mektebeve.



MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM AMBASADORIN E AUSTRISË NË KOSOVË, Z. CHRISTOPH WEIDINGER



Më 13 shkurt 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim ambasadorin e Austrisë në Kosovë, z. Christoph Weidinger.

Myftiu Tërnavë e njohu mysafirin me funksionimin e institucionit të BIK-ut, si dhe me sfidat me të cilat ballafaqohet ai. Ai falënderoi ambasadorin dhe nëpërmes tij edhe shtetin e Austrisë për

ndihmën dhe përkrahjen e vazhdueshme për shtetin e Kosovës. Myftiu Tërnavë po ashtu vlerësoi se Bashkësia Islame e Kosovës ndër prioritet kryesore, e ka edhe kultivimin e tolerancës dhe mirëkuptimin ndërfetar e ndërnjerëzor, me qëllimin e vetëm që në Kosovë të mbretërojë paqja, respekti e toleranca ndërmjet besimeve dhe etnive të ndryshme.

Ambasadori Christoph Weidinger, falënderoi Myftiun për mikpritjen, dhe shprehu interesimin për organizimin dhe funksionimin e BIK-ut. Ai më tutje tha se institucionet dhe prijësit fetarë kanë rol të rëndësishëm në edukimin shpirtëror të masës së gjerë.

Në fund të takimit, të dyja palët ranë dakord që edhe më të thellohet bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve.

KOMANDANTI I KFOR-IT PRITI NË TAKIM PRIJËSIT E BASHKËSIVE FETARE TË KOSOVËS

Më 13 shkurt 2023, komandanti i KFOR-it, gjeneralmajor Angelo Michele Ristuccia, priti në takim prijësit e bashkësive fetare të Kosovës, kryetarin e Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiun Naim ef. Tërnavë, ipeshkvën Dodë Gjergji dhe peshkopin Teodosije Shibaliq. Myftiu Tërnavë në këtë takim shprehu përkushtimin e institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës për promovimin e paqes, tolerancës dhe bashkëjetesës ndërfetare në vend. Ai shprehu gatishmërinë e tij dhe të institucionit që ai drejton që edhe më tej të kontribuojë për harmoninë ndërfetare. Ky takim me prijësit fetarë u zhvillua për promovimin e dialogut ndërfetar dhe për rolin që kanë ata për forcimin e paqes. Komandanti Ristuccia, theksoi rëndësinë e komuniteteve fetare



për promovimin e paqes, tolerancës dhe respektit të ndërsjellë. Ai tha se fetë

janë pjesë e zgjidhjes për një bashkëjetesë harmonike.

MYFTIU TËRNASA U PRIT NË TAKIM NGA REISI I BFI-SË, SHAQIR EF. FETAI



Më 15 shkurt 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, qëndroi për vizitë në Bashkësinë Fetare Islame të Maqedonisë së Veriut, në të cilën u mirëprit nga reisi hfz. Shaqir ef. Fetai. Myftiu Tërnavë tha se institucionet tona gjegjëse, Bashkësia Islame e Kosovës dhe Bashkësia Fetare Islame e RMV-së,

kanë një bashkëpunim tejet të mirë, për të cilin tha se duhet vazhduar edhe në të ardhmen, për të mirën e besimtarëve të të dyja vendeve. Myftiu tha se qëllimi i kësaj vizite është thellimi i bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve fetare, duke diskutuar bashkërisht çështjet dhe projektet e përbashkëta, të cilat janë me interes për të dyja institucionet. Nga ana e tij, reisi Fetai, u

shpreh tejet i lumtur me vizitën që sot iu bë nga delegacioni i BIK-ut, i kryesuar nga Myftiu Tërnavë. Ai tha se ne si bashkësi na lidhin shumë gjëra të përbashkëta dhe kemi para vetes shumë projekte me interes, për të cilat nevojitet bashkërendim dhe koordinim mes vete, që të realizohen në formën më të mirë.

MYFTIU TËRNASA PRITI NË TAKIM AMBASADORIN E ARABISË SAUDITE, FEISAL HEFZI



Më 16 shkurt 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim ambasadorin e Arabisë Saudite, Feisal Hefzi. Myftiu Tërnavë fillimisht i uroi mirëseardhje mysafirit, e më pas e

njohu atë me punët, angazhimet dhe sfidat me të cilat përballon institucioni i Bashkësisë Islame të Kosovës. Më pas Myftiu Tërnavë shpreh falënderimet e tij për përkrahjen dhe ndihmat e vazhdueshme që ka dhënë shteti i

Arabisë Saudite për popullin e Kosovës. Myftiu shpreh gatishmërinë e institucionit të BIK-ut që të vazhdojë edhe më tej bashkëpunimin e mirë ndërmjet BIK-ut dhe Ambasadës së Arabisë Saudite. Nga ana e tij, ambasadori Feisal Hefzi, shpreh falënderimet e tij për mikpritjen dhe për gatishmërinë e BIK-ut që të vazhdojë bashkëpunimi ndërmjet BIK-ut dhe Ambasadës së Arabisë Saudite. Ai edhe njëherë çmoi lart kontributin e Myftiut Tërnavë dhe të Bashkësisë Islame të Kosovës për promovimin e vlerave qytetare në vend dhe për harmoninë fetare e cila ekziston në Kosovë. Dy palët u pajtuan që bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve të thellohet edhe më në të mirë të qytetarëve të Kosovës.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM PËRFAQËSUESIT E QENDRËS “MBRETI SELMAN”

Më 16 shkurt 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim përfaqësuesit e qendrës “Mbreti Selman”, të Mbretërisë së Arabisë Saudite, z. Abdurahman al Mutejri dhe dhe Muadh Sulejman.

Tërnavë i falënderoi për kontributin e vazhdueshëm të autoriteteve saudite, si dhe për bashkëpunimin shumë të mirë që kanë me qendrën “Mbreti Selman” të Mbretërisë së Arabisë Saudite. Myftiu Tërnavë dhe përfaqësuesit e qendrës “Mbreti Selman” nënshkruan një marrëveshje për dërgimin e 2400 pakove ushqimore për familjet nevojtare në Kosovë, e cila do



të realizohet në prag të muajit Ramazan. Nga ana e tyre, Abdurahman al Mutejri dhe Muadh Sulejman, thanë se ndjehen mjaft të lumtur për realizimin e këtij projekti me BIK-un. Ata prematuan se

në të ardhmen do të ketë edhe projekte të tjera në ndihmë popullit të Kosovës, të cilat do të realizohen në bashkëpunim me BIK-un.

MYFTIU TËRNAVA TAKOI AMBASADORIN E RI TË TURQISË NË KOSOVË, Z. TUNÇ ANGILI



Më 22 shkurt 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, vizitoi Ambasadën e Republikës së Turqisë në Kosovë, në të cilën u mirëprit nga ambasadori i ri i kësaj Ambasade, z. Tunç Angilı.

Myftiu Tërnavë fillimisht i dëshiroi ambasadorit punë të mbarë dhe të suksesshme në misionin e ri. Më pas, në emër të tij dhe në emër të gjithë besimtarëve myslimanë, i shprehu ngushëllime për viktimat e tërmetit që goditi Turqinë disa ditë më parë. Ai

shprehu dhimbjen dhe solidaritetin e tij me të gjithë të prekurit nga ky tërmet, duke lutur Zotin që të lënduarit t'i shërojë sa më parë, ndërsa të vdekurit, Zoti t'i ketë marrë me mëshirën e Tij. Me këtë rast, Myftiu Tërnavë, tha se besimtarët tanë, gjatë aksionit që kemi organizuar në të gjitha xhamitë e Kosovës kanë grumbulluar 400,500.00 euro (katërqindmijë e pesqind euro), si mbështetje materiale për të prekurit nga tërmeti, të cilat u transferuan sot në llogarinë bankare të Ambasadës.

Nga ana e tij, ambasadori i Turqisë, z. Tunç Angilı, falënderoi Myftiun Tërnavë për vizitën dhe për solidaritetin e treguar të besimtarëve myslimanë të Kosovës me të prekurit nga tërmeti. Ai tha se popullit turk është tejet mirënjohës dhe falënderues ndaj popullit vëlla kosovar për solidaritetin e treguar me popullin vëlla turk, si dhe për mbështetjen morale, me të cilën kanë dëshmuar vëllazërinë dhe miqësinë e thellë ndërmjet dy popujve.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM KRYETARIN E BASHKËSISË ISLAME TË AUSTRISË, Z. YMIT VURAL



Më 22 shkurt 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim një delegacion të Bashkësisë Islame të Austrisë, të kryesuar nga kryetari i kësaj Bashkësie, z. Ymit Vural. Kryetari Vural shoqërohej në takim nga kryetari i Komunitetit Mysliman Shqiptar në Austri, ALKIG, Vahidin ef. Behluli dhe nga përgjegjësi për edukim në Bashkësinë Islame të Austrisë, z. Binur Mustafi.

Myftiu Tërnavë i uroi mirëseardhje në institucionin e BIK-ut kryetarit Vural, e më pas e njohu atë me funksionimin, sfidat dhe të arriturat e Bashkësisë Islame në Kosovës. Ai tha

se Bashkësia Islame e Kosovës është e përkushtuar për të bashkëpunuar me Bashkësinë Islame të Austrisë në fushat të cilat janë të rëndësishme dhe me prioritet për besimtarët e të dyja vendeve.

“Bashkësia Islame e Kosovës, përmes institucioneve të saj fetare dhe arsimore, Medresesë dhe Fakultetit të Studimeve Islame, mbetet e përkushtuar për përgatitjen e kuadrit fetar, të denjë për të qenë në shërbim të fesë islame dhe të besimtarëve, e të cilët do t'i mbrojnë parimet islame dhe besimtarët nga indoktrinimi i mundshëm dhe nga interpretimet radikale ekstreme, të cilat nuk kanë të bëjnë asgjë më Islamin e

pastër e burimor” – tha ndër të tjera Myftiu Tërnavë.

Nga ana e tij, kryetari Vural, falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen dhe për gatishmërinë e tij dhe të institucionit që ai drejton që të kenë një bashkëpunim të mirëfilltë ndërmjet dy institucioneve.

“Kontributi i komunitetit mysliman shqiptar, është i një rëndësie tejet të veçantë, në mbrojtjen dhe përfaqësimin e Islamit dhe të myslimanëve që jetojnë në Austri, andaj konsiderojmë se prezenca e tyre është një urë e fuqishme që lidh Bashkësinë Islame të Austrisë dhe vendet e tyre të origjinës, e në veçanti institucionet fetare të atyre vendeve” – tha kryetari Vural.

Në fund të takimit, Myftiu Tërnavë dhe kryetari Vural, nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi në fushën fetare, arsimore e kulturore, e fusha të tjera, siç janë shkëmbimi i kuadrove, projektet kulturore etj.

Gjatë kësaj vizite, kryetari Vural vizitoi edhe ShML “Medreseja Alaudin” dhe Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë.

MYFTIU TËRNAVA MORI PJESË NË SHËNIMIN E FESTËS KOMBËTARE TË KUVAJTIT NË TIRANË



Më 22 shkurt 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, mori pjesë në manifestimin për shënimin e festës kombëtare të Kuvajtit, i cili u mbajt në Tiranë. Ai në këtë manifestim u prit nga ambasadori i Kuvajtit në Shqipëri, z. Faisal Sulaiman Ali al Musaileem, të cilin e uroi për festën kombëtare të tyre. Myftiu Tërnavë, vlerësoi kontributin e shtetit dhe popullit të Kuvajtit për popullin e Kosovës dhe bashkëpunimin shumë të mirë që kanë me ambasadën kuvajtiane në Tiranë. Nga ana e tij, ambasadori Musaileem, falënderoi Myftiun Tërnavë për urimin dhe vizitën duke vlerësuar lart bashkëpunimin me BIK-un në realizimin e projekteve në të mirë të Kosovës. Në këtë vizitë, Myftiu Tërnavë, shoqërohej nga shefi i kabinetit, mr. Besim Mehmeti si dhe zv.sekretari Rexhep Luma.

U RESTAURUA XHAMIA DHE MEJTEPI I MULLA IDRIZ EF. GJILANIT

Më 16 shkurt 2023, në prag të 15-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës dhe në nderim të kontributit fetar dhe atdhetar të Mulla Idriz ef. Gjilanit, Këshilli i Bashkësisë Islame në Gjilan, përuroi xhaminë dhe mejtepin e Mulla Idriz ef. Gjilanit, në fshatin Dunavë të Gjilanit, restauruar nga Ministria e Kulturës, respektivisht Këshilli i Bashkësisë Islame në Gjilan. Në këtë ceremoni qenë të pranishëm kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Hajrulla Çeku, kryetari i Komunës së Gjilanit, z. Alban Hyseni, përfaqësues të partive politike, bashkëfshatarë dhe familjarë të Mulla Idriz ef. Gjilanit. Në fjalën e tij drejtuar të pranishmëve, Myftiu Tërnavë, vlerësoi lart kontributin dhe angazhimin fetar dhe kombëtar të hoxhës. “Në kohën kur pushtuesi serb po tentonte ta zhdukte gjithçka që ishte shqiptare e islame, figurat e shquara shqiptare, u vunë në ballë për ta mbrojtur vendin dhe kombin tonë. Mulla Idriz ef. Gjilani, luftoi për kauzën e bashkimit kombëtar, për të cilën edhe ra heroikisht. Amanetin e tij dhe të atyre që ranë heroikisht në luftën e



fundit, ne gjeneratat e reja duhet ta çojmë në vend” – tha ndër të tjera Myftiu Tërnavë. Ministri Çeku tha se Ministria e Kulturës mbetet e përkushtuar për rikthimin në vendin e merituar të trashëgimisë kulturore islame. “Ne do të vazhdojmë të punojmë me përkushtimin të madh dhe në bashkëpunim me Bashkësinë Islame të Kosovës për restaurimin e objekteve fetare islame.” Kryetari i Komunës, z. Alban Hyseni, tha se restaurimi i këtyre objekteve do t’ia kthejë hijeshinë këtij vendi dhe do ta bëjë atë qendër atraktive, ku qytetarët do ta vizitojnë dhe do të njihen me historikun dhe kulturën e vendit tonë. Ndërkaq

kryetari i Këshillit të BI-së së Gjilanit Naim ef. Aliu, falënderoi Ministrinë e Kulturës për bashkëpunimin në restaurimin e këtyre dy objekteve, duke potencuar faktin se, vetëm në Gjilan, nga Ministria e Kulturës janë restauruar tri objekte të trashëgimisë islame. Në emër të familjes së Mulla Idriz ef. Gjilanit, foli djali i tij, Isa Hajrullahu, i cili falënderoi KBI e Gjilanit dhe Ministrinë e Kulturës për restaurimin e këtyre dy objekteve. Krejt në fund, Këshilli i Bashkësisë Islame në Gjilan, ndau një mirënjohje për ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Hajrulla Çeku, të cilën ia dhuroi Myftiu Naim ef. Tërnavë.

TELEGRAM NGUSHËLLIMI NGA MYFTIU TËRNAVA ME RASTIN E TERMETIT NË TURQI

Prishtinë, më 6 shkurt 2023

Me dhembje të thellë morëm lajmin për tërmetin që goditi disa zona në jug të vendit tuaj.

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës ndan dhembje me vëllezërit e tyre turq pas tërmetit shkatërrues që goditi jugun e Turqisë në mëngjesin e sotshëm.

Andaj me këtë rast, e lusim Zotin xh.sh. që të vdekurit t’i shpërblejë me Xhenet, të lënduarit t’i shërojë sa më shpejtë, dhe familjarëve të të vdekurve, Zoti t’iu falë durim që ta kapërcejnë sa më lehtë këtë gjendje të rëndë.

Në këto çaste të vështira për popullin turk, Bashkësia Islame e Kosovës, por edhe tërë populli i Kosovës, ndan dhembjen dhe është me ju në çdo situatë. Andaj, pranoni ngushëllimet tona të përzemërta, me lutjet drejtuar Krijuesit Suprem që të falë mëshirë dhe durim për popullin tuaj në këto momente të vështira, për të tejkaluar sa më lehtë këtë gjendje të rënduar pas tërmetit të fuqishëm që goditi disa rajone të vendit tuaj!

KRYETARI

Myftiu Naim ef. Tërnavë



MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM KRYETARIN E KMSHZ-SË MEHAS EF. ALIJA

Më 27 shkurt 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim kryetarin e Komunitetit Mysliman Shqiptar të Zvicrës, njëherësh imamin e xhamisë “El-Hidaje”, Mehas ef. Alijan.

Myftiu Tërnavë e falënderoi z. Alijan për vizitën dhe për gjithë kontributin që janë duke dhënë ai dhe Komuniteti Mysliman Shqiptar në Zvicër për mirëqenien e besimtarëve myslimanë shqiptarë atje. Ai edhe njëherë rikonfirmoi gatishmërinë e tij dhe të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës që edhe më tej të vazhdohet dhe të intensifikohet bashkëpunimi ndërmjet këtyre dy institucioneve. Myftiu Tërnavë çmoi lart angazhimin dhe punën e deritanishme të KMSHZ-së. Nga ana e tij, kryetari Alija shprehu falënderimet e tij dhe të institucionit që ai drejton për bashkëpunimin dhe për ndihmën e ofruar nga Bashkësia



Islame e Kosovës sa herë që është kërkuar një gjë e tillë. Gjatë këtij takimi kryetari Alija dorëzoi te Bashkësia Islame e Kosovës shumën e mjeteve financiare të mbledhura nga mërgimtarët tanë për vërshimet që ndodhën para disa muajve në Kosovë.

KRYEIMAMI SAHITI PRITI NË TAKIM NËNKRYETARIN E KOMUNËS SË GRAÇANICËS, Z. LEUTRIM AJETI

Më 27 shkurt 2023, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, priti në takim nënkryetarin e Komunës së Graçanicës, z. Leutrim Ajeti.

Kryeimami Sahiti fillimisht i shprehu mirëseardhje nënkryetarit Ajeti e më pas e falënderoi atë për ndihmën dhe bashkëpunimin që ka ofruar për realizimin e ndarjes së parcelës për ndërtimin e xhamisë në Kishnicë. Ai tha se pas përfundimit të procedurave të bartjes së pronës dhe pajisjes me lejet e kërkuara, shumë shpejt, Bashkësia Islame e Kosovës, do të fillojë me ndërtimin e xhamisë në këtë vend, si një kërkesë e kamotshme e besimtarëve të asaj ane.

Nënkryetari Ajeti falënderoi kryeimamin Sahiti për mikpritjen, si dhe përgëzoi Bashkësinë Islame të Kosovës për gatishmërinë e treguar për ndërtimin e xhamisë në Kishnicë,



e cila besimtarëve do t'ua mundësojë kryerjen e adhurimeve dhe ritualeve fetare në kushte komode.

DREJTORI SIMNICA MORI PJESË NË TRIBUNËN E ORGANIZUAR NGA QENDRA ISLAME SHQIPTARE “DRITA” NË MULHOUSE

Më 4 shkurt 2023, drejtori i Diasporës në Bashkësinë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, mori pjesë në tribunën e organizuar me rastin e themelimit të xhamisë, në Qendrën Islame Shqiptare “Drita” në Mulhouse, të Francës, ku u prit nga kryetari z. Sinan Shala, anëtarët e kryesisë dhe nga xhemati i kësaj xhamie. Drejtori Simnica, në ligjëratën e tij, përshëndeti të pranishmit në emër të BIK-ut, dhe në emrin e Myftiut Naim ef. Tërnavë dhe vlerësoi punën, veprimtarinë dhe bashkëpunimin e kësaj xhamie me institucionin e BIK-ut. Në tubim mori pjesë edhe imami Fadil ef. Musliu, imami i xhamisë në Kalstruhe, Gazmend ef. Bajraktari dhe një numër i konsiderueshëm i xhematit.



DREJTORI SIMNICA MORI PJESË NË TRIBUNËN FETARE TË ORGANIZUAR NGA “EL-HIDAJE”

Më 11 shkurt 2023, drejtori i Diasporës në Bashkësinë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, qëndroi për vizitë në Zvicër, ku mori pjesë në tribunën fetare “Të gjithë për një xhami të re, për breza të tërë!”, të organizuar nga Bashkësia Islame “El-Hidaje” në St. Gallen. Drejtori Simnica, në fjalën e tij përshëndetëse, i uroi dhe i përgëzoi për iniciativën për

xhami të re, duke falënderuar kryetarin e xhamisë, imamin, kryesinë dhe xhematin për angazhimin, aktivitetet dhe të arriturat e tyre për këtë periudhë kohore. Drejtori Simnica, fjalimin e tij ia kushtoi rolit dhe rëndësisë së xhamive në përgjithësi, e në veçanti në Diasporë.



DREJTORI SIMNICA PRITI NË TAKIM IMAMIN E QENDRËS ISLAME SHQIPTARE NË KARLSRUHE, MUHAMED EF. HAVOLLIN

Më 23 shkurt 2023, drejtori i Drejtorisë së Diasporës në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, ka pritur sot në takim kryetarin, njëherësh imamin e Qendrës Islame në Karlsruhe, Muhamed ef. Havollin. Drejtori Simnica falënderoi imamin Havolli për vizitën dhe njëherësh nëpërmes tij falënderoi edhe tërë mërgatën tonë atje për kontributin që kanë dhënë në vazhdimësi për Kosovën. Nga ana e tij, imami Havolli, shprehu falënderime për mikpritjen që i bëhet çdoherë në IK, duke shprehur kështu gatishmërinë e tij si imam, që edhe më tej në të ardhmen të vazhdojë një bashkëpunim i mirë ndërmjet tyre dhe BIK-ut. Me këtë rast, imami Havolli, solli edhe një shumë të parave për renovimin e Medresesë “Alauddin”.



KËSHILLI DREJTUES I IHSI-SË MBAJTI MBLEDHJEN E RADHËS

Më 13 shkurt 2023, Këshilli Drejtues i Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame, ka mbajtur sot mbledhjen e radhës, të cilën e hapi dhe e kryesoi drejtori i këtij Instituti, Sabri ef. Bajgora. Ai para anëtarëve të këtij Këshilli shpalosi planet dhe projektet e Institutit për vitin 2023, duke falënderuar kështu anëtarët për kontributin e tyre përgjatë vitit 2022. Ndër pikat e rendit të ditës, për të cilat diskutoi Këshilli ishin përgatitja për konferencën që pritet të mbahet këtë vit, e që ka të bëjë me historikun, rolin, edukimin dhe trajtimin e xhamive në trojet tona. Më pastaj, Këshilli diskutoi edhe për përgatitjet për mbajtjen e dy tryezave për personalitetet,



Fahri ef. Iljazin dhe Hysen Latifin, e që parashihen të mbahen njëra në muajin maj, ndërsa tjetra në tetor të këtij viti. Këshilli Drejtues i IHSI-së gjithashtu

shqyrtoi projekt-propozimin për thesarin e bejtexhinjve nëpër shekuj, si dhe diskutoi për projekte të tjera.

DËSHMI DHE FAKTE RRETH INICIMIT TË NDËRTIMIT TË XHAMISË NË GRACË TË VOGËL TË LIPJANIT

Fshati Gracë të Vogël i Komunës së Lipjanit ka më shumë se 70 shtëpi dhe mbi 300 banorë. Pasi paraprakisht ishte siguruar trualli për ndërtimin e xhamisë, filluam nismën, kërkim-hulumtimin e mundësive për ndërtimin e xhamisë (paraprakisht ishte siguruar trualli), kërkesë imediate e komunitetit në këtë fshat.

Në këtë takim u dakorduar për t'i ftuar disa nga vullnetmirët e fshatit, të cilët pa hezituar janë përgjigjur ftesës (Prizren, Mehdi Sopa, Isuf Bresa, Ali Sopa dhe Milaim Qeriqi), me të cilët është vendosur krijimi i këshillit nismëtar për ndërtimin e xhamisë. Pjesëmarrës në këtë takim ishte sekretari i Përgjithshëm i Kryesisë së BIK-ut Ahmet ef. Sadriu, kryetari i KBI të Lipjanit, Xhevdet ef. Bytyçi, imami Mazllam Mazllami, Naser Bresa, përfaqësues nga fshati Grackë e Vogël (Mehdi Sopa, Ali Sopa, Milaim Qeriqi), bashkinicues të nismës. Në këtë takim, sekretari Sadriu e mori përgjegjësin në emër të BIK-ut për të siguruar donator për ndërtim të xhamisë.

Këshilli iniciues ka punuar në përgatitjen teknike-administrative, si



planprojektin, po ashtu dokumentet e tjera relevante për hapjen e rrugës për ndërtimin e xhamisë. Falënderimi i takon Allahut që e orientoi një vullnet mirë, donatorin nga Kuvajtin Hessa Ishak Ibrahim al Haxhiri, gjithsesi duhet vlerësuar përkushtimin eksplicit të sekretarit të përgjithshëm të Kryesisë së BIK-ut, Ahmet ef. Sadriu dhe më 24 dhjetor 2021 u falë edhe xhumaja e parë në xhami të re. Në këtë eveniment në emër të kryesisë së BIK-ut dhe Myftiut Tërnavë një fjalë rasti mbajti sekretari i përgjithshëm i Kryesisë Ahmet ef. Sadriu, i cili njëherësh mbajti edhe hytben e xhumasë. Ai më pas nënvizoi se BIK është i përkushtuar që t'u

përgjigjet kërkesave dhe nevojave të xhematit që t'u plotësojë nevojën e tyre për ngritjen e xhamive që obligimet e tyre t'i kryejnë sa më lehtë dhe në infrastrukturë të mirë për falje dhe aktivitete të xhamisë. Ai krejt në fund porositi që mësim-besimit më fëmijë t'i kushtohet rëndësi ku gjeneratat e reja do të formoheshin drejt si në aspektin fetar dhe kombëtar. Ndërkaq në emër të KBI të Lipjanit, foli kryetari i KBI-së në Lipjan, Zaim ef. Baftiu, kurse në emër të banorëve të fshatit, foli kryetari i fshatit prof. Ali Sopa, i cili edhe njoftoi për ecurinë e punimeve të xhamisë.

Dr. Sc. Naser Bresa

“BEREQETI” MORI PËRSIPËR RENOVIMIN E PESË SHTËPIVE NË MITROVICË

Më 1 shkurt 2023, drejtori i Shoqatës Humanitare Bamirëse “Bereqeti”, Behxhet ef. Ajvazi, i shoqëruar nga sekretari i kësaj shoqate, z. Xheladin ef. Fazliu, si dhe nga koordinatorët e shoqatës në Mitrovicë, Cena ef. Bala dhe z. Armend ef. Haxhiu, u pritën në takim nga kryetari i komunës së Mitrovicës, z. Bedri Hamza. Në këtë takim u bisedu lidhur me situatën në komunë pas vërshimeve dhe për dëmet e shkaktuara nga kjo fatkeqësi natyrore. SHHB “Bereqeti”, duke parë situatën e krijuar pas vërshimeve në Mitrovicë, ka shprehur gatishmërinë që të mbështesë komunën me renovimin e pesë shtëpive



për familjet e prekura nga vërshimet. Kryetari Hamza ka falënderuar shoqatën “Bereqeti” dhe stafin e saj për

ndihmën dhe solidaritetin e treguar ndaj familjeve që kanë pësuar dëme të shumta në shtëpitë e tyre nga vërshimet.

MERHUM NUSRET EF. CENAJ (1972-2023)

“Të Allahut jemi dhe tek Ai do të kthehemi”

Më 11 shkurt 2023, në moshën 50 vjeçare, ndërroi jetë imami i Xhamisë së Pashës në Ulqin, Nusret ef. Cenaj.

Biografi e shkurtër

Nusret ef. Cenaj lindi më 5 gusht 1972, në një familje fetare dhe atdhetare. Shkollimin fillor e përfundoi në shkollën “Bedri Elezaga” në Anë të Malit. Më pas, shkollimin e mesëm e vazhdoi në Medresenë “Alaudin” të Prishtinës, të cilin e përfundoi në vitin 1992. Po në atë vit, filloi edhe detyrën e imamit. Në vitin 1996, u regjistrua në kursin e gjuhës arabe në Medine, të cilin e përfundoi në vitin 1998. Me t’u kthyer nga Medina, u emërua imam i Xhamisë së Pashës në Ulqin, në të cilën shërbeu deri në fund të jetës së tij. Në vitin 2004, përfundoi studimet në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë. Imamin Cenaj, përveç detyrës së imamit dhe të mësimdhënësit, atë, për disa vite e gjejmë

në udhëheqje të sektorit të shërbimeve fetare pranë Mexhlisit të Bashkësisë Islam në Ulqin.

Ata që e njohën imamin Nusret ef. Cenaj, do ta kujtojnë atë si një njeri të përkushtuar, të qetë, të komunikueshëm, të çiltër e dashamirës me të gjithë, veti këto me të cilat karakterizohej, duke dëshmuar kështu shembullin më të mirë të një imami të përkushtuar dhe një njeriu me vlerat më të mira të besimit.

Kalimi i tij në Ahiret është një humbje e një njeriu meritore të shoqërisë sonë, e cila do të lë një boshllëk të madh në mesin tonë. Urtësia, qetësia, mençuria e këshillat e tij, do të jenë përherë në mesin tonë.

Ai u varros më 14 shkurt 2023 në varrezat e Kravarit në Ulqin, me pjesëmarrjen e një numri të madh xhematësh nga Mali i Zi, Kosova e Shqipëria. Namazit të xhenazes i priu reisi i Bashkësisë Islame të Malit të Zi, Rifat ef. Fejziq.



Lusim Allahun e Madhëruar që ta shpërblejë me të mirat e Tij të pakufishme dhe që shpirtin e tij ta bashkojë me shpirtat e peygamberëve, dëshmorëve e dijetarëve tanë! (Rifat Jusufi)

MERHUM FEHMI EF. RAQIPI (1936-2023)

“Të Allahut jemi dhe tek Ai do të kthehemi”

Njoftojmë miqtë, kolegët dhe dashamirët, se më 22 shkurt 2023, në moshën 87 vjeçare, ndërroi jetë imami Fehmi ef. Raqipi.

Biografi e shkurtër

Fehmi ef. Raqipi lindi më 25 janar 1936, në fshatin Dobrosin, komuna e Bujanocit. Mësimet e para të fesë, deri në ixhazet, i mori nga babai i tij, mulla Mehmet ef. Raqipi.

Pas kësaj, ai u regjistrua në Medresenë “Alauddin” në Prishtinë (me korrespondencë), të cilën e kreu me sukses.

Më pas, emërohet imam në xhaminë e fshatit Dobrosin, komuna e Bujanocit, pasi baba i tij kaloi në pension.

Shërbeu si imam në këtë xhami për rreth 32 vite (1964-1996).

Gjatë kësaj periudhe ai ua mësoi leximin e Kuranit afro njëzet gjeneratave, prej të cilëve disa ende vazhdojnë të veprojnë si imamë nëpër xhemate të ndryshme.

Pavarësisht rrethanave dhe situatave politike të komunizmit dhe të tjera, ai dha një kontribut të çmueshëm, jo vetëm në xhami, por u mor edhe me shkrime ku la pas vete disa libra. Prej tyre: “El Hutab el memberije”, “Tryeza shpirtërore”, “Hixhabi (Mbulesa)”, “Istiadheja dhe besmelja”, “Fikhu Hanefij”, e punime të tjera në shkencën e hadithit.

Gjatë gjithë kësaj periudhe ishte anëtar dhe pjesëtar i Këshillit të Bashkësisë Islame të Bujanocit, ku ishte një bashkëpunëtor i mirëfilltë i këtij institucioni.



Zoti e mëshiroftë dhe e shpërbleftë me Xhenet!

DEPARTAMENTI I GRUAS I BIK-UT SHËNOI DITËN BOTËRORE TË MBULESËS



Nën organizimin e Departamentit të Gruas të BIK-ut dhe World Hijab Day Kosova, të mërkurën, më 1 shkurt, u mbajt konferenca e 5-të kushtuar mbulesës. Pjesë e kësaj konference ishin përfaqësueset nga Qeveria e Kuvendi, siguria e policia, e mysafire nga Shqipëria e Shkupi, si dhe personalitete nga fusha të ndryshme.

Në këtë organizim u bë thirrje për të drejtat e grave në përgjithësi, e në veçanti për manifestimin e lirshëm të fesë të vajzave myslimane pa paragjykitje e stigmatizim, ashtu siç ua garantojnë ligjet në fuqi.

Kryeimami i Kosovës, Vedat ef. Sahiti, tha se Bashkësia Islame e Kosovës do të ngre zërin gjithmonë kur gratë e vajzat me mbulesë diskriminohen e stigmatizohen në shoqëri.

“Ne kemi ngritur dhe do të ngremë zërin kundër vendimeve, ligjeve, akteve dhe të gjitha veprimeve që diskriminojnë, injorojnë apo stigmatizojnë një grua që ka vendosur të plotësojë fetarinë e saj dhe të konfirmojë identitetin e saj me hixhab, si dhe mbështesim çdo grua që shpreh përkushtimin e saj ndaj Zotit duke bartur hixhabin” u shpreh mes të tjerash kryeimami Sahiti.

Nënkryetarja e Kuvendit të Kosovës, Saranda Bogujevci, tha se ende duhet të punohet për ngritjen e vetëdijes për sa i përket mbulesës.

“Mendoj që kemi ende punë për të bërë në shoqërinë tonë për sa i përket ngritjes së vetëdijes të çështja e mbulesës. Kjo natyrisht që mbetet obligim

edhe yni si persona që jemi në pozita të caktuara dhe që mund të punojmë e të sigurohemi që në sho-qërinë tonë të ketë barazi”, tha ajo.

Zëvendëskryeministrja, Emilia Rexhepi, ofroi mbështetjen e plotë dhe bashkëpunimin e saj në arritjen e përmbushjes së të drejtave të grave me mbulesë.

“Jam sot këtu për t’ju përcjellë formën më të sinqertë të mbështetjes dhe bashkëpunimit në përmbushjen e çdo forme të të drejtave tuaja të garantuara nga Kushtetuta e vendit tonë dhe ligji për lirinë e fesë. Të jeni të sigurt, që unë do të jem gjithmonë me ju dhe askush nuk ka të drejtë, absolutisht askush t’ju diskriminojë sepse jeni tonat, bashkëqytetare të barabarta me të gjithë qytetarët e Republikës sonë.”

Gratë dhe vajzat me mbulesë në Kosovë po tregojnë profesionalizëm në secilën fushë ku veprojnë, ndonëse një numër i tyre ende po përballen me paragjykitje, e mohim të të drejtave për punësim. Kështu theksuan organizatorët e kësaj konference.

“Fatmirësisht, sot, shumë grave po iu jepet mundësia të ushtrojnë profesionin e tyre pavarësisht mbulesës, por në anën tjetër, në legjislacionin e Kosovës, ekziston një udhëzim administrativ në të cilin ndalohet bartja e mbulesës për nxënëset e ciklit të ulët dhe të lartë në sistemin publik të arsimit në Kosovë, e i cili merret për referencë edhe në fushat e tjera të organizimit të jetës publike. Ne, si Bashkësi Islame e Kosovës e si Departament i Gruas, si përgjegjës për

organizimin e jetës fetare në Kosovë iu kemi ofruar mundësi punësimi një numri të madh të grave e vajzave brenda institucioneve të Bashkësisë Islame të Kosovës, e të cilat me zell dhe profesionalizëm të dëshmuar po japin kontribut të jashtëzakonshëm në edukimin e brezave fetar”, tha udhëheqësja e Departamentit të Gruas së BIK-ut, znj. Vaxhide Bunjaku.

“Gratë myslimane me hixhab shpesh stigmatizohen. Ato konsiderohen të shtypura nga njëra anë dhe si fanatike fetare nga ana tjetër. Për shkak të keqkuptimeve të tilla, për fat të keq, shoqëria më e madhe nuk arrin të pranojë dhe vlerësojë guximin e grave myslimane për t’iu kundërvënë normave shoqërore në vendosmërinë e tyre për të ruajtur privatësinë e tyre. Si rezultat i këtyre keqkuptimeve, gratë myslimane diskriminohen në vendin e punës, ndërsa të tjera abuzohen emocionalisht nëpërmjet vërejtjeve”, u shpreh ambasadorja e World Hijab Day Kosovo, znj. Valbone Bytyqi.

Në këtë konferencë, po ashtu u diskutua për të drejtat e grave sipas ligjit të Kosovës e Kartës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Për nder të Ditës Botërore të Mbulesës, autorja Marigona Krasniqi, dhuroi për të pranishmit romanin e saj “Zëri i mbytur i gruas”.

Që nga viti 2013, 1 Shkurti festohet si Dita Botërore e Mbulesës në rreth 125 vende të botës. (Shota Krasniqi)

ZEMRA SËRISH MBETET E ETUR

Janë ditë të numëruara,
Që jetët gjallërojnë,
E në netët e këtyre ditëve,
Zemrat në sexhde pushojnë.

Rrugës je o muaj i mirësive,
Eja me hënën, po të presim...
Myslimanë anekënd botës,
Me ibadete plot e zbardhim mëngjesin.

Me ty ditët kanë kuptim,
Faljen Tënde o Zot kërkojmë,
Kuran lexojmë mbrëmje e agim,
Er-Rejanin e shpresojmë.

Mirëseardhje të uron çdo zemër,
Nga viti i kaluar, shumë mall ka mbetur,
Je burimi që pimë shumë nga ti,
Por, zemra sërish mbetet e etur.

Nga takimi ynë i fundit,
Sytë na shkëlqejnë nga lotët për ty,
Atëherë nga frika se më a do të shihemi,
Dhe tani nga gëzimi që takohemi përsëri.

Te ne frymon përherë,
Gjashtë muaj lutemi të të takojmë,
Dhe kur ti të na kesh shkuar,
Në muajt e mbetur pranimin tënd
Zotit i kërkojmë!

Anita Gërguri-Zhegrova



400,500.00 EURO

**NGA AKSIONI I GRUMBULLIMIT TË MJETEVE
NË XHAMITË E KOSOVËS, PËR TËRMETIN NË TURQI DHE SIRI**

